

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



MBROJTJA

Viti i 93-të i botimit
Maj-gusht 2025 / Nr. 2

Forcat e Armatosura:
Objektivi 2030

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Viti i 93-të i botimit MAJ-GUSHT 2025 / Nr. 2

DREJTOR I QKMBM

ARBEN SKËNDERAJ

Shefe e Sektorit të Botimeve &

Kryeredaktore

ANJEZA MUSOLLARI

GRAPHIC DESIGNER

AFËRDITA HYSAJ

REDAKTORE / KORREKTORE

SUELA HODA

BASHKËPUNËTORË

KOLONEL HYSNI GJERGJI

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ
MJESHTËR I MADH

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

© Ministria e Mbrojtjes

*Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të
riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa marrë
autorizim nga botuesit e saj.*

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes.

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

*Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:
[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/
revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)*



Mbrojtja

Kryeministri Rama dhe ministri Vengu në qendër të strategjisë së re të NATO-s: Shqipëria
afirmon leadershipin në sigurinë transatlantike, Tiranë - Samiti 2027

4

Shqipëria, prioritet investimet në Mbrojtje: Pjesë e Projekteve të Përbashkëta me BE-në
për Sigurinë Evropiane

10

Ministri i Mbrojtjes, vizitë në Bazën Ajrore të Farkës: Falënderon pilotët hungarezë për
ndihmën në përballimin e zjarreve

11

Shqipëria ringjall industrinë ushtarake: Prodhimi vendas i armatimeve, një strategji për
sigurinë dhe zhvillimin kombëtar

14

Ministri Vengu: Shqipëria krah Kosovës për garantimin e stabilitetit në rajon

16

Kur uniforma laget me djersë e hi – sakrificë që nuk matet me orë

31

Pesë Vite Akreditim për Akademinë e Forcave të Armatosura, një Dëshmi e Ekselencës në
Arsimin Ushtarak Shqiptar

36

Rivitalizimi i Industrisë Ushtarake, një Qasje Strategjike në Realitetin e Ri të Sigurisë

48

67 vite KMS, histori, krenari dhe përkushtim në shërbim të sigurisë kombëtare

58

"Nderi i Kombit fillon me uniformën" - Me studentët e diplomuar: Gentritin, Fjodorën
dhe pedagogun, nëntoger Arlen Rama

62

"Heroi im nën Uniformë" - Një Bisedë Zemre me major Genti Bajlas dhe bijën e Tij,
Alaja 8-vjeçare

66

Heronjtë me uniformë të kuqe: Rrëfimi i zjarrfikësit

70

Agron Goga: Buzëqeshja që lind nga dhimbja

74

Strategjitë dhe risitë e operacioneve të qershorit 2025, "Rrjeta e merimangës", "Ngritja
e Luanit" dhe "Çekani i mesnatës"

78

Arsimimi në Ushtri, gur-themeli i Mbrojtjes Kombëtare

82

Mbi gjurmë, ndërtojmë të ardhmen

92

Shqiptarë, fluturon drejt dritës! - Thirrja hyjnore që na ngarkon me shpresë dhe përgjegjësi

112

Orkestra e Ushtrisë Shqiptare: Diplomaci në skenë, magji mbi det

118

Gjurmë të një gjenerali dhe profesori ushtarak

120

Hito Kongoci - Fushëbardha, topçiu i parë shqiptar që shkroi epokë

126

24

Shqipëria themelon
Komandën e
Kibernetikës
dhe Ndërlidhjes,
ministri Vengu: Një
Hap Historik drejt
Modernizimit të
Mbrojtjes Kombëtare

6

OBJEKTIVI I MBROJTJES 2030

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu së bashku me kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Drejtësisë Ulsi Manja, inspektuan mjediset e Uzinës së Rubikut, e cila do të kthehet në Qendër të Industrisë Ushtarake.

Në takimin me ish-punonjës së uzinës, ministri Vengu u shpreh se ky...

12

NGA BETIMI TE PËRGJEGJËSIA 90 Oficerë të Rinj i Bashkohen Forcave të Armatosura

20

Shqipëri - Kosovë: Forcim i Partneritetit Usharak përmes Planit të Bashkëpunimit 2025–2028

Në ambientet e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë u zhvillua një takim zyrtar ndërmjet përfaqësuesve të lartë të FA-ve të Shqipërisë dhe Shtabit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), me fokus hartimin e Planit...



**SHSHPPFA, gjenerallejtënant
Arben Kingji: Nga Tradita
në Vizion - 67 Vite Akademi
e Mbrojtjes në Themel të
Ushtrisë Moderne Shqiptare**

Faqe 22



**25 vite rrugëtim, nga themelet
tek modernizimi**

Intervistë ekskluzive me Komandantin e
Forcës Tokësore të FARSH,
Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia

Faqe 56



**Të jesh grua:
Mes detyrës, identitetit
dhe sakrificës**

Faqe 116



Kryeministri Rama dhe ministri Vengu në qendër të strategjisë së re të NATO-s: Shqipëria afirmon leadershipin në sigurinë transatlantike, Tiranë - Samiti 2027

Në platformën strategjike të Samitit të NATO-s, të mbajtur më 24-25 qershor 2025 në Hagë, delegacioni i Shqipërisë, i udhëhequr nga kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Igli Hasani, shefi i Shtabit të Përgjithshëm Arben Kingji dhe përfaqësues të inteligjencës, afirmoi një angazhim të qartë ndaj mbrojtjes kolektive dhe sigurisë transatlantike. Vendimet për investimin strategjik në Portin e Ri të Durrësit dhe organizimin e Samitit 2027 në Tiranë ishin ndër pikat më të spikatura të përfaqësimit shqiptar.

Takimi Rama-Rutte: Një aks i ri strategjik

Në një moment kulmor të Samitit, kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim bilateral me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte. Diskutimet u përqendruan në sigurinë në Ballkanin Perëndimor, si dhe projektin ambicioz për ndërtimin e një terminali ushtarak në Portin e Ri të Durrësit, ku NATO pritet të ketë rol praktik dhe operacional.

Roli i ministrit Pirro Vengu në forumet ushtarake të NATO-s

Ministri Vengu ishte pjesë aktive e sesioneve të Ministrave të Mbrojtjes, duke përforcuar angazhimin



e Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes dhe mbështetjen e industrisë ushtarake. Nga punimet në Bruksel deri te diskutimet strategjike në Hagë, ai konfirmoi qasjen proaktive të vendit në planifikimin e dekadës së ardhshme të Aleancës.

Deklaratat përfundimtare të samitit përfshinë:

Dedikimin e 5% të GDP-së për mbrojtje deri në 2035; Mbështetje të fuqishme për Ukrainën; Garancinë e fortë të nenit 5 për mbrojtje kolektive; Konsolidimin e rrjeteve të infrastrukturës kritike dhe kapaciteteve inovative të mbrojtjes.

Shqipëria, 'nikoqire' e Samitit të NATO-s 2027

Një moment historik u shënua me vendimin unanim të Aleatëve për të zhvilluar Samitin e NATO-s të vitit 2027 në Tiranë. Kjo përbën një vlerësim për tranzicionin euro-atlantik të Shqipërisë dhe aftësinë e saj organizative, duke vendosur vendin në epiqendr të vëmendjes ndërkombëtare.

Samiti i Hagës shërbeu si një pikë kthese për rolin e Shqipërisë në Aleancën Veri-Atlantike. Me dy figura udhëheqëse, kryeministrin Rama dhe Ministrin Vengu, Shqipëria demonstroi vizion strategjik, përfshirje aktive dhe besueshmëri si një partner i sigurisë kolektive. Investimi në Porto Romano dhe konfirmimi i Tiranës si qytet pritës për Samitin e ardhshëm janë dëshmi të këtij kapitulli të ri në politikën e jashtme dhe të mbrojtjes së vendit.





Objektivi i Mbrojtjes 2030:

Shqipëria në hartën e vendeve të prodhimit të mjeteve, artilerisë, armatimeve, dronëve dhe municioneve

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu së bashku me kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Drejtësisë Ulsi Manja, inspektuan mjediset e Uzinës së Rubikut, e cila do të kthehet në Qendër të Industrisë Ushtarake.

Në takimin me ish-punonjës së uzinës, ministri Vengu u shpreh se ky projekt do të realizohet pas disa negociatash, të cilat janë ende në proces: “Jemi shumë afër realizimit të objektivit që qeveria shqiptare ka vendosur për rijetëzimin e industrisë ushtarake në vendin tonë. Patjetër që ky kompleks i ri ushtarak do të krijojë padyshim disa përfitime, jo vetëm për ekonominë lokale, por janë gjithashtu benefitet e logjistikës, shërbimeve mbështetëse, që do të gravitojnë rreth këtij kompleksi”, - theksoi ministri Vengu. Sipas Ministrit të Mbrojtjes, zhvillimi i industrisë ushtarake do të hapë mjaft vende pune.

“Ne nuk synojmë të riarmatosemi, por synojmë të ngremë një ekonomi të qëndrueshme, ku industria ushtarake është një prej shtyllave kryesore të ri-industrializimit të vendit”, - u shpreh ministri Vengu. Nga ana e tij, kryeministri Edi Rama u shpreh se: “Këtë kompleks e kemi identifikuar si një nga pikat, ku do të investohet dhe do të prodhohet për Forcat tona të Armatosura, por në masën më të madhe për eksport. Gjë që sigurisht do të thotë e para, një front i ri dhe kuptimplotë punësimi; e dyta, punësim cilësor, pasi këtu kërkohen një seri specialitetesh, ashtu sikundër edhe të gjitha kategoritë, që nga puna e inxhinierëve, tek puna e teknikëve dhe tek puna e

gjithë shërbimeve mbështetëse”.

Kryeministri tha se, duke zhvilluar këtë industri nuk rriten thjesht kapacitetet tona mbrojtëse, por rritet në mënyrë të ndjeshme ekonomia vendore dhe kombëtare.

Kryeministri Rama gjithashtu theksoi se po negociohet me aleatët dhe kompani prestigjioze në fushën e Mbrojtjes, që këto investime të nisin konkretisht. “Këto qendra të industrisë ushtarake do të jenë të ndara në disa pika të terrorit sipas kapaciteteve dhe profileve të tyre dhe, do të profilizohen në prodhime të llojeve të ndryshme. Për të gjitha këto, ne jemi duke bashkëpunuar dhe negociuar me aleatë të mëdhenj të Shqipërisë, me kompanitë nga më të mëdhatë, nga më prestigjiozet në fushën e Mbrojtjes, kemi ndërtuar rrugët e duhura për të bërë këto marrëveshje dhe së shpejti ky program do të nisë konkretisht, pas firmosjes së kontratës, këtu në Qendrën e Industrisë Ushtarake në Rubik”, - tha kryeministri Rama. Ai vuri në dukje gjithashtu se do të vijnë investimet për mbrojtjen si dhe rritja e pagave për ushtarakët.

Industria e Mbrojtjes ka një objektiv të qartë që brenda vitit 2030, Shqipëria të hyjë në hartën e vendeve të prodhimit të mjeteve, artilerisë, armatimeve, dronëve dhe municioneve. Një pjesë e godinave në kompleksin e Rubikut do të vihet në funksion të investorëve, që do të investojnë në këtë fushë.





Akademia e Aviacionit në Vlorë, KAYO firmos marrëveshjen me kompaninë izraelite

Akademia e Aviacionit në Vlorë, KAYO firmos marrëveshjen me kompaninë izraelite. Më 8 maj, testi i parë i uljes së avionit në pistën e Aeroportit të Vlorës. Shkolla e Aviacionit do të rikthehet në Vlorë. Kjo falë bashkëpunimit të kompanisë shtetërore KAYO dhe kompanisë prestigjioze izraelite “Elbit Systems Ltd.”.

Memorandumi mes dy kompanive u firmos në Vlorë, në prani të kryeministrit Edi Rama, zëvendëskryeminstres Belinda Balluku, ministrit të Mbrojtjes Pirro Vengu dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji. Memorandumi për rithemelimin e Shkollës u nënshkrua nga drejtuesi i Kompanisë Shtetërore

të Prodhimit të Armëve, KAYO, e Ministrisë së Mbrojtjes, Ardi Velu dhe përfaqësuesit të kompanisë së Izraelit.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu theksoi se kjo shkollë do të nxjerrë pilotë ushtarë dhe civilë, sipas nevojave të kërkuara.

“Rithemelimi i Shkollës së Aviacionit të Vlorës, në aeroportin e Vlorës, në Akëri, një shkollë e cila do të gjenerojë jo vetëm pilotë ushtarakë, por edhe civilë, jo vetëm kontrollorë ajrorë ushtarakë, por edhe civilë, gjithmonë me një investim të rëndësishëm të dyanshëm”, - tha ministri Vengu.

“Siç e përmendi edhe zëvendëskryeministrja Balluku pak më parë, efekti i rritjes së buxhetit të mbrojtjes në tërë këtë dekadë, do të doja të theksoja një shifër të vetme, në dhjetë vitet e ardhshme investimet në mbrojtje në Republikën e Shqipërisë janë 10-fishuar, nga 13 milionë në 138 milionë euro”, - tha Vengu. “Sigurisht, - shtoi ai, - Shqipëria në përmbushje të të gjithë detyrimeve si vend anëtar i NATO-s ka investuar në infrastrukturë kritike ushtarake, por jo vetëm, dhe ndërkohë që ne ndërmarrim një hap tjetër ambicioz për të çuar edhe më lart se 2% të prodhimit të brendshëm bruto, buxhetin e mbrojtjes në tërësi, përpiqemi që gjithmonë këto investime të kenë një impakt në ekonominë e vendit, një vlerë të shtuar në ekonominë e vendit, dhe prandaj kemi një logjikë në investimet në infrastrukturë kritike, në mënyrë që ato të kenë një dobi të dyfishtë: të shërbejnë për lëvizshmërinë ushtarake, por edhe për lëvizshmërinë civile.

I tillë është në fakt edhe i gjithë investimi në Korridorin 8, ku porti i Porto Romanos është porta hyrëse dhe do të jetë, siç tha zëvendëskryeministrja, një port ushtarak dhe civil: një port tregtar modern i automatizuar dhe një port ushtarak që do të ketë një dobi të trefishtë akomodimin e mjeteve detare që forca detare, që Shqipëria do të ndërtojë, dhe akomodimin e forcave të NATO-s për dislokime”, -

tha ministri Vengu.

“Por, - shtoi ai, - infrastruktura nuk është e vetmja shtyllë. Shtylla e dytë ka të bëjë me investime në kapitalin njerëzor, zhvillimi i industrisë së mbrojtjes, qëndrueshmëria e infrastrukturës kërkojnë kapacitete dhe burime njerëzore të mirë kualifikuara, prandaj dhe kemi ndërmarrë, Akademia e Forcave të Armatosura së bashku me Universitetin Politeknik dhe Universitetin e Vlorës, krijimin e programeve të përbashkëta në mënyrë që të mbështesim këtë sforcë dhe përpjekje kombëtare për industrinë ushtarake”.

“Na duhet të stërvitim inxhinierë navalë, inxhinierë armatimi, kontrollorë ajrorë, pilotë, e kështu me radhë, në të gjithë ciklin e investimeve publike, ne na duhet të ndërtojmë një gjeneratë ekspertize, profesionistë të rinj, të cilët mirëmbajnë këtë infrastrukturë kritike dhe e zhvillojnë më tej.

Prej disa muajsh Ministria e Mbrojtjes dhe kompania e prodhimit ushtarak KAYO, kanë një negociatë me një kompani lider izraelite “LB Systems”, që i kemi prezent këtu sot për të gjeneruar këto kapacitete, këto burime njerëzore civilo-ushtarake, ndaj do të doja të kalonim tek momenti i nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje shumë të rëndësishme për rithelimin e shkollës së aviacionit në Vlorë, në aeroportin e Vlorës, një shkollë e cila do të gjenerojë jo vetëm pilotë ushtarakë, por edhe pilotë civilë, jo vetëm kontrollorë ajrorë ushtarakë, por edhe civilë, gjithmonë me një investim të dobishëm të dyfishtë”, - tha Vengu.

KAYO, pas nisjes së bashkëpunimit të suksesshëm me “Fincantieri” për ndërtimin e anijeve në Pashaliman, po merr përsipër edhe këtë projekt të rëndësishëm me “Elbit Systems”, kompania prestigjioze që sjell teknologji të përparuar, si simulatorë të fluturimit në kushte të vështira dhe pajisje moderne trajnimi.

Ngritja e Akademisë së Aviacionit do të sjellë ulje të kostove, certifikim të qëndrueshëm dhe të pavarur si edhe rritje të kapaciteteve kombëtare në mbrojtje dhe aviacion civil.



SHQIPËRIA, PRIORITET INVESTIMET NË MBROJTJE: **Pjesë e Projekteve të Përbashkëta me BE-në për Sigurinë Evropiane**

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu zhvilloi një bashkëbisedim të rëndësishëm me ambasadorët e vendeve të Bashkimit Evropian të akredituar në Shqipëri, ku në qendër të diskutimeve ishte rritja e investimeve në mbrojtje dhe zhvillimi i kapaciteteve prodhuese të industrisë ushtarake shqiptare.

Ministri Vengu theksoi se forcimi i shtyllës evropiane të NATO-s është sot një temë kyçe në agjendën euroatlantike dhe Shqipëria është e përkushtuar të luajë një rol aktiv në këtë drejtim. Ai nënvizoi se investimet në mbrojtje nuk kanë vetëm ndikim ushtarak, por sjellin gjithashtu përfitime të prekshme në fusha civile, përmes nxitjes së inovacionit dhe krijimit të vlerës së shtuar ekonomike për vendin.

Në këtë kuadër, ai vlerësoi vendimin e Bashkimit Evropian për të përfshirë Shqipërinë në mekanizmat dhe projektet e përbashkëta në fushën e mbrojtjes, duke e cilësuar këtë, një hap të rëndësishëm drejt integritimit më të thellë të vendit në arkitekturën evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes. Takimi u konsiderua një sinjal i qartë i bashkëpunimit të ngushtë mes Shqipërisë dhe partnerëve të saj evropianë në ndërtimin e një mjedisi më të sigurt dhe më të qëndrueshëm për të ardhmen.





MINISTRI I MBROJTJES, vizitë në Bazën Ajrore të Farkës: Falënderon pilotët hungarezë për ndihmën në përballimin e zjarreve

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë në Bazën Ajrore të Farkës, ku takoi nga afër pilotët hungarezë të helikopterëve H225M, të cilët kanë ardhur në ndihmë të Shqipërisë në përballimin e vatrave të zjarrit që kanë prekur disa zona të vendit.

Ndihma është ofruar në kuadër të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Europian, dhe përbën një shembull domethënës të solidaritetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar mes Shqipërisë, Hungarisë, Kroacisë dhe vendeve të tjera anëtare të BE-së në përballimin e emergjencave natyrore.

Gjatë fjalës së tij, ministri Vengu theksoi rëndësinë e vigjilencës së lartë në orët dhe ditët në vijim, duke vlerësuar lart përkushtimin dhe profesionalizmin e mbi 1300 efektivëve civilë dhe ushtarakë që janë angazhuar në terren për menaxhimin e situatës me zjarret dhe temperaturat ekstreme.

“Bashkëpunimi me vendet mike dhe strukturat europiane është kyç në përballimin e emergjencave. Falënderoj për zemërsisht ekipet hungareze për gatishmërinë dhe mbështetjen konkrete në këto momente sfiduese për vendin tonë”, - u shpreh ministri Vengu.

Vizita në Bazën e Farkës u mbyll me një takim pune me drejtues të Forcave Ajrore, ku u diskutuan hapat operativë për përballimin e situatës në vazhdim dhe koordinimi me partnerët ndërkombëtarë.





NGA BETIMI TE PËRGJEGJËSIA 90 Oficerë të Rinj i Bashkohen Forcave të Armatosura



Në një ceremoni solemne të zhvilluar në kompleksin e ri sportiv të garnizonit “Skënderbej”, 90 studentë/kadetë të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA) bënë betimin ushtarak para Flamurit Kombëtar, duke u bërë pjesë e trupës së re të oficerëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Mes tyre,

edhe pesë studentë nga Kosova, të cilët u diplomuan me sukses në këtë institucion të rëndësishëm ushtarak. Në këtë ngjarje të veçantë ishin të pranishëm personalitete të larta të mbrojtjes dhe sigurisë nga Shqipëria dhe Kosova, përfshirë ministrin e Mbrojtjes të Shqipërisë z. Pirro Vengu, ministrin e Mbrojtjes të Kosovës z. Ejup Maqedonci, shefin e



Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve, gjenerallejtënant Arben Kingji, gjeneralë, atashe ushtarakë, anëtarë të Komisionit Parlamentar të Sigurisë, pedagogë të AFA-së dhe familjarë të kadetëve.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, vlerësoi këtë moment si një ngjarje me rëndësi kombëtare:

“Çdo herë që një brez i ri vesh uniformën, shteti shqiptar rifillon, forcohet dhe përtërihet”, – u shpreh ministri Vengu. Ai theksoi më tej se Forcat e Armatosura nuk janë thjesht një dekor simbolik i shtetit, por përfaqësojnë “kockën, muskujt dhe ndërgjegjen” e tij, duke sjellë në vëmendje rolin e efektivëve në përballimin e emergjencave natyrore, veçanërisht zjarreve që kanë prekur vendin gjatë vitit: “Ata nuk bënë vetëm detyrën. Ata treguan atë që në rrethana normale quhet vetëpërmbytje, por në rrethana të jashtëzakonshme, quhet heroizëm i heshtur”.

Ministri prezantoi gjithashtu pesë shtyllat kryesore të Strategjisë “Shqipëria 2030” për mbrojtjen kombëtare, të cilat përfshijnë: zhvillimin e industrisë vendase të mbrojtjes “Made in Albania”; aplikimin e inovacionit dhe teknologjisë; modernizimin operacional dhe logjistik; forcimin e kapaciteteve të integruara dhe kontributin në sigurinë rajonale e globale.

Në fjalimin e tij, ministri falënderoi edhe familjarët dhe pedagogët për mbështetjen e tyre: “Shqipëria nuk është më një vend që pret të mbrohet. Shqipëria mbron! Shqipëria kontribuon! Shqipëria përgatitet!”. Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, në fjalën e tij theksoi rëndësinë morale dhe ligjore të betimit ushtarak: “Betimi ushtarak para Flamurit Kombëtar nuk është thjesht një tekst, por një angazhim moral, ligjor dhe atdhetar për të qenë gjithmonë në shërbim të kombit”.

Nga 90 të diplomuarit, 53 përfunduan studimet Bachelor në programe të ndryshme si Shkenca Ushtarake, Navigim Detar dhe Teknologji Informacioni në fushën e Mbrojtjes. Ndërsa 37 kadetë përfunduan me sukses Kursin njëvjeçar të Përgatitjes së Oficerit.

Ceremonia përmbylli me krenari një etapë të rëndësishme për këta të rinj, të cilët tashmë do të mbajnë mbi supë përgjegjësinë dhe nderin për të shërbyer me përkushtim në radhët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.





SHQIPËRIA RINGJALL INDUSTRIJË USHTARAKE: **Prodhimi vendas i armatimeve, një strategji për sigurinë dhe zhvillimin kombëtar**

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, ka bërë të ditur një strategji të re për fuqizimin e mbrojtjes dhe industrializimin ushtarak të vendit, duke theksuar se Shqipëria, si një aleat i besueshëm në NATO, duhet të njohë kufizimet e saj aktuale, por edhe të përfitojë nga mundësitë për të ndërtuar kapacitete të qëndrueshme. “Duhet të jemi të kujdesshëm dhe realistë në raport me kapacitetet që kemi në mbrojtje. Forcimi i fuqisë së zjarrit dhe zhvillimi i industrisë ushtarake janë thelbësorë për

sigurinë kombëtare”, - deklaroi ministri për mediat. Gjithashtu ai theksoi se do të ketë një rritje domethënëse të kapaciteteve për mbrojtjen kundër sulmeve ajrore, përdorimin e dronëve luftarakë, sistemeve anti-dron dhe artilerisë së rëndë. Këto investime janë pjesë e një strategjie 5-vjeçare të koordinuar me aleatët e NATO-s.

Prodhimi vendas, prioritet kombëtar

Në kuadër të kësaj strategjie, Shqipëria ka tërhequr interesin e 25 kompanive ndërkombëtare për

prodhimin e armatimeve në vend. Deri tani janë finalizuar dy marrëveshje: një për prodhimin e uniformave personale dhe tjetra për mjete të blinduara. Me nëntë kompani të tjera po vijnë negociatat për prodhimin e municioneve dhe teknologjive të avancuara ushtarake.

Ministri theksoi se në vitin 2026 pritet të nisë prodhimi i municioneve të kalibrit të vogël dhe të mesëm në Shqipëri. “Qëllimi ynë është të mos importojmë më armë dhe municione, por t’i prodhojmë vetë për nevojat e Forcave të Armatosura. Eksporti do të jetë objektiv i dytë, për ta bërë industrinë të qëndrueshme ekonomikisht”, - u shpreh ai.

Nga konsumator në prodhues të sigurisë

Ministri vuri në dukje se kjo strategji nuk është vetëm ushtarake, por përfaqëson një qasje të re drejt zhvillimit ekonomik të vendit përmes një industrie ushtarake vendase që gjeneron punësim dhe rrit vlerën e prodhimit kombëtar.

Më tej ministri Vengu do të sillte në vëmendje dhe sigurinë kombëtare, për të cilën u shpreh se: “Mbrotjtja nuk është vetëm fuqi zjarri. Mbrotjtja është kohezion shoqëror, besim në institucione dhe angazhim largpamës gjithëshetëror për të zhvilluar kapacitete civile dhe ushtarake. Mbrotjtja kalon sigurisht përmes qëndrueshmërisë ekonomike, teknologjisë, prodhimit vendas dhe, në fund, përmes qëndrueshmërisë së familjeve shqiptare. Gjithashtu ai bëri me dije dhe vizionin e Qeverisë Rama, por njëkohësisht sesi Shqipëria do i përgjigjet angazhimit të vendeve aleate në Samitin e NATO-s për rritjen e buxheteve të Mbrotjtjes.

Samiti i NATO-s i zhvilluar në Hagë shërbeu si një platformë e rëndësishme për rikonfirmimin e qëndrueshmërisë së aleancës dhe rolit udhëheqës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ministri i Mbrotjtjes, theksoi se nën leadershipin amerikan, vendet anëtare kanë bërë një angazhim të përbashkët për të rritur ndjeshëm shpenzimet për sigurinë dhe mbrotjtjen.

“Ky është një sinjal i qartë se NATO është një aleancë solide dhe funksionale, që përballlet me sfidat e kohës përmes angazhimit konkret të secilit shtet anëtar”, - u shpreh ministri.

Buxheti i mbrotjtjes: Nga 1.75% në 5% të PBB-së deri në vitin 2035

Në përputhje me angazhimet e reja të NATO-s,

Shqipëria ka hartuar një plan ambicioz për rritjen graduale të buxhetit të mbrotjtjes deri në vitin 2035. Strategjia parashikon që brenda një dekade, buxheti i mbrotjtjes të arrijë në 5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, përmes një rritjeje vjetore me 0.15%.

“Synimi ynë është të dyfishojmë buxhetin aktual, duke arritur fillimisht në 3.5% dhe më tej duke përfshirë edhe investimet në infrastrukturë dhe teknologji me përdorim të dyfishtë për të përmbushur 1.5% shtesë”, - deklaroi Vengu.

Ky plan është ndërtuar në bashkëpunim me ministrinë e Financave, të Jashtme si dhe ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe reflekton një përpjekje të bashkërenduar shtetërore për të fuqizuar mbrotjtjen kombëtare dhe kontributin në NATO.

Ringritja e industrisë ushtarake shqiptare:

“Made in Albania” në fushën e mbrotjtjes

Ministri Vengu gjithashtu bëri të ditur se Shqipëria po ndërmerr hapa konkretë për të ringritur industrinë ushtarake vendase. Deri tani, 25 kompani ndërkombëtare kanë shprehur interes për të investuar në prodhimin e armatimeve në Shqipëri. Me nëntë prej tyre po zhvillohen negociatat, ndërsa dy janë finalizuar: një për prodhimin e uniformave personale dhe një tjetër për mjetet e blinduara.

Nëse negociatat ecin siç pritet, viti 2026 do të shënojë fillimin e prodhimit të municioneve të kalibrit të vogël dhe të mesëm “Made in Albania”.

“Qëllimi parësor është të plotësojmë nevojat e Forcave të Armatosura, duke i zëvendësuar importet me prodhim vendas. Eksporti vjen më pas, si domosdoshmëri për qëndrueshmërinë ekonomike të industrisë ushtarake”, - theksoi Vengu.

Organizimi i Samitit të NATO-s në Shqipëri,

në 2027: Vlerësim për kapacitetet e vendit

Për ministrin Vengu, besimi i dhënë Shqipërisë për të organizuar Samitin e NATO-s në vitin 2027 është një konfirmim i drejtpërdrejtë i rolit në rritje të vendit në aleancë dhe i besueshmërisë së tij në rajon.

“Kjo është një përgjegjësi madhore, por edhe një vlerësim i kapaciteteve tona në siguri, infrastrukturë dhe menaxhim”, - u shpreh ai.

Kjo strategji përfaqëson një kthesë historike në politikën e mbrotjtjes së Shqipërisë, duke shënuar kalimin nga një vend konsumator në një vend prodhues e kontribuues i sigurisë rajonale dhe globale.



MINISTRI VENUGU: Shqipëria krah Kosovës për garantimin e stabilitetit në rajon

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu dhe shefi Arben Kingji, pritën në një takim zyrtar komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Bashkim Jashari. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi bashkëpunimin strategjik dhe vëllazëror ndërmjet dy vendeve tona në fushën e Mbrojtjes, i cili konsiderohet një faktor stabiliteti për rajonin dhe një orientim i qartë drejt integritetit euroatlantik.

Ministri Vengu vlerësoi nivelin e lartë të bashkëpunimit me Kosovën dhe konfirmoi përkushtimin e Ministrisë së Mbrojtjes për të mbështetur anëtarësimin e Kosovës në nisma rajonale dhe ndërkombëtare, përfshirë Kartën e Adriatikut (US-A5).

Ndër të tjera, në këtë takim u diskutua rreth situatës së brishtë të sigurisë në rajon, ku u dënuan sulmet terroriste dhe kriminale në veri të Kosovës, si dhe tensionet në Bosnje-Hercegovinë. Ministri Vengu theksoi se Shqipëria do të mbetet gjithmonë krah Kosovës për të garantuar siguri dhe stabilitet të qëndrueshëm në rajon.

Po ashtu, ministri Vengu theksoi qëndrimin e Shqipërisë se misioni i NATO-s, KFOR, është garanti për sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës.

Ministri Vengu dhe gjenerallejtënant Jashari theksuan prioritetet e përbashkëta për forcimin e FSK-së si një forcë moderne dhe territoriale përmes pesë shtyllave kryesore: kapitali njerëzor, modernizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve, industria ushtarake dhe inovacioni, qëndrueshmëria kombëtare (përfshirë mbrojtjen kibernetike dhe civile) dhe infrastruktura kritike.

Bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve në fushën e Mbrojtjes është konkretizuar me pjesëmarrjen aktive në stërvitjen ndërkombëtare “Defender Europe 2025”, ku Shqipëria dhe Kosova luajnë një rol kyç.

Një tjetër fushë me rëndësi strategjike është ajo e arsimit ushtarak. Akademia e Forcave të Armatosura shqiptare vijon të ofrojë bursa dhe kurse për studentët dhe oficerët nga Kosova, ndërkohë që po shqyrtohen edhe kuota të veçanta në universitete publike për specialitete të rëndësishme për mbrojtjen.

U diskutua gjithashtu për mundësinë e tërheqjes së burimeve njerëzore nga diaspora dhe individët me shtetësi të dyfishtë si dhe nxitjen e kthimit të profesionistëve me aftësi të larta në Shqipëri dhe Kosovë përmes stimujve konkretë.

Plani i bashkëpunimit dypalësh për vitin 2025 përfshin 64 aktivitete konkrete: takime, trajnime, shkëmbim informacioni dhe stërvitje, të cilat janë tashmë në proces zbatimi.

Qeveria ofron paketë mbështetëse për zonat e prekura nga zjarret: Angazhim maksimal i forcave të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile

Qeveria shqiptare ka vendosur të ofrojë një paketë mbështetëse për banorët e zonave të prekura nga zjarret e shumta që kanë përfshirë vendin gjatë muajit korrik. Paketa synon të kompensojë dëmet e shkaktuara në banesa, sektorin e bujqësisë dhe atë të blegtorisë.

Gjatë një takimi koordinues ndërinstitutional, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, bëri me dije se fokusi kryesor është vlerësimi i gatishmërisë operacionale për Emergjencat Civile dhe përcaktimi i masave konkrete për ndihmën ndaj banorëve të prekur, veçanërisht në sektorin e blegtorisë.

“Gjatë muajit korrik kemi regjistruar 59 zjarre masive dhe një numër të madh zjarresh më të vogla, kryesisht në zonat rurale. Janë djegur mbi 29 mijë hektarë sipërfaqe”, deklaroi ministri Vengu, duke shtuar se qarqet më të goditura janë Vlora (17.500 ha), Dibra (4.524 ha), Tirana (2.400 ha) dhe Berati (1.500 ha).

Ai nënvizoi se janë angazhuar rreth 14.200 forca, 2.000 mjete të specializuara dhe janë kryer 63 operacione ajrore me mbështetje nga helikopterë shqiptarë dhe

ndërkombëtarë, përfshirë forcat hungareze, italiane, greke dhe kroate.

“Nuk ka pasur kurrë më parë kaq shumë mjete ajrore në dispozicion”, – theksoi Vengu, duke shtuar se dëmet përfshijnë 12 banesa, 3 stane, një objekt kulti dhe një nënstacion energjie, por fatmirësisht nuk janë shënuar humbje në njerëz.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, znj. Anila Denaj, raportoi dëme të konsiderueshme në blegtori, bletari dhe kullota, veçanërisht në zonat jugore si Delvina. “Po vlerësojmë nevojat për ushqim për blegtorinë në të gjitha zonat e prekura, dhe kemi mundësuar furnizimin në kohë rekord”, – tha Denaj. Ndërkohë, ministri i Brendshëm, z. Ervin Hoxha, bëri të ditur se Policia e Shtetit ka identifikuar dhe proceduar 120 persona si të dyshuar për zjarrvënie të qëllimshme ose nga pakujdesia, nga të cilët 21 janë arrestuar.

Ministrat theksuan nevojën për vigjilencë të shtuar edhe gjatë muajit gusht, duke kërkuar reagim të menjëhershëm nga të gjitha strukturat vendore dhe qendrore.





Ministri Vengu: Modernizojmë FA-të me radar të lëvizshëm për vëzhgimin ajror

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu priti në një takim zyrtar homologun e tij francez Sébastien Lecornu, në të parën vizitë të një ministri të Forcave të Armatosura të Francës në vendin tonë. Pas pritjes me truporjë nderi, dy ministrat zhvilluan një takim tête-à-tête dhe më pas, bashkë me delegacionet që i shoqëronin, zhvilluan një takim ku në fokus të diskutimeve ishin modernizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes, industria ushtarake, si dhe trajnimi e edukimi. Marrëveshjen teknike për modernizimin e Forcës sonë Ajrore me kapacitete të avancuara mobile të vëzhgimit ajror, ministri Vengu e konsideroi si tregues të qartë të një investimi strategjik për nevojat kombëtare dhe në funksion të Aleancës.

Nga ana e tij, ministri i Forcave të Armatosura të Francës Sébastien Lecornu, e cilësoi marrëveshjen e nënshkruar si shumë të rëndësishme jo vetëm për rritjen e kapaciteteve të Forcës Ajrore shqiptare, por edhe për rritjen e ndërveprueshmërisë mes forcave aleate. Vizita zyrtare e ministrit të Forcave



të Armatosura të Francës në vendin tonë zhvillohet edhe në kuadër të Samitit të Komunitetit Politik Evropian të mbajtur sot në Tiranë.



MINISTRI I MBROJTJES, PIRRO VENGU, merr pjesë në “Paris Air Show”: Shqipëria forcon bashkëpunimin me Francën në fushën e mbrojtjes

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, realizoi një vizitë zyrtare në Francë, ku u prit nga homologu francez, Sébastien Lecornu, me rastin e hapjes së “Paris Air Show” (Salon du Bourget), një prej ngjarjeve më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil dhe ushtarak, si dhe të teknologjive të mbrojtjes. Ky aktivitet prestigjioz mbledhi liderë politikë, prodhues të industrisë së mbrojtjes dhe përfaqësues të forcave të armatosura nga e gjithë bota, duke ofruar një platformë të vlefshme për shkëmbim përvojë dhe nxitje të bashkëpunimeve të reja teknologjike. Ministri Vengu, në kuadër të vizitës së tij, zhvilloi takime dypalëshe me homologë dhe drejtues të kompanive kryesore të industrisë së mbrojtjes, me fokus

të veçantë bashkëpunimin ushtarak Shqipëri-Francë.

Ai vlerësoi mikpritjen e ministrit Lecornu dhe theksoi se pjesëmarrja në “Paris Air Show” është një mundësi e shkëlqyer për të eksploruar rrugë të reja të bashkëpunimit strategjik.

“Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë ekspozitë tregon angazhimin tonë për të ndjekur hapat e modernizimit dhe për të ndërtuar partneritete afatgjata në fushën e mbrojtjes dhe teknologjisë”, – deklaroi Vengu.

Kjo vizitë vjen në një moment ku Shqipëria po punon intensivisht për të përforcuar rolin e saj brenda NATO-s dhe për të përfituar nga eksperiencia dhe mbështetja e vendeve aleate si Franca në zhvillimin e kapaciteteve të saj mbrojtëse.





SHQIPËRI - KOSOVË: Forcim i Partneritetit Ushtarak përmes Planit të Bashkëpunimit 2025–2028

Në ambientet e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë u zhvillua një takim zyrtar ndërmjet përfaqësuesve të lartë të FA-ve të Shqipërisë dhe Shtabit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), me fokus hartimin e Planit të Bashkëpunimit Dypalësh për periudhën 2025–2028.

Takimi u kryesua nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, i cili vlerësoi progresin e ndjeshëm të FSK-së në drejtim të transformimit dhe modernizimit, si dhe angazhimin e saj në stërvitjet dy dhe shumëpalëshe me performancë të shkëlqyer. Ai theksoi gjithashtu rolin e rëndësishëm që Forca e Sigurisë së Kosovës luan në garantimin e sigurisë kombëtare dhe

rajonale.

Gjenerallejtënant Kingji shprehu përkushtimin e palës shqiptare për të mbështetur pa rezerva FSK-në në fushat kyçe si edukimi ushtarak, trajnimi, shkëmbimi i eksperiencës dhe zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit strategjik mes dy institucioneve.

Delegacioni i FSK-së, i udhëhequr nga kolonel Haki Hoti, u mirëprit me nderimet përkatëse dhe falënderoi palën pritëse për mikpritjen dhe mbështetjen e vazhdueshme.

Ky takim shënon një tjetër hap të rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve vëllazërore dhe partneritetit ushtarak mes Shqipërisë dhe Kosovës, duke konfirmuar angazhimin e përbashkët për paqen, stabilitetin dhe sigurinë në rajon.



TAKIM I LARTË USHTARAK NË TIRANË, THELLOHET BASHKËPUNIMI STRATEGJIK SHQIPËRI-SHBA

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në një takim zyrtar zëvendëskomandantin e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, gjeneral brigade LaPoint, dhe zëvendësrektorin e Planifikimit të Komandës së Forcave Amerikane për Evropën (USEUCOM), gjeneral brigade McKinney.

Ky takim erdhi menjëherë pas përfundimit të stërvitjes shumëkombëshe “Defender Europe-25”, ku të dy gjeneralët amerikanë morën pjesë në “Ditën e Vizitorëve të Shquar”, me ftesë të gjenerallejtënant Kingjit. Në këtë stërvitje, Shqipëria luajti rolin e vendit mikpritës, ndërkohë që në të morën pjesë edhe personel nga Garda Kombëtare e Nju Xhersit dhe Forca Detare e SHBA-së.

Në fokus të takimit ishin vijimi i bashkëpunimit dypalësh, me theks të veçantë në zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse, trajnimeve të përbashkëta, stërvitjeve dhe projekteve të modernizimit të FARSH-së. Gjenerallejtënant Kingji vlerësoi kontributin e rëndësishëm të SHBA-ve për rritjen e ndërveprueshmërisë dhe profesionalizmit të personelit shqiptar, duke përmendur veçanërisht mbështetjen nga USEUCOM dhe Garda e Nju Xhersit në fusha kyçe si trajnimi, mirëmbajtja dhe logjistika.

Në fjalën e tij, gjenerallejtënant Kingji shprehu falënderim të veçantë për Komandën e Forcave Amerikane për Evropën dhe Afrikën, për zgjedhjen



e Shqipërisë për të tretën herë radhazi si vend mikpritës të një prej stërvitjeve më të rëndësishme të NATO-s. Ai e cilësoi këtë si një dëshmi të qartë të partneritetit strategjik mes Shqipërisë dhe SHBA, dhe si një kontribut të drejtpërdrejtë në rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë.

Në përmbyllje të takimit, palët ritheksuan vullnetin për thellimin e bashkëpunimit ushtarak, duke theksuar se angazhimi i SHBA-ve mbetet i pazëvendësueshëm për forcimin e sigurisë rajonale dhe euroatlantike.

Vizita e gjeneralëve LaPoint dhe McKinney vijoi në Komandën e Forcës Tokësore dhe Komandën e Forcës Ajrore, ku u pritën nga komandantët respektivë. Ata u njohën nga afër me zhvillimet më të fundit në këto njësi si dhe me ecurinë e projekteve të përbashkëta me SHBA-të, duke nënvizuar edhe një herë rëndësinë e partneritetit strategjik në fushën e mbrojtjes.

SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji: Nga Tradita në Vizion - 67 Vite Akademi e Mbrojtjes në Themel të Ushtrisë Moderne Shqiptare

Me rastin e 67-vjetorit të themelimit të Akademisë së Mbrojtjes, sot Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, përcjell urimet më të përzemërta për drejtuesit, pedagogët, instruktorët, dhe stafin civil që kanë kontribuar dhe vijojnë kontributin në këtë vatër të dijes dhe lidershit ushtarak. Që prej 10 majit 1958, Akademia ka qenë zemra strategjike e ushtrisë sonë, një institucion që ka formuar mijëra oficerë të përkushtuar, të cilët kanë mishëruar vlerat ndaj Atdheut dhe kanë ndërtuar themelet e një ushtrie moderne, ndërvepruese me NATO-n dhe të denjë për një vend kandidat për Bashkimin Evropian.

Sot, përballë sfidave të një bote që ndryshon me ritme të shpejta, arsimi ushtarak nuk është më vetëm një proces akademik, por një instrument thelbësor i sigurisë kombëtare.

Në këtë kuadër, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë po përqafohet me të ardhmen, me transformime strukturore, infrastrukture bashkëkohore, kurrikula cilësore dhe të modernizuara, teknologji të avancuar, akreditim kombëtar, ndërkombëtar dhe një horizont të qartë për shtrirje më të avancuar kombëtare dhe rajonale të studimeve për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes.

Programet e arsimit ushtarak janë gjithnjë e më shumë në vartësi të nevojave të sotme dhe të nesërme operacionale të Forcave të Armatosura, të institucioneve të sigurisë në vend, duke synuar edukimin e një trupe oficerësh dhe civilësh të përgatitur profesionalisht dhe të pajisur me aftësi për të udhëhequr në një mjedis gjithnjë e më kompleks e të paparashikueshëm.

Për më tepër, bashkëpunimi me institucione të ekselencës ushtarake rajonale dhe të NATO-s është dëshmi e promovimit



rajonat në çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes si dhe e angazhimit për përsosmëri në formimin e liderëve me integritet, vizion dhe përgjegjësi kombëtare, bashkëpunim që duhet thelluar e konsoliduar më tej, etj.

Në këtë përvjetor, shpreh falënderimin tim më të thellë të gjithë brezave që kanë kontribuar ndër vite në këtë institucion

elitar të Forcave të Armatosura.

I inkurajoj brezat e rinj të oficerëve që programet arsimore e stërvitore t'i perceptojnë jo thjesht si promovim në karrierë apo detyrë, por si një mision në shërbim të Forcave të Armatosura, Atdheut dhe vlerave euroatlantike, me dije, përkushtim dhe vizion.

Urime përvjetorin!



Gjeneral Kingji në Konferencën e BCHODs: Bashkëpunimi Rajonal dhe Teknologjitë e reja, çelësi për siguri dhe paqe në Ballkan

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji mori pjesë në Konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit (BCHODs), që u zhvillua në Stamboll, Turqi.

Në fokus të kësaj konference ishte vizioni i përdorimit të mjeteve pa pilot në mjedisin operacional, ku SHSHP të Ballkanit trajtuan zhvillimin e shpejtë teknologjik të mjeteve pa pilot, tashmë një komponent kritik i taktikave moderne të luftimit.

Gjithashtu, gjatë punimeve të kësaj konference, u vu theksi edhe në rëndësinë e dimensionit njerëzor, për garantimin e përdorimit të përgjegjshëm të këtyre sistemeve.

Në fjalën e tij në këtë konferencë, SHSHPFA gjenerallejtënant Arben Kingji ndër të tjera theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet vendeve aleate dhe ato partnere për zhvillimin e kapaciteteve, për adresimin e sfidave dhe mundësive që vijnë nga përdorimi i mjeteve pa pilot, si dhe e vlerësoi si shumë të rëndësishme edhe iniciativën



e Turqisë për ngritjen e Qendrës së Ekscelencës kundër Sistemeve pa pilot.

Më tej, gjenerallejtënant Arben Kingji u ndal edhe në rolin e Qendrës së Inovacionit për Sigurinë dhe Mbrojtjen dhe rivitalizimin e industrisë ushtarake, si pjesë e strategjisë së FARSH-ve për rritjen e kapaciteteve të

Mbrojtjes, si dhe në aftësimin e personelit për t'u përballur me pasiguritë e mjedisit operacional. Qëllimi i Iniciativës së Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Ballkanit është promovimi dhe forcimi i paqes dhe sigurisë rajonale nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak të vendeve anëtare.



Shqipëria themelon Komandën e Kibernetikës dhe Ndërlidhjes, ministri Vengu: Një Hap Historik drejt Modernizimit të Mbrojtjes Kombëtare

Në një ceremoni solemne, u zyrtarizua krijimi i Komandës së Kibernetikës dhe Ndërlidhjes së Forcave të Armatosura, e cila prej këtij momenti do të operojë si një njësi e veçantë strukturore brenda Forcave të Armatosura, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të sigurisë dhe nevojat

strategjike të vendit.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, e ngarkuara me punë e SHBA-së në Shqipëri znj. Nancy VanHorn, gjeneralmajor John Phillips si dhe përfaqësues



të lartë të Forcave të Armatosura, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes Vengu e cilësoi krijimin e Komandës së Kibernetikës dhe Ndërlidhjes si një hap historik drejt modernizimit të strukturave ushtarake dhe rritjes së sigurisë kombëtare në një mjedis gjithnjë e më të digjitalizuar: “Sulmet kibernetike të vitit 2022 ndaj Shqipërisë, shërbyen si një kujtesë e fuqishme se, në një botë gjithnjë e më të digjitalizuar, mbrojtja e hapësirës kibernetike është po aq e rëndësishme sa mbrojtja e integritetit territorial të vendit.

Këto zhvillime, të mbështetura edhe në përvojat e tjera të NATO-s, e bënë të domosdoshëm dhe krejt të natyrshme në fakt krijimin e Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes, të cilën themelojmë sot.

Jo vetëm e natyrshme, sepse na duhet më shumë ndërveprim mes forcave operacionale që ndërmarrin veprimtari që lidhen me mbrojtjen kibernetike dhe me komunikimin digjital, e natyrshme, sepse ky është një domen ku padyshim bashkëpunimi mes komponentit ushtarak dhe komponentit civil është ndoshta çelësi i suksesit.

Krijimi i kësaj komande, përbën një hap historik dhe thekson edhe njëherë angazhimin e Shqipërisë në modernizimin e infrastrukturës së saj të sigurisë kibernetike, duke konfirmuar rolin tonë gjithnjë e më aktiv në arkitekturën rajonale dhe brenda aleancës për sa i përket politikave të sigurisë kibernetike”, - theksoi ministri Vengu.

Sipas ministrit të Mbrojtjes, krijimi i kësaj Komande vjen gjithashtu, pas një sërë hapash të ndërmarra gjatë 5-vjeçarit të fundit nën tutelën, nën mbështetjen, nën trajnimin e partnerëve tanë, aleatëve tanë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

“Kalimi në nivel komande do të sjellë një sërë avantazhesh të rëndësishme, në drejtim të rritjes së efikasitetit operativ dhe të kapaciteteve të mbrojtjes kibernetike dhe komunikimit të sigurt”, - nënvizoi ministri Vengu.

Gjeneralmajor John Phillips, drejtor i Njësisë Kibernetike në Komandën Evropiane të SHBA-ve vlerësoi lart rolin e Shqipërisë si një partnere e besueshme dhe e angazhuar në kuadër të aleancës: “Shqipëria ka treguar angazhim të palëkundur si një

aleate e denjë e NATO-s dhe krijimi i kësaj komande është një hap domethënës në forcimin e arkitekturës së përbashkët të mbrojtjes kibernetike”, - u shpreh gjeneralmajor Phillips.

Nga ana e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, u shpreh: “Krijimi i Komandës së Kibernetikës dhe Ndërlidhjes si pjesë e përmirësimeve strukturore të Forcave të Armatosura për adresim më të mirë të sfidave të mjedisit të sigurisë është një qasje proaktive ndaj karakterit të ndryshueshëm të konflikteve moderne”.

Ai shtoi se, në këtë mjedis të ri operativ, kundërshtarët janë gjithnjë e më të padukshëm dhe, duke shfrytëzuar çdo mundësi që ofron teknologjia, synojnë ndërhyrjen në sistemet e komunikimit, dëmtimin e infrastrukturës kritike, nxitjen e dezinformimit dhe konflikteve, shpesh pa shkreput asnjë armë



të vetme.

Komandanti i ri i Komandës së Kibernetikës dhe Ndërlidhjes së FA-së, gjeneral brigade Hamdi Doda u shpreh i vendosur për ngritjen e një strukture moderne dhe efektive, që do të garantojë sigurinë dhe ndërveprimin në të gjitha nivelet e komandës dhe kontrollit.

Ceremonia u përmbyll me një moment simbolik, ku gjenerallejtënant Kingji i dorëzoi flamurin e strukturës së re ushtarake komandantit të saj, gjeneral brigade Hamdi Doda, duke zyrtarizuar kështu nisjen e funksionimit të kësaj komande të re në përbërje të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.



Ish-reparti ushtarak në Bushat kthehet në Qendër Rajonale të Emergjencave Civile

Ish-reparti ushtarak i Forcave të Armatosura në Bushat po i nënshtrohet një transformimi të rëndësishëm, duke u kthyer në një Qendër Rajonale të Emergjencave Civile, në funksion të përballimit të situatave të jashtëzakonshme dhe fatkeqësive natyrore në veri të vendit.

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, i shoqëruar nga drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako, prefektja e qarkut Shkodër, znj. Majlinda Angoni dhe komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando, zhvilluan një vizitë inspektuese në ambientet e repartit, ku po kryhen punimet për rehabilitimin e tij.

Gjatë inspektimit, ministri Vengu theksoi se ky projekt është pjesë e një iniciative të gjerë të Ministrisë së Mbrojtjes për të rivlerësuar dhe kthyer në funksion civil e ushtarak asetet e amortizuara të Forcave të Armatosura. “Në bashkëpunim me Komandën Mbështetëse, Prefekturën e Shkodrës dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, kemi vendosur që ky ish-repart, i lënë pas dore për vite me radhë, të shndërrohet në një strukturë moderne e të gatshme për t’u përballur me emergjencat natyrore”, - deklaroi ministri.

Qendra e re synon të mbështesë kapacitetet



reaguese të bashkive të Shkodrës dhe Lezhës, me fokus të veçantë në zonën ndërmjet Shëngjinit dhe Velipojës, ku fluksi turistik i shtuar rrit edhe rreziqet potenciale gjatë gjithë vitit. Ajo do të funksionojë si një nyje bashkërendimi për reagimin ndaj zjarreve, përmytjeve dhe fatkeqësive të tjera natyrore.

Ministri Vengu bëri me dije se puna për rehabilitimin ka nisur dhe po zhvillohet falë angazhimit të Komandës Mbështetëse, e cila ka garantuar aksesin dhe përgatitjen e ambientit për zbatimin e projektit.

Kjo qendër rajonale përforcon angazhimin e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Mbrojtjes Civile për një reagim më efikas dhe të koordinuar ndaj emergjencave, si dhe kontribuon në ndërtimin e një infrastrukture moderne në shërbim të sigurisë së komunitetit.

Ministri Vengu: Mbështetja e SHBA-ve, përmes donacioneve në armatim dhe pajisje, gur themeli për modernizimin dhe fuqizimin e kapaciteteve tona operacionale

Forcimi i sigurisë kombëtare është i lidhur kryesisht me trajnimin e vazhdueshëm dhe bashkëpunimin me aleatët tanë strategjikë. Në kuadër të vizitës së përfaqësuesve të Kongresit amerikan, në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore, u zhvillua një demonstrim i qitjes në kushte simulimi nga një skuadër e specializuar, si dhe një ekspozim statik i armatimit, pajisjeve dhe mjeteve të përdorura nga Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë (BKL) dhe Qendra e Mbrojtjes nga Armët e Dëmtimit në Masë (QMADM); nga ku Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, bëri të ditur se: “Mbështetja e vazhdueshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përmes donacioneve në armatim dhe pajisje, është një gur themeli për modernizimin dhe fuqizimin e kapaciteteve tona



operacionale, theksoi Vengu.

Sipas tij, ky partneritet forcon jo vetëm mbrojtjen tonë, por edhe kontributin e Shqipërisë në sigurinë rajonale dhe globale.

Zëvendësministrja e Mbrojtjes, pjesë e NATO Youth Summit 2025

Zëvendësministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. Blerina Abrazhda, së bashku me presidentin e Malit të Zi, z. Jakov Milatović, morën pjesë si të ftuar nderi në NATO Youth Summit 2025, i cili u mbajt në Budva, Mal i Zi.

Zëvendëssekretarja e Përgjithshme e NATO-s, znj. Radmilla Shekerinska, mirëpriti të rinjtë nga e gjithë Aleanca në këtë samit rinor në Budva.

Në fjalën e saj, zëvendësministrja Abrazhda theksoi rëndësinë e sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe rolin kyç të të rinjve në ndërtimin e një të ardhmeje më të sigurt. Ajo theksoi se siguria nuk është thjesht mungesa e konfliktit dhe nuk mund të delegohet, por kërkon investim aktiv në Mbrojtje dhe në institucionet përkatëse. Abrazhda gjithashtu shprehu mirënjohjen ndaj NATO-s për krijimin e një platforme, ku zërat e të rinjve janë në qendër të ndërtimit të sigurisë të së nesërme. NATO Youth Summit 2025 u organizua në bashkëpunim



me Këshillin Atlantik të Malit të Zi dhe mbledhi së bashku liderë të rinj nga vendet anëtare dhe partnere të NATO-s, për të diskutuar çështje kyçe të sigurisë globale, përfshirë rolin e NATO-s në ruajtjen e paqes, ndikimin e teknologjive të reja dhe kërcënimet ndaj informacionit.



Ish-Uzina e Autotraktorëve rikthehet në funksion – Qendër e re për prodhimin ushtarak dhe montimin e mjeteve të specializuara

Ish-Uzina e Autotraktorëve në Tiranë do të rigjallërohet në funksion të Industrisë Ushtarake për prodhimin e uniformave dhe montimin e mjeteve të blinduara, transportuesve të artilerisë, zjarrfikëseve dhe autoambulancave.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, nënvizoi se ish-Uzina e Autotraktorëve do të kthehet në funksion, duke u bërë pjesë e programit për sa i përket industrisë ushtarake shqiptare.

“Uzina e Autotraktorëve në fakt ka qenë një nga ndërmarrjet më të rëndësishme industriale të vendit një simbol i fuqisë mekanike shqiptare të dikurshme. Siç e keni parë në disa lajme që janë bërë publike gjatë këtyre muajve, ne jemi duke realizuar një sërë dëgjësash publike në të gjitha ato ish-Uzina Ushtarake apo mekanike si pjesë e të gjithë përpjekjes së qeverisë shqiptare dhe programit për sa i përket industrisë ushtarake”, - tha Vengu.

Vengu theksoi se gjatë dekadës së fundit buxheti i mbrojtjes është rritur ndjeshëm, duke bërë të mundur edhe përmirësimin e trajtimit financiar të ushtarakëve. Sipas tij, investimet do të mbështesin edhe Policinë e Shtetit dhe Emergjencat Civile.

“Kjo dekadë ka qenë pa dyshim e rritjes së buxheteve ushtarake dhe pikësëpari rritjes së investimeve me një dhjetëfishim të tyre në 10 viteve e fundit. Jo vetëm kaq, rritja e buxheteve të mbrojtjes ka siguruar gjithashtu dhe rritjen e trajtimit financiar të ushtarakëve, përfshirë dhe gjithë komponentët teknikë, inxhinierikë, mekanikë të cilët janë jetësor për sa i përket ambicies tonë për të rijetëzuar industrinë ushtarake në vendin tonë. Dhe arsyeja pse jemi sot së bashku këtu dhe me kolegun e Ministrisë

së Brendshme është se strategjia e qeverisë shqiptare sa herë investojmë në kapacitete ushtarake të mund të mbështesim edhe kapacitet që lidhen me Policinë e Shtetit.

Shihni këtu dy shembuj të prodhimeve Made in Albania nga kompania Timak, me të cilën jemi në bisedime intensive për të realizuar një bashkëpunim sipas ligjit të ri të industrisë ushtarake me qëllimin të mund të mbulojmë ato nevoja të brendshme të forcave të Armatosura të Emergjencave Civile të urgjencave mjekësore dhe padyshim siç e përmendëm edhe të Policisë së Shtetit. Jemi në një sipërmarrje ku shteti shqiptar sa herë do të investojë dhe do të shpenzojë para për të blerë mjete, pajisje dhe industri do ta bëjë këtë duke siguruar që këto blerje, prodhohen këtu, kanë një vlerë të shtuar ekonomike në vendin tonë dhe padyshim prodhojnë punësim dhe ekonomi në komunitete ku këto uzina janë të instaluar”, - tha Vengu. Vengu shtoi më tej se “Uzina e Autotraktorëve bëhet pjesë e një zhvillimi shqiptar së bashku me Rubikun, ku do të montohen sistemet e artilerisë dhe dronëve luftarake, Vlorë me shkollën e aviacionit dhe kantierin detar, Gramshi dhe Poliçani sa i përket armëve dhe municioneve”.

Ministri theksoi në fjalën e tij se në këtë objekt do të kemi prodhim të mjeteve të blinduara.

“Pra një sipërmarrje automekanike të mjeteve të emergjencave civile dhe mjete ambulatorë për sa i përket emergjencave mjekësore, sikundër në godinën nga pas jush do të sigurojmë prodhimin e mjeteve, pajisje personale dhe uniforma, kaq të nevojshme për të gjithë tipologjinë e forcave, qofshin të armatosura apo me objekte ligj zbatuese”, - tha Vengu.



Takim zyrtar në Tiranë: Admirali Pierre Vandier viziton Shqipërinë

FARSH rikonfirmon përkushtimin ndaj vizionit të NATO-s për transformim dhe përshtatje strategjike. Me një pritje zyrtare dhe diskutime të nivelit të lartë, Shqipëria mirëpriti Admiralin Pierre Vandier, Komandantin e Komandës Supreme të NATO-s për Transformim (Allied Command Transformation – ACT), i cili zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë.

Gjatë qëndrimit në Tiranë, Admirali Vandier u prit nga Presidenti i Republikës, Sh.T. z. Bajram Begaj, si dhe nga ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu. Një takim i veçantë u zhvillua gjithashtu me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të (FARSH), gjenerallejtënant Arben Kingji, ku u theksua rëndësia e bashkëpunimit strategjik ndërmjet Shqipërisë dhe strukturave të NATO-s. Diskutimet e zhvilluara u përqendruan në temat kyçe të inovacionit, teknologjisë dhe mësimëve të nxjerra nga sfidat aktuale të sigurisë globale. Palët vlerësuan domosdoshmërinë për një NATO më të aftë të parashikojë dhe t'i përgjigjet në mënyrë efektive ndryshimeve në mjedisin e sigurisë ndërkombëtare. “Forcat e Armatosura të



Republikës së Shqipërisë mbeten të përkushtuara në mbështetje të vizionit të NATO-s për transformim të qëndrueshëm dhe përshtatje të vazhdueshme ndaj sfidave të kohës”, - u shpreh gjenerallejtënant Arben Kingji.

Në përmbyllje të vizitës, iu shpreh mirënjohje Admiral Vandier për mbështetjen e tij të vazhdueshme dhe për vizionin e qartë drejt një Aleance më të bashkuar, më fleksibël dhe të fuqizuar përmes avancimit teknologjik dhe kapaciteteve të reja.



Vizitë e rëndësishme nga Bundestagu gjerman në Ministrinë e Mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes mirëpriti Tilman Kuban, anëtar i Bundestagut gjerman dhe Zëdhënës për Çështjet Evropiane i grupit parlamentar CDU/CSU, si dhe David Preisendanz, deputet dhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Çështjet e Bashkimit Evropian.

Gjatë takimit u diskutua mbi angazhimin e ripërtërirë të Gjermanisë në rajonin e Evropës Juglindore, një angazhim që vjen me një qartësi të re strategjike, e cila luan një rol kyç për procesin e integritetit evropian të Shqipërisë.

Në fokus të bisedimeve ishte siguria, fuqizimi i industrisë së mbrojtjes dhe stabiliteti gjeopolitik në kontinent. Këto sfida tejkalojnë kufijtë kombëtarë dhe kërkojnë një qasje të koordinuar, bashkëpunim të ngushtë ndër-institucional dhe punë në ekip me partnerët tanë ndërkombëtarë.

Vizita e delegacionit gjerman nënvizon rëndësinë që Gjermania i kushton zhvillimeve në Ballkanin Perëndimor dhe mbështetjen e vazhdueshme për Shqipërinë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian.



Kur uniforma laget me dgersë e hi – sakrifica që nuk matet me orë

Në ditët kur flakët përpinë hektarë të tërë pyjesh e kullotash, kur ajri u mbush me tym e hi, forcat e armatosura u gjendën në vijën e parë të frontit. Ata nuk mbanin pushkë, por lopata, pompa uji, dhe mbi të gjitha një vendosmëri të palëkundur për të mbrojtur jetën e njerëzve dhe pasurinë e vendit. Për orë të tëra, shpesh pa pushim, efektivët e ushtrisë përballuan temperatura të larta, terrene të vështira dhe rrezikun e përhershëm të rrethimit nga zjarri. Ata ecën në këmbë për kilometra, bartën pajisje të rënda dhe luftuan me flakët edhe aty ku mjetet e tjera nuk arrinin.

Një nga pamjet më të prekshme ishte ajo e dhjetëra ushtarëve të shtrirë përtokë, në hije, të kapur nga gjumi aty ku lodhja i kishte rrëzuar. Pa çadra, pa komoditet, vetëm uniforma e pluhurosur dhe fytyra

të mbuluara me dgersë e hi. Ishte pushimi i shkurtër mes dy betejave të gjata – një moment i qetësisë mes një lufte pa armë zjarri, por me një armik po aq të pamëshirshëm: zjarrin.

Ky përkushtim nuk është vetëm detyrë, por një shërbim i pastër ndaj atdheut. Në këto ditë të nxehta, ushtria tregoi se gatishmëria e saj nuk kufizohet vetëm në mbrojtjen nga kërcënimet ushtarake, por shtrihet edhe në përballimin e fatkeqësive natyrore.

Në heshtje, pa shumë fjalë e bujë, këta burra dhe gra në uniformë dhanë gjithçka që kishin – forcat e tyre, kohën, madje dhe gjumin – për të siguruar që zjarret të shuheshin dhe njerëzit të ishin të sigurt.

Ky është portreti i vërtetë i sakrificës: jo vetëm në fushëbetejë, por edhe në malet dhe pyjet e përfshira nga flakët.



Operacion i gjerë kërkim-shpëtimi në brigjet jugperëndimore, Forca Ajrore në qendër të ndërhyrjes emergjente

Në kuadër të misionit të saj për siguri dhe reagim emergjent, Forca Ajrore shqiptare është angazhuar në një operacion të gjerë kërkim-shpëtimi, i cili po zhvillohet në brigjet jugperëndimore të vendit. Operacioni po udhëhiqet nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit (RCC Albania), në bashkëpunim të ngushtë ndërinstitucional dhe me mbështetje ndërkombëtare.

Fokusi i operacionit është gjetja e një shtetasi të raportuar si i zhdukur në det nga trageti ndërkombëtar “AKKA”. Për realizimin e këtij misioni, Forca Ajrore ka vënë në dispozicion kapacitete ajrore të specializuara:

- 1 dron “Bayraktar” TB2, i pajisur me sensorë të avancuar dhe sistem transmetimi në kohë reale, për mbikëqyrje të zonave detare të përcaktuara.
- 1 helikopter UH-60, me ekuipazh të trajnuar për ndërhyrje në operacione kërkim-shpëtimi në zona bregdetare dhe në det të hapur.

Mjete ajrore janë angazhuar intensivisht në patrullime dhe kërkime në një hapësirë të gjerë detare që shtrihet nga Kepi i Stillos në jug deri te gryka e Semanit në veri. Operacioni po zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Forcën Detare, Policinë



Kufitare, si dhe me partnerë ndërkombëtarë italianë nga MRCC Roma, MRSC Bari dhe MRSC Venezia.

Pjesëmarrja e Forcës Ajrore në këtë operacion është një tjetër dëshmi e angazhimit të saj të palëkundur për të garantuar sigurinë dhe shpëtimin e jetëve në rrezik, përmes përdorimit të teknologjisë moderne dhe profesionalizmit të efektivëve të saj.

Operacioni vijon në kushte dinamike, me monitorim të vazhdueshëm dhe reagim të menjëhershëm sipas zhvillimeve në terren dhe kushteve detare.

FA angazhon dronë dhe helikopterë për kontrollin e zjarreve në terren

Forca Ajrore shqiptare vijon angazhimin intensiv në operacionet për përballimin e vatrave të zjarrit në disa zona të jugut të vendit, përkatësisht në Poliçan, Mallakastër dhe Finiq, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe emergjencave civile.

Në kuadër të këtij operacioni, janë vënë në funksion kapacitetet ajrore për monitorim dhe ndërhyrje, me qëllim parandalimin e përhapjes së flakëve dhe minimizimin e dëmeve në njerëz dhe pasuri natyrore.

- Droni “Bayraktar” TB2 është aktualisht i angazhuar për vëzhgim dhe monitorim në kohë reale, duke ndihmuar në identifikimin e vatrave aktive të zjarrit dhe duke siguruar të dhëna të detajuara për drejtimin e operacioneve në terren.

- Helikopteri “Blackhawk” (UH-60) ka realizuar dhe vijon të kryejë ndërhyrje direkte nga ajri, me hedhje uji mbi zonat e përfshira nga flakët, veçanërisht në ato zona ku aksesit nga toka është i kufizuar.

Operacionet ajrore kanë një rol vendimtar në koordinimin ndërinstitucional dhe në mbrojtjen e zonave të banuara dhe atyre me rëndësi ekologjike



nga përhapja e mëtejshme e flakëve.

Forca Ajrore mbetet në gatishmëri të plotë dhe angazhim të pandërprerë, duke garantuar mbështetje ajrore efektive përballë çdo situatë emergjente, në funksion të sigurisë publike dhe mbrojtjes së territorit kombëtar.

Forca Ajrore feston 94-vjetorin e Armës Kundërajrore dhe 2-vjetorin e ringritjes së Batalionit GBAD

Në mjediset e Komandës së Forcës Ajrore u zhvillua sot ceremonia solemne në nderim të 94-vjetorit të krijimit të Armës Kundërajrore dhe 2-vjetorit të ringritjes së “Batalionit të Mbrojtjes Ajrore me Bazë në Tokë (GBAD)”. Ky aktivitet përkujtoi një moment historik me rëndësi të veçantë për mbrojtjen ajrore të vendit.

Në ceremoni morën pjesë Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, komandantë të strukturave të varësisë së FAj, si dhe personel ushtarak dhe civil. Atmosfera u karakterizua nga solemniteti dhe ndjenjë krenarie për trashëgiminë dhe misionin e kësaj arme të rëndësishme.

Zv. komandanti i Batalionit GBAD, Nënkolonel Sokol Mehmeti, në fjalën e tij përshëndetëse, solli në vëmendje themelimin e armës, më 1 korrik 1931, me dekret mbretëror nga Mbreti Zog, si një hap vendimtar në konsolidimin e Forcave të Armatosura shqiptare. Ai theksoi rëndësinë e ringritjes së strukturës GBAD në vitin 2022, si pjesë e përpjekjeve për rritjen e kapaciteteve mbrojtëse në përputhje me standardet e NATO-s.

Gjeneralmajor Ferdinand Dimo, në përshëndetjen e tij, vlerësoi kontributin e të gjithë atyre që kanë shërbyer në këtë armë ndër vite, duke e cilësuar mbrojtjen ajrore si një shtyllë kyçe të sigurisë kombëtare dhe kolektive. Ai nënvizoi rëndësinë e vazhimit të modernizimit, përfshirë projektin e



sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës ajrore – një investim strategjik për mbrojtjen e vendit dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare.

Ky përvjetor i dyfishtë është një homazh për historinë dhe një angazhim për të ardhmen, duke konfirmuar misionin e Forcës Ajrore për të garantuar sigurinë e hapësirës ajrore të Shqipërisë dhe për të kontribuar në mbrojtjen kolektive të aleatëve.



FAj, pjesë e stërvitjes “Flood North Albania”

Në kuadër të operacionit stërvitor ndërkombëtar “Flood North Albania”, të zhvilluar për një periudhë 3 - ditore në rajonin e Shkodrës, Forca Ajrore pati kontributin e saj në bashkëpunim të ngushtë me AKMC dhe me strukturat qendrore dhe lokale, për ardhjen në ndihmë të popullsisë së bllokuar nga përmbytjet ku rruga e vetme për shpëtimin e tyre ishte evakuimi nga ajri.

Forca Ajrore në këtë stërvitje u angazhua me 3 helikopterë, “Cougar” dhe “Black Hawk”, si dhe me një personel prej 15 vetash, duke realizuar demonstrime sipas skenarëve të stërvitjes, që pasqyronin sfidat reale në raste fatkeqësish natyrore.

U zhvilluan demonstrime që përfshinin operacione shpëtimi për banorët e izoluar nga uji, duke u ndërmarrë dhe veprime për evakuim, si dhe operacione të kërkim - shpëtimit të personave të humbur, ose që mund t'i ketë marrë rrjedha e ujit.

Përmes këtyre skenarëve u synua testimi i kapaciteteve, rëndësia e veprimit të përbashkët në situata emergjente, si dhe reagimi i shpejtë dhe i sinkronizuar për të shpëtuar jetë dhe mbrojtur komunitetin.



Forca Ajrore, në vijë të parë kundër zjarreve: Vlerësim për përkushtimin dhe kontributin vendimtar në operacionet ajrore

Përballë situatës së vështirë të krijuar nga përhapja e vatrave të zjarrit në disa rajone të vendit, Forca Ajrore e Republikës së Shqipërisë ka luajtur një rol vendimtar në menaxhimin dhe shuarjen e emergjencave. Misionet ajrore kanë qenë të pandërprera, me qëllim mbështetjen e forcave tokësore në zonat malore dhe të paarritshme, ku ndërhyrja nga toka është thuajse e pamundur.

Kreu i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako, ka vlerësuar lart kontributin e Forcës Ajrore, duke shprehur një falënderim të veçantë për komandantin e Bazës Ajrore të Farkës, nënkolonel Ervin Buzi dhe gjithë stafin ajror të angazhuar pa ndërprerje në operacione: “Falënderim i veçantë për Forcën Ajrore të Shqipërisë, për nënkolonel Ervin Buzin dhe ekipin e Bazës Ajrore të Farkës, të cilët me përkushtim, profesionalizëm dhe sakrificë janë gjendur në çdo moment në mbështetje të qytetarëve dhe strukturave operacionale në terren. Angazhimi i tyre ka qenë vendimtar në menaxhimin e situatave më kritike”, – deklaroi z. Çako. Komandanti i Bazës Ajrore, nënkolonel Ervin Buzi, theksoi se gatishmëria ka qenë maksimale, pavarësisht kushteve të vështira të fluturimit dhe lodhjes së akumuluar nga operacionet e vazhdueshme: “Ekipet tona kanë qenë në gatishmëri të vazhdueshme, të gatshme për ndërhyrje në çdo moment, pavarësisht kushteve të vështira dhe lodhjes. Ky është misioni ynë – të jemi aty ku nevojitet, orë pa orar”. Në kuadër të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian, Shqipëria përfitoi gjithashtu mbështetje nga



vendet partnere. Hungaria kontribuoi me helikopterë për operacionet nga ajri, duke dëshmuar solidaritet dhe reagim të shpejtë përballë situatës emergjente. Misioni i tyre në Shqipëri përfundoi me sukses, duke u vlerësuar nga autoritetet shqiptare për ndihmën konkrete dhe bashkëpunimin e frytshëm.

Ky operacion nxori në pah jo vetëm angazhimin e jashtëzakonshëm të Forcës Ajrore shqiptare, por edhe bashkëpunimin efikas ndërkombëtar në kuadër të mbrojtjes civile, duke forcuar kapacitetet dhe gatishmërinë për përballimin e emergjencave të natyrës në të ardhmen.

Forca Ajrore, në mision të pandërprerë për shuarjen e zjarreve: Bashkëpunim i ngushtë me strukturat vendore dhe partnerët ndërkombëtarë

Forca Ajrore e Republikës së Shqipërisë vijon pa ndërprerje angazhimin në operacionet ajrore për përballimin e situatës së krijuar nga vatrat e zjarrit që kanë përfshirë disa zona të vendit. Në koordinim të ngushtë me strukturat e Mbrojtjes Civile, Forcat e Armatosura, autoritetet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë, misionet ajrore janë duke u zhvilluar me intensitet të lartë dhe në kushte të vështira.

Dy helikopterë të Forcës Ajrore u përfshinë në operacionet në zonat e Borshit, Piqerasit dhe Sasajt, ku për shkak të erërave të forta, flakët janë përhapur me shpejtësi, duke rrezikuar banesa dhe struktura ekonomike. Ndërhyrja nga ajri ka synuar frenimin dhe izolimin e përhapjes së mëtejshme të zjarrit në një territor me rëndësi të veçantë për turizmin dhe komunitetin lokal. Operacionet janë kryer në kushte të vështira terreni dhe moti, me përkushtim të lartë nga ekipet ajrore. Po ashtu, helikopterë të Forcës Ajrore janë angazhuar edhe në zona të tjera problematike si Zhulati, në qarkun Gjirokastrë, dhe Qafa e Buallit, pranë Bulqizës, në bashkërendim me forcat tokësore dhe njësitë zjarrfikëse. Në kuadër të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian, Shqipëria ka përfituar ndihmë nga partnerët ndërkombëtarë. Një avion zjarrfikës i tipit “Canadair” CL-415, i dërguar nga Italia, ka mbërritur dhe është aktivizuar në jug të vendit, veçanërisht në segmentet malore të Borshit dhe Lukovës, ku ndërhyrja ajrore ishte jetike për mbrojtjen e zonave të banuara.

Ndërhyrjet ajrore u zhvilluan në koordinim të ngushtë me strukturat tokësore të emergjencave civile, autoritetet vendore dhe zjarrfikësit në zonat



më të prekura si Rrëshen, Mirditë dhe Bulqizë. Ky bashkëpunim ndërinstitucional siguroi një reagim të unifikuar dhe efikas, duke bërë të mundur ndërhyrjen e menjëhershme nga ajri në mbështetje të përpjekjeve nga toka. Forca Ajrore mbetet e angazhuar maksimalisht në misionin e saj për garantimin e sigurisë publike dhe përkrahjen e operacioneve të mbrojtjes civile. Kapacitetet ajrore janë vënë në dispozicion të emergjencave në çdo moment, duke përmbyshur detyrën me përkushtim dhe profesionalizëm. Pilotët dhe ekuipazhet ajrore të Forcës Ajrore demonstrojnë guxim dhe vendosmëri, duke operuar pa orar në kushte të vështira, për të mbrojtur jetën, pronën dhe natyrën e vendit tonë. Përmes këtij angazhimi të jashtëzakonshëm, Forca Ajrore dëshmon rolin thelbësor në arkitekturën e reagimit emergjent në Shqipëri.



Gjeneralmajor Duke Pirak, drejtor në Detyrë i Forcave Ajrore të Gardës Kombëtare të SHBA, vizitoi Bazën Ajrore të Kuçovës

Gjeneralmajor Duke Pirak, drejtor në detyrë i Forcave Ajrore të Gardës Kombëtare të SHBA-së, zhvilloi një vizitë njëditore në Bazën Ajrore Kuçovë. Gjenerali amerikan u prit nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Luan Sadiku, dhe komandanti i Bazës Ajrore të Kuçovës, kolonel Ardian Kuli. Gjatë vizitës ai dhe ekipi që kryesonte u shoqëruan nga zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Altin Kurti. Në fokus të diskutimeve ishin kapacitetet aktuale që ofron Baza Ajrore Kuçovë, projektet për modernizimin e bazës në sistemet e navigimit e të komunikimit ajror me qëllim krijimin e Kapaciteteve fillestare operacionale si një bazë taktike e NATO-s, në përputhje me standardet më të larta të aleancës.

Vizita konfirmoi rëndësinë e Kuçovës si një aset strategjik, jo vetëm për mbrojtjen kombëtare, por edhe për rolin e saj në rrjetin operativ të NATO-s. Ky bashkëpunim dëshmon përkushtimin e palëve për avancimin e kapaciteteve dhe garantimin e një mjedisi më të sigurt në rajon.



Stërvitja fushore/ujore e Batalionit të Forcave Speciale të Regjimentit të Operacioneve Speciale, e koduar “Mburoja Ilire 50-25”, u zhvillua në rajonin stërvitor të Distriktit Detar Jugor, në Pashaliman, me synim zhvillimin e kapaciteteve për operacione speciale ujore dhe nënujore, nëpërmjet ndërthurjes së veprimeve tokësore, detare dhe ajrore.





Pesë Vite Akreditim për Akademinë e Forcave të Armatosura, një Dëshmi e Ekselencës në Arsimin Ushtarak Shqiptar

Akademia e Forcave të Armatosura është akredituar institucionalisht për një periudhë pesëvjeçare, sipas vendimit të fundit të Bordit të Akreditimit. Ky vlerësim i rëndësishëm për arsimin e lartë shqiptar konfirmon përmbushjen e standardeve akademike dhe administrative nga kjo akademi ushtarake.

Ky zhvillim përbën një dëshmi të qartë të përkushtimit të AFA-së për të garantuar cilësi në arsimin ushtarak dhe në kërkimin shkencor, duke synuar përgatitjen sa më të mirë të studentëve dhe oficerëve të ardhshëm të Forcave të Armatosura.

Akreditimi pesëvjeçar jo vetëm që rrit besueshmërinë institucionale, por njëkohësisht thekson angazhimin për zhvillim profesional në përputhje me sfidat bashkëkohore të sigurisë dhe mbrojtjes. Kjo është një arritje



domethënëse për AFA-në dhe një hap përpara në konsolidimin e saj si institucion i arsimit të lartë ushtarak në vend.

PËRFUNDON ME SUKSES STËRVITJA “ÇAKALLA 05-2025”

Kursi i 83-të fillestar i nënoficerit përmbylli me sukses stërvitjen komplekse 24-orëshe të koduar “Çakalla 05-2025”. Pas 5 javësh trajnim intensiv në përgatitje Fizike, Lidership, Zjarr dhe Shërbim Luftarak të Trupave, kursantët treguan aftësitë e tyre si drejtues grupi në kushtet e një skenari të vështirë taktik.

Kjo stërvitje finalizoi gjithë njohuritë e përfituara dhe u ndoq nga afër nga Zv/ Komandanti i Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerit dhe instruktorët e Akademisë.



SUKSES I AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA NË “HALF MARATHON KUKËS 2025”: VEND I PARË DHE RENDITJE DINJITOZE NË GARAT 10 KM DHE 21 KM

Në kuadër të promovimit të sportit dhe jetës aktive, një ekip përfaqësues nga Akademia e Forcave të Armatosura, mori pjesë në edicionin e parë të “Half Marathon Kukës 2025”, me gara në distancat 21 km dhe 10 km. Nënkolonel Bledar Mesi u shpall fitues i vendit të parë në garën 10 km dhe studentja Anita Popa u rendit në vendin e katërt në garën 21 km. Ky përfaqësim pasqyron përkushtimin, disiplinën dhe nivelin e lartë të përgatitjes fizike që karakterizojnë personelin dhe studentët e Akademisë së Forcave të Armatosura.



Stërvitja "Defender Europe 25"

Operacion i përbashkët detar në Gjirin e Durrësit

Në kuadër të stërvitjes shumëkombëshe "Defender Europe 25", në Gjirin e Durrësit u zhvillua një demonstrim i operacioneve të ndalimit detar (MIO), me pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Detare të SHBA-së.

Stërvitja u ndoq nga komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetar, nënadmiral Adnand Agastra, komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, komandant i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo!

Operacioni simuloi ndalimin, marrjen në kontroll, inspektimin dhe shoqërimin e një anijeje të dyshuar. Mjetet detare shqiptare, në bashkëpunim me ato të SHBA-së, kryen ndalimin e anijes, ndërsa skuadra e Regjimentit të Operacioneve Speciale realizoi bordimin vertikal përmes helikopterëve të Forcës Ajrore. Pas marrjes në kontroll të objektivit, veprimet vijuan me grupin e bordimit të Forcës Detare, i cili, pas inspektimit të hollësishëm, shoqëroi anijen drejt portit.

E gjithë ndërhyrja u mbikëqyr nga dronë të Forcës Ajrore, të cilët transmetuan pamje live në Shtabin e Brigadës Shumëkombëshe

në Zall-Herr, duke garantuar një ndërveprim të përkryer ndërmjet strukturave pjesëmarrëse.

Ky demonstrim tregoi edhe një herë nivelin e lartë të ndërveprueshmërisë së Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me flotën e SHBA-së për garantimin e sigurisë detare në kuadër të operacioneve të përbashkëta.



Anija “Oriku” e Forcës Detare, në stërvitjen ndërkombëtare “Adrion Livex 25” në Mal të Zi

TIVAT, MAL I ZI – Anija patrulluese “Oriku” e Forcës Detare/Rojës Bregdetare të Republikës së Shqipërisë mori pjesë në stërvitjen ndërkombëtare “Adrion Livex 25”, e zhvilluar në ujërat territoriale të Malit të Zi.

Kjo stërvitje, e përvitshme dhe me karakter shumëpalësh, kishte për qëllim rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe ndërveprueshmërisë midis forcave detare të vendeve pjesëmarrëse në fushat e sigurisë detare, zbatimit të ligjshmërisë në det, operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe sigurisë së lundrimit. Në këtë aktivitet morën pjesë gjashtë shtete të rajonit të Adriatikut dhe Jonit, të cilat kontribuan me njësi detare dhe personel të specializuar. Stërvitja u zhvillua në dy faza të veçanta: faza përgatitore në port dhe faza taktike në det të hapur, ku ekuipazhet trajtuan skenarë realistë që përfshinin operacione bordimi, reagim ndaj kërcënimeve asimetrike,

luftë kundër zjarrit dhe menaxhim të situatave emergjente me hyrje uji në bord.

Gjatë Ditës së Vizitorëve të Shquar (Distinguished Visitors Day), komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare të Shqipërisë, nënadmiralet Adnand Agastra, mori pjesë në aktivitetet zyrtare së bashku me përfaqësues të lartë ushtarakë nga vendet pjesëmarrëse. Në kuadër të këtij takimi, nënadmiralet Agastra zhvilloi një takim me kryetarin e Bashkisë së Tivatit, ku u diskutua mbi rëndësinë e bashkëpunimit civil-ushtarak dhe rolin e aktiviteteve të përbashkëta për forcimin e sigurisë në rajon.

Pjesëmarrja e anijes “Oriku” në këtë stërvitje ndërkombëtare dëshmon edhe një herë angazhimin e Shqipërisë për sigurinë detare, si dhe përforcon rolin aktiv të Forcës Detare në kuadër të aleancës dhe partneritetit me vendet anëtare të NATO-s dhe ato partnere në rajon.



Anija 'Lissus' dhe ekuipazhi i saj nisen nga Saranda drejt operacionit 'Sea Guardian', pas një historie suksesi me dhjetëra operacione shpëtimi

Forcat e Armatosura të Shqipërisë vijojnë të mbajnë me profesionalizëm dhe përkushtim peshën e përgjegjësisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut, duke kontribuar në sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare. Nga baza detare e Sarandës, anija "Lissus" me 22 detarë në bord është nisur drejt Detit Egje, ku për një periudhë 6-mujore do të shërbejë në kuadër të operacionit të NATO-s "Sea Guardian". Ky mision ka për qëllim rritjen e sigurisë detare në Mesdhe dhe parandalimin e kërcënimeve të ndryshme në hapësirat ujore.

Me këtë rast, ministri i Mbrojtjes vizitoi

ekui-pazhin shqiptar, duke përcjellë urimet për një mision të suksesshëm dhe duke vlerësuar profesionalizmin e trupës detare, të udhëhequr nga kapiteni Jetnor Balla.

Vetëm gjatë këtij viti, ekuipazhet shqiptare kanë kryer 5 operacione të suksesshme në Egje, duke shpëtuar mbi 120 jetë. Në total, misionet e Forcave të Armatosura shqiptare në këtë zonë kanë realizuar 29 operacione shpëtimi, duke shpëtuar mbi 700 persona në det. Nisja e "Lissus" shënon një tjetër dëshmi të angazhimit të Shqipërisë në misionet ndërkombëtare dhe të kontributit të saj të çmuar në Aleancë.



Stërvitjet "Durrësi SAREX 25" & "Redoni Blu 25"

Nën drejtimin e Forcës Detare/Rojës Bregdetare në bashkëpunim dhe me strukturat shtetërore me detyrime në fushën e kërkim-shpëtimit dhe reagimit ndaj ndotjeve në det u zhvilluan me sukses stërvitjet "Durrësi SAREX 25" dhe "Redoni Blu 2025" në rajonin Durrës-Kepi i Palit.

Qëllimi i stërvitjeve ishte testimi i kapaciteteve operacionale, rritja e ndërveprueshmërisë në situata emergjente dhe demonstrimi i gatishmërisë për operacione kërkim-shpëtimi dhe përballimin e ndotjeve detare. Në stërvitje u angazhuan mjete detare, ajrore dhe tokësore të Forcës Detare, Forcës

Ajrore, Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, Autoritetit Portual Durrës, Policisë Kufitare dhe institucione të tjera që kontribuan me personel dhe pajisje mbështetëse. Gjatë zhvillimit të Ditës së Vizitorëve të Shquar, me pjesëmarrjen e autoriteteve të larta civile dhe ushtarake, komandanti i Forcës Detare nënadmiralet Adnand Agastra vlerësoi angazhimin, profesionalizmin dhe bashkëpunimin institucional si dëshmi i kapaciteteve për përballimin e sfidave detare në kohë reale. Forca Detare mbetet një faktor kyç për sigurinë kombëtare detare dhe reagimin e koordinuar ndaj emergjencave në hapësirën detare të Shqipërisë.

Forca Tokësore nis Kontingjentin KFOR - 3 në Kosovë

Forca Tokësore nisi Kontingjentin KFOR - 3 në Kosovë, për përcjelljen e trupave nga Batalioni i Këmbësoresisë së Lehtë (bkl), të cilët do të shërbejnë në KFOR, si pjesë e misionit të NATO-s. Me këtë rast u organizua një ceremoni në të cilën mori pjesë shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Ilirjan Dauti, i cili pasi u uroi suksese, ndër të tjera vuri theksin në zbatimin e detyrës me rigorozitet dhe përfaqësimin dinjitoz të Shqipërisë, tashmë si një prodhuese e mbrojtëse e sigurisë në rajon e më gjerë.

Të pranishmit, i përshëndeti në emër të kontingjentit, komandanti i kontingjentit, kapiten Erind Pashaj, i cili pasi falënderoi për besimin e treguar i siguroi ata se misionin që iu është ngarkuar, do ta kryejnë me devotshmëri dhe korrektesë në çdo drejtim.

Me nisjen e këtij kontingjenti, Forca Tokësore



shton kontributet e saj në interes të paqes dhe sigurisë rajonale së bashku me aleatët tanë ndërkombëtarë, në përfaqësimin sa më denjësisht të Forcave tona të Armatosura.

Trupat e Regjimentit të Këmbësoresisë së Jugut nisen për mision në Kosovë

Në ambientet e Garnizonit të Këmbësoresisë së Jugut u zhvillua një ceremoni solemne me rastin e nisjes së kontingjentit të këtij regjimenti, i cili do të shërbejë në përbërje të kompanisë italiane në kuadër të Batalionit Kinetik të Komandës Rajonale Perëndimore (RC-W) në Pejë, Kosovë.

Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Regjimentit të Këmbësoresisë së Jugut, kolonel Gëzim Marku, zëvendëskomandanti nënkolonel Agron Muka, familjarë të efektivëve dhe përfaqësues të tjerë të strukturave ushtarake.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kolonel Marku vlerësoi profesionalizmin, përkushtimin dhe seriozitetin e trupave që nisen drejt misionit ndërkombëtar. “Jam i bindur në suksesin e misionit tuaj, bindje të cilën e mbështes në njohjen e aftësive tuaja profesionale, përkushtimin dhe seriozitetin e treguar gjatë gjithë ciklit stërvitor para dislokues, veçanërisht në rajonin stërvitor të Bizës gjatë stërvitjes ‘Immediate Response/Defender Europe-25’”, - theksoi ai.

Kolonel Marku garantoj mbështetje të plotë për personelin në mision, duke theksuar se komanda e regjimentit do të jetë gjithmonë pranë tyre për çdo shqetësim apo nevojë, me qëllim lehtësimin e detyrës së tyre. Fjalën e tij e mbajti edhe komandanti



i kontingjentit, toger Maringlen Tomani, i cili falënderoi eprorët për besimin e dhënë dhe siguroi të pranishmit se misioni do të përmbushet me përkushtim të lartë dhe profesionalizëm.

Ky dislokim përbën një tjetër dëshmi të angazhimit të Forcës Tokësore në operacionet ndërkombëtare të sigurisë dhe paqes, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e NATO-s, duke rritur kontributin e saj në promovimin e paqes dhe stabilitetit rajonal.



Kontingjenti II shqiptar niset drejt Bosnjës dhe Hercegovinës në kuadër të misionit “ALTHEA 2”

Regjimenti i Mbrojtjes me Luftim, Forca Tokësore – Në një ceremoni zyrtare të mbajtur në ambientet e Regjimentit të Mbrojtjes me Luftim të Forcës Tokësore, është përcjellë kontingjenti i dytë shqiptar që do të marrë pjesë në misionin ndërkombëtar “ALTHEA 2” në Bosnje dhe Hercegovinë. Ceremonia u zhvillua në prani të zëvendëskomandantit të Forcës Tokësore, gjeneral brigade Vehbije Kuti, dhe shefit të Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes, kolonel Blodinel Tafa. Në fjalën e mbajtur me këtë rast, gjeneral brigade Kuti vlerësoi pjesëmarrjen e vazhdueshme të Forcave të Armatosura në misione ndërkombëtare si një dëshmi e përkushtimit dhe profesionalizmit të ushtarakëve shqiptarë.

“Pjesëmarrja në këtë mision nuk është vetëm një detyrë, por edhe një përgjegjësi. Ju mbartni me vete jo vetëm uniformën që përfaqëson Forcat tona të Armatosura, por edhe vlerat më të larta të vendit tonë: përkushtimin dhe profesionalizmin për të kontribuar në rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në rajon e më gjerë”, - theksoi gjeneral Kuti. Ai shtoi se ndonëse të qenët larg familjes është një sfidë, krenaria që ato ndiejnë për këtë përfaqësim e tejkalon çdo fjalë.

Kontingjenti i dytë shqiptar përbëhet nga një togë ushtarake, përfshirë katër vajza, të cilët do të shërbejnë për një periudhë prej rreth gjashtë muajsh në Camp Butmir, Sarajevë. Ky angazhim është vazhdim i kontributit të nisur në shkurt të këtij viti, kur



Shqipëria mori pjesë për herë të parë në operacionin “ALTHEA 2”, një mision i Bashkimit Evropian për mbështetjen e paqes dhe sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë.

Ky përfaqësim i radhës tregon për angazhimin serioz të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë kolektive, si dhe për fuqizimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë.



Komandot shqiptare testojnë aftësitë në një stërvitje të avancuar taktike “Mburoja Ilire 45-25”

Efektivët e Batalionit Komando, pjesë e Regjimentit të Operacioneve Speciale, kanë zhvilluar një stërvitje intensive në kuadër të ushtrimit gjithëpërfshirës “Mburoja Ilire 45-25”, i zhvilluar në rajonin stërvitor të Distriktit Detar Jugor, në Pashaliman.

Ky ushtrim synonte testimin dhe forcimin e kapaciteteve ndërhjësore në operacione të ndërlikuara taktike. Përmes një strukture të integruar veprimi, janë kombinuar me sukses komponentët tokësorë, detarë dhe ajrorë. Skema e stërvitjes ka përfshirë skenarë realistë si zhytje taktike, lëvizje nënujore, zbarkim amfib dhe ndërhyrje në zona të izoluar dhe me vështirësi të lartë operacionale.

Qëllimi kryesor i kësaj stërvitjeje ishte rritja e aftësive të Forcave Speciale për të vepruar në mjedise ujore dhe nënujore, si dhe përdorimi i taktikave të avancuara për operacione të specializuara.

Përmes këtij ushtrimi, Forcat Speciale konfirmojnë edhe një herë përkushtimin, përgatitjen dhe profesionalizmin që i karakterizon në çdo mision. Motoja “Komandot veprojnë të parët – në çdo terren, në çdo thellësi” përmbushet çdo ditë nëpërmjet disiplinës dhe vendosmërisë së tyre për të qenë gjithmonë në pararojë të sigurisë dhe të mbrojtjes kombëtare.



Qendra e Simulimit të Qitjeve me Armët e Këmbësorisë, një kapacitet i ri në Forcën Tokësore

Në Qendrën Stërvitore të Komandës së Forcës Tokësore përfundoi Kursi i Instruktorëve për Përdorimin e Simulatorit të Qitjeve me Armët e Këmbësorisë.

Ky simulator, i prokuruar përmes ODC me programin FMS (Foreign Military Sales), përfaqëson një kapacitet të ri për Forcën Tokësore.

Në demonstrimin e përfundimit të këtij trajnimi, ku u certifikuan 3 instruktorë, morën pjesë një ekip nga Zyra Amerikane e Bashkëpunimit për Mbrojtjen si dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia.

Gjeneralmajor Xhebexhia, pasi falënderoi specialistët amerikanë për montimin dhe trajnimin e përdorimit të këtij simulatori, theksoi përfitimet e rëndësishme që



sjell ky kapacitet i ri në trajnimin e efektivëve, duke ndihmuar në krijimin dhe ruajtjen e aftësive në qitjet luftarake.



Kontingjenti XVII EOD, merr detyrën në kuadër të misionit të Prezencës së Përparuar të Përforcuar pas transferimit të komandës dhe autoritetit nga Kontingjenti XVI

Efektivët e Kontingjentit XVI kanë realizuar me sukses detyra të rëndësishme, duke marrë pjesë në stërvitje të tilla si “Resolute Warrior”, “OAK Resolve 25-01”, duke mbështetur me operacione EOD të gjitha njësitë e brigadës shumëkombëshe.

Drejtuesit më të lartë të brigadës shumëkombëshe kanë vlerësuar me certifikata mirënjohje efektivat

tanë për profesionalizmin, angazhimin dhe lidhshmërinë dhe dëshmuar gjatë këtij misioni.

Stafetën e merr tashmë Kontingjenti i XVII, i cili me përkushtim dhe gatishmëri merr përsipër realizimin e detyrave komplekse dhe jetike, që lidhen me ruajtjen e jetës së personelit dhe sigurimin e vijueshmërisë së operacioneve ndërkombëtare.

Forcat xheniere ndërhyjnë për pastrimin e sipërfaqes detare pranë portit të Durrësit nga municionet e rrezikshme



Një ekip xhenierësh të Kompanisë EOD, janë angazhuar në operacion në mbështetje të autoriteteve civile në bashkinë Durrës për kërkimin dhe largimin e municioneve të rrezikshme.

Në bashkëpunim me ekipin e zhytësve të Forcës Detare, operatorët EOD kanë zbuluar pranë zonës së portit të Durrësit dhe më pas kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me manualët EOD, duke vlerësuar municionet tip predha mortaje tërhmuese të periudhës së Luftës së Dytë Botërore, si të prekshme dhe të lëvizshme.

Municionet e identifikuar u magazinuan në ambientet e përcaktuara në Batalionin e Xhenios.

Specialistët EOD realizojë detyra të rëndësishme jo vetëm për pastrimin e sipërfaqeve tokësore por dhe atyre detare, duke përbushur me profesionalizëm misionin e tyre.

Përfundon operacioni EOD në mbështetje të Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut

Efektivët e Komandës Mbështetëse, realizuan një tjetër detyrë të rëndësishme duke mbështetur strukturat e Forcave të Armatosura me operacione për vlerësimin dhe asgjësimin e municioneve.

Në mbështetje të Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut, efektivë të Kompanisë EOD të kompletuar me pajisje speciale, u angazhuan në asgjësimin e municioneve të hedhura dhe të paplasura në poligonin e qitjeve Mnelë. Veprimet profesionale bënë të mundur sigurimin e poligonit dhe zonës përreth, duke e shndërruar në një rajon të sigurt për realizimin e stërvitjeve të mëtejshme.

Komanda Mbështetëse, me kapacitetet e saj operacionale mbetet një strukturë e rëndësishme për kryerjen me sukses të operacioneve jo vetëm në mbështetje të popullsisë civile por dhe strukturave të tjera ushtarake.



Montim i suksesshëm i urës "Bailey" në vetëm 8 ditë, përmirësohet ndërlidhja e katër fshatrave

Perlat, Laç, Bruc dhe Lufaj përfitojnë nga ndërhyrja e Batalionit të Xhenios

Brenda një afati prej vetëm 8 ditësh, kompania e urave e Batalionit të Xhenios ka përfunduar me sukses montimin e një ure të tipit "Bailey", me gjatësi 21 metra, seksion 2/1 dhe kapacitet mbajtës deri në 44 tonë.

Projekti përfshiu të gjithë ciklin teknik dhe logjistik: nga transportimi i pajisjeve, montimi në terren, e deri te kthimi i tyre në repart, duke dëshmuar efikasitetin dhe përkushtimin e strukturave të

Forcave të Armatosura.

Ura e re pritet të përmirësojë ndjeshëm qarkullimin dhe aksesin për rreth 750 banorë të fshatrave Perlat, Laç, Bruc dhe Lufaj, duke i ndërlidhur ata më lehtë me qendrat urbane dhe shërbimet bazë.

Kjo ndërhyrje përbën një tjetër shembull konkret të mbështetjes që Forcat e Armatosura japin për komunitetin, veçanërisht në zonat e thella, ku nevojat infrastrukturore janë të larta dhe ndërhyrjet e tilla kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të banorëve.



Forca Tokësore përmirëson kapacitetet në përdorimin e UAV-ve në bashkëpunim me Gardën Kombëtare të New Jersey-it

Në kuadër të zbatimit të planit të bashkëpunimit dypalësh mes Gardës Kombëtare të New Jersey-it (GKNJ) dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë, është zhvilluar një trajnim i avancuar me fokus përdorimin e mjeteve ajrore pa pilot (UAV), një komponent kyç në kapacitetet moderne të inteligjencës dhe mbështetjes taktike.

Trajnimi u zhvillua në garnizonet ushtarake të Zall-Herriit dhe Bazës Ajrore të Kuçovës, ku personeli i Forcës Tokësore, konkretisht nga batalioni i këmbësorisë së lehtë (bkl) dhe Regjimenti i Operacioneve Speciale (ROS), u trajnuan nga instruktorë amerikanë të Gardës Kombëtare të New Jersey-it.

Pjesëmarrësit u njohën me teknikat më të avancuara të planëzimit operacional dhe kryerjes së detyrave të zbulimit, vëzhgimit dhe zbulimit të objektivave (ISR) përmes sistemeve UAV, tashmë një aftësi shumë e rëndësishme e Forcës Tokësore në fushën e inteligjencës ushtarake.

Gjatë trajnimit, efektivat punuan në kushte të ndryshme atmosferike, përfshirë temperatura të larta, duke simuluar skenarë realë operacionalë për përdorimin e UAV-ve në situata komplekse. Trajnimi përfshiu gjithashtu përgatitjen, realizimin dhe përbushjen e plotë të procesit operacional, duke prodhuar produkte konkrete informative nga fluturimet dhe misionet e simuluar.



Kjo iniciativë shënon një hap të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura në përdorimin e teknologjive të reja, duke kontribuar në një ndërveprim më të efektshëm dhe të denjë me strukturat homologe të vendeve partnere dhe aleate të NATO-s. Po ashtu, përgatitja e personelit në këto fusha ndikon drejtpërdrejt edhe në përmirësimin e reagimit ndaj emergjencave civile, përmes përdorimit të mjeteve ajrore pa pilot për monitorim dhe menaxhim të situatave kritike. Niveli i lartë i arritur gjatë këtij trajnimi konfirmon përkushtimin e Forcës Tokësore për të ndërtuar dhe zhvilluar më tej aftësitë moderne në fushën e operacioneve inteligjente dhe të sigurisë kombëtare.

Baza e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile mori pjesë në stërvitjen "Flood North Albania 25"

Efektivët e Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile u angazhuan në kuadër të stërvitjes ndërkombëtare "Flood North ALB 2025", e cila u zhvillua në qarkun Shkodër.

Ekipi i BMEC i përbërë nga 40 efektivë, u përfaqësua denjësisht në këtë stërvitje krah ekipeve të gjashtë shteteve të huaja pjesëmarrëse.

Qëllimi i stërvitjes ishte testimi i kapaciteteve të ekipeve të kërkim-shpëtimit, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimi i koordinimit mes strukturave vendore, qendrore dhe ndërkombëtare, në përputhje me mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Europian.

Gjatë stërvitjes efektivët tanë realizuan skenarë të ndryshëm për përballimin e situatave në rast përmytje, duke demonstruar përgatitje të lartë profesionale dhe zotërimin e kapaciteteve të duhura për të mbështetur autoritetet e emergjencave civile.

Personeli i BMEC ndër të tjera punoi për ngritjen

e rajonit të fushimit për 250 trupa pjesëmarrës, me të gjitha kapacitetet mbështetëse të nevojshme.



Grupet EOD të Batalionit të Xhenios përfundojnë me sukses operacionet për largimin e municioneve në Durrës dhe Lushnjë

Specialistët e Kompanisë EOD të Batalionit të Xhenios, përfunduar me sukses operacionet xheniere për vlerësimin dhe largimin e municioneve të identifikuara në territorin e bashkive Durrës dhe Lushnjë.

Në zonën pranë portit të Durrësit, një ekip specialistësh EOD, duke zbatuar të gjitha masat e sigurisë, ka kryer identifikimin dhe vlerësimin e disa bombave të aviacionit gjysmë blind-shpuese. Pas analizës teknike, municionet janë klasifikuar si të prekshme dhe janë transportuar në mënyrë të sigurt drejt ambienteve të posaçme të Batalionit të Xhenios për trajtim të mëtejshëm.

Ndërkohë, një tjetër operacion është kryer në fshatin Stan, njësi administrative Karbunarë, bashkia Lushnjë, ku operatorët EOD identifikuan dhe klasifikuan municione të tipit predha artilerie dhe predha topi të kalibrave të ndryshëm. Pas vlerësimit teknik, u konstatua se municionet ishin të lëvizshme dhe u transportuan për magazinimin të sigurt në ambientet e caktuara nga Forcat e Ar-



matosura.

Pastrimi i territorit nga municionet e rrezikshme mbetet një sfidë e përditshme për efektivitetin e Kompanisë EOD, të cilët me profesionalizëm dhe përkushtim kontribuojnë në rritjen e sigurisë së komuniteteve dhe mjedisit.

Xhenierët shqiptarë në stërvitje shumëkombëshe në Letoni

Xhenierë nga Shqipëria, së bashku me kolegët e tyre nga Mbretëria e Bashkuar, Kanada, Franca, Italia dhe Spanja, po zhvillojnë aftësitë e tyre gjatë një stërvitjeje të përbashkët në Letoni.

Stërvitja ka në fokus teknikat e shpërthimeve taktike për hapjen e rrugëve, ndërtimin e pengesave dhe pastrimin e minave, duke rritur ndërveprueshmërinë dhe aftësitë operacionale të forcave pjesëmarrëse. Ky aktivitet është një tjetër dëshmi e kontributit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë në kuadër të aleancës dhe angazhimeve shumëkombëshe për sigurinë dhe stabilitetin e përbashkët.



Rivitalizimi i Industrisë Ushtarake, *një Qasje Strategjike* në Realitetin e Ri të Sigurisë

Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

Në një kohë kur sfidat globale të sigurisë po evoluojnë me shpejtësi, dhe kur përballjet gjeopolitike po zhvendosen gjithnjë e më afër kufijve tanë, nevoja për rritjen e kapaciteteve të brendshme të mbrojtjes është bërë më e domosdoshme se kurrë më parë. Në këtë kuadër, rivitalizimi i industrisë ushtarake shqiptare po shfaqet si një nga prioritetet strategjike që kërkon vëmendje të shtuar dhe një qasje të qartë të integruar ndërinstitucionale.

Një trashëgimi që rikthehet me synim të ri

Shqipëria ka trashëguar një infrastrukturë të konsiderueshme ushtarake nga e kaluara, përfshirë kapacitete prodhimi, riparimi dhe mirëmbajtjeje, të cilat për vite me radhë qëndruan jashtë funksionit. Me një analizë të kujdesshme tekniko-ekonomike dhe mbështetjen e partnerëve strategjikë, këto kapacitete mund të shndërrohen në bazamentin e një industrie moderne të mbrojtjes, e aftë të shërbejë si për nevojat kombëtare, ashtu edhe për ato të aleancave ndërkombëtare, përfshirë NATO-n.

Pse është kjo industri thelbësore sot?

Mbrojtje e qëndrueshme kombëtare. Në këndvështrimin tim nuk ka mbrojtje të qëndrueshme pa burime të brendshme që e mbështesin atë. Një industri ushtarake funksionale ul varësinë nga importi, siguron mirëmbajtje më të shpejtë të pajisjeve dhe ndihmon në përballimin më efikas të emergjencave ushtarake apo civile.

Ekonomi kombëtare dhe vende pune. Përtej përfitimeve strategjike, një industri e mirëorganizuar ushtarake mund të gjenerojë vlera të prekshme ekonomike: vende pune për inxhinierë, teknikë dhe specialistë; zhvillim teknologjik dhe partneritete me sektorin privat për nënkontraktime dhe shërbime të lidhura.

Diplomaci e mbrojtjes dhe kapacitet eksporti. Në një botë ku edhe siguria është pjesë e diplomacisë, të kesh produkte apo shërbime të eksportueshme në sektorin e mbrojtjes rrit prestigjin ndërkombëtar të vendit. Por kjo kërkon kritere të qarta etike dhe ligjore për përdorimin dhe destinacionin final të çdo produkti.

Roli i mediave të mbrojtjes: Informim dhe vlerësim me përgjegjësi

Gazeta “Ushtria” ka detyrën jo vetëm të pasqyrojë projektet në zhvillim, por edhe të informojë opinionin ushtarak dhe publik mbi ndikimet reale që sjell kjo nismë. Kjo analizë nxit një debat të matur dhe teknik, ku prioriteti mbetet gjithmonë interesi kombëtar dhe ruajtja e transparencës publike.

Një proces që kërkon koherencë, profesionalizëm dhe vizion

Rivitalizimi i industrisë ushtarake nuk është thjesht një projekt teknik apo ekonomik, ai është një gur themeli për sigurinë kombëtare. Ai kërkon bashkërendim të ngushtë midis Ministrisë së Mbrojtjes, Forcave të Armatosura, universiteteve teknike, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë. Shqipëria ka mundësi reale për të kthyer këtë industri në një aset strategjik dhe një motor zhvillimi. Ky proces nuk duhet parë si një luks, por si një komponent i domosdoshëm i sovranitetit dhe sigurisë kombëtare në një botë gjithnjë më të paparashikueshme.

Benefitet dhe e ardhmja

Shqipëria dikur kishte një bazë të konsiderueshme prodhimi ushtarak gjatë regjimit komunist, por me rënien e sistemit dhe tranzicionin drejt ekonomisë së tregut, këto kapacitete u shkatërruan ose u lanë në harresë. Tashmë, ideja e rikthimit të një industrie moderne të mbrojtjes po shihet si një domosdoshmëri për përmbushjen e nevojave të ushtrisë dhe për të kontribuar në aleanca si NATO.

Benefitet kryesore të rivitalizimit të industrisë ushtarake: Siguri Kombëtare dhe Vetëmjaftueshmëri: Reduktimi i varësisë nga importi i armatimeve.

Reagim më i shpejtë në raste emergjente për



furnizime, pajisje dhe mirëmbajtje.

Zhvillim Ekonomik dhe Teknologjik: Krijimi i vendeve të reja të punës për inxhinierë, teknikë, shkencëtarë dhe punëtorë të kualifikuar. Nxitje për zhvillim të teknologjive të avancuara që më pas mund të transferohen edhe në sektorë civilë.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Mundësi për partneritete me kompani dhe shtete të NATO-s për prodhim ose bashkë-prodhim. Fuqizimi i pozitës së Shqipërisë si një vend kontribuues aktiv në fushën e mbrojtjes në rajon. Modernizimi i Ushtrisë Shqiptare. Prodhimi i mjeteve të përshtatura për terrenin dhe nevojat specifike të Forcave të Armatosura Shqiptare. Lehtësi në mirëmbajtje dhe përmirësim të vazhdueshëm të sistemeve ekzistuese.

Si shihet e ardhmja e industrisë ushtarake në Shqipëri?

Transformimi i ish-fabrikave ushtarake, rindërtimi dhe modernizimi i ish-fabrikave në Poliçan, Gramsh, Mjekës dhe Burrel, investime publike ose përmes partneriteteve publike-private (PPP).

Integrimi në zinxhirët e furnizimit të NATO-s

Prodhimi i komponentëve për armë, pajisje mbrojtëse dhe pjesë këmbimi për tregjet e NATO-s.

Shqipëria ka një avantazh strategjik për të ofruar punë të kualifikuar me kosto konkurruese. Fokusi në teknologji të reja (dronë, komunikim, AI ushtarake); Bashkëpunime

me universitetet dhe institutet kërkimore për zhvillim të dronëve ushtarakë, sistemeve të mbikëqyrjes dhe analizës së të dhënave me inteligjencë artificiale; Futja e prodhimeve të teknologjisë së lartë që nuk kërkojnë infrastrukturë të rëndë si dikur; Angazhimi i Diasporës dhe investitorëve strategjikë; Shfrytëzimi i dijes teknike dhe kapitalit të ekspertëve shqiptarë jashtë vendit për të ndërtuar një industri konkurruese.

Roli i ushtrisë shqiptare në këtë strategji:

Fokus në standardet e NATO-s: çdo zhvillim duhet të jetë i përputhshëm me doktrinën dhe logjistikën e NATO-s. Trajnim i specializuar: krijimi i kapaciteteve njerëzore që të mund të operojnë dhe mirëmbajnë teknologji të avancuar prodhimi dhe armësh. Eksport potencial: nëse industria zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme dhe cilësore, Shqipëria mund të bëhet eksportuese e pajisjeve të caktuara ushtarake në rajon apo më gjerë. Pengesat aktuale dhe sfidat: Mungesa e investimeve fillestare. Kuadri ligjor dhe procedurat e ngadalta të prokurimeve. Rreziku i korrupsionit në projektet strategjike. Nevoja për mbikëqyrje dhe transparencë në bashkëpunimet me kompani të huaja. Rivitalizimi i industrisë ushtarake është një mundësi strategjike për Shqipërinë që kërkon vizion afatgjatë, investime të qëndrueshme dhe koordinim ndërinstitucional. Nëse zbatohet me kujdes dhe profesionalizëm, ajo mund të bëhet një shtyllë e fortë për zhvillimin ekonomik, fuqizimin e ushtrisë dhe për rolin gjeopolitik të Shqipërisë në rajon dhe në aleancat ndërkombëtare.



Intervista

25 VITE RRRUGËTIM, nga themelet tek modernizimi



***Intervistë ekskluzive me
Komandantin e Forcës Tokësore
të FARSH, Gjeneralmajor
Ilir Xhebexhia***



Intervistoi:

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

Në kuadër të 25-vjetorit të krijimit të Forcës Tokësore, kemi kënaqësinë dhe nderin të zhvillojmë një bisedë ekskluzive me Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, komandantin aktual të kësaj Force. Për herë të parë në këtë format, Gjeneralmajori sjell një panoramë të plotë historike dhe profesionale: nga ditët e para të themelimit të Forcës Tokësore dhe komandantët që udhëhoqën atë periudhë të vështirë, tek transformimi i saj sipas standardeve të NATO-s, si dhe sfidat që janë tejkaluar në rrugën e modernizimit.

Në këtë intervistë, Gjeneralmajor Xhebexhia ndalet jo vetëm te rruga e zhvillimit të institucionit që drejton, por edhe te përvoja e tij personale si ushtarak dhe drejtues, duke ndarë vizionin për të ardhmen e Forcës Tokësore dhe rolin që ajo do të ketë në garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit.

I nderuar Gjeneralmajor Xhebexhia, kush ishin figurat dhe komandantët që kontribuan në ngritjen e Forcës Tokësore? Cilat ishin sfidat e para?

Forca Tokësore, nga krijimi e deri më sot, është drejtuar nga komandantë me eksperiencë, të cilët sot kemi nderin t'i kemi shumicën prezentë në këtë ceremoni modeste. Kështu, nga viti 2000-2006, Forca Tokësore u drejtua nga gjeneralmajor Kostaq Karoli (i cili nuk ndodhet më mes nesh), prej vitit 2006-2007, u drejtua nga gjeneralmajor Shpëtim Spahiu dhe nga viti 2010 deri në gusht 2012, kjo Forcë u drejtua nga gjeneralmajor Viktor Berdo. Prej gushtit 2012 deri në nëntor 2015, Forca Tokësore u drejtua nga gjeneralmajor Zyber Dushku. Nga muaji nëntor 2015 e deri në muajin janar 2019, Forca Tokësore u drejtua nga gjeneralmajor Nazmi Cahani. Prej muajit shkurt 2019 - tetor 2020, u drejtua nga gjeneral brigade Albert Mullai. Nga viti 2020-2022, Forca Tokësore u drejtua nga gjeneral brigade Arben Kingji. Ndërsa nga viti 2023 e në vazhdim, Forca Tokësore drejtohet nga gjeneralmajor Ilir Xhebexhia.

Forca Tokësore krijohej në një vit kur shteti kishte sfida të mëdha në drejtim të organizimit, sigurisë, shkatërrimi i vitit 1997, si dhe sfidat për riorganizim të vazhdueshëm sipas modeleve bashkëkohore të vendeve PFP dhe NATO.

Ndër sfidat e para mund të përmendim riorganizimin e njësive pas ngjarjeve të vitit 1997, me fokus transformimin, stërvitjen dhe trajnimin, në përmbushje të

misionit kushtetues si dhe përballimin e sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve që shfaqeshin gjatë pjesëmarrjes në misionet paqeruajtëse dhe luftarake jashtë vendit, në kuadër të operacioneve ushtarake të NATO-s në Afganistan, Irak, Bosnje-Hercegovinë.

Si ka ndryshuar roli i Forcës Tokësore nga vitet e para e deri sot?

Forca Tokësore përbën bazën e Forcave të Armatosura dhe strukturën ushtarake më të madhe të tyre. Ajo është forca ushtarake përgjegjëse për planëzimin, organizimin dhe zhvillimin e operacioneve tokësore luftarake dhe jo luftarake që rrjedhin nga misioni dhe detyrat e Forcave të Armatosura.

Megjithatë roli i saj ka ndryshuar ndër vite, duke kaluar ndryshime strukturore të vazhdueshme për ngritjen dhe zhvillimin e strukturave dhe kapaciteteve, në përshtatje me kërkesat që kërkonte rruga e gjatë për të arritur qëllim final të anëtarësimit në NATO, në vitin 2009.

Këto ndryshime kanë bërë që Forca Tokësore nga një konsumues i sigurisë në vitet e para të ndërtimit të saj është shndërruar në prodhues të sigurisë në rajon dhe më gjerë, falë eksperiencës së gjatë në misione, stërvitje ndërkombëtare, trajnim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim me aleatët dhe partnerët, duke fituar besimin e tyre si një forcë e besueshme dhe e aftë të veprojë në teatrin operacional.

Cilat janë momentet më të rëndësishme historike që shënojnë rrugëtimin e këtyre 25 viteve?

- Forca Tokësore në krijimin e saj, më datë 29 gusht 2000, përfshinte në radhët e saj njësi dhe reparte me traditë me një veprimtari të pasur shumëvjeçare, të përhapura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo u krijua mbi bazën e 5 divizioneve këmbësore me rreth 55 brigada dhe 300 batalione, të përhapur në 167 rajone të ndryshme të vendit.

- Në vitin 2006, suprimohet Forca Tokësore dhe krijohet Komanda e Forcës së Bashkuar.

- Në kuadër të transformimit të vazhdueshëm të Forcave të Armatosura bazuar edhe në konceptin e një ushtrie sa më të vogël në numër dhe sa më operacionale e profesioniste, më 9 dhjetor 2009, u dekretua ri-krijimi i Forcës Tokësore mbi bazën e Brigadës së Reagimit të Shpejtë dhe Regjimentit Komando.

- Forca Tokësore, duke filluar nga 1 nëntori i vitit 2023, ka kaluar në Strukturën e Re Organizative, e cila konsiston në një forcë ushtarake më efektive, e kompletuar me personel, e mirë-pajisur me armatim dhe teknikë të avancuar, e mirë-trajnuar, të stërvitur dhe të motivuar, të gatshme dhe të aftë të kryejnë misionin e tyre kushtetues në mbrojtje të vendit, si dhe duke vepruar në përbërje të Aleancës, në respekt të vlerave, sigurisë dhe paqes në rajon dhe më gjerë.

- Një risi e këtyre ndryshimeve strukturore është atashimi i komponentit rezervist krahas personelit aktiv. Aktivizimi dhe integrimi i kësaj force rezerviste,

do mbështesë trupat aktivë në mjedisin operacional të përbashkët si dhe i shërben rritjes së kapaciteteve dhe aftësisë operationale për t'u përballur me rreziqet dhe kërcënimet të identifikuar në mjedisin aktual të sigurisë.

Çfarë roli ka Forca Tokësore në zhvillimet e sigurisë rajonale në Ballkan?

Koncepti strategjik i NATO-s thekson se vendet e Ballkanit Perëndimor përballen me sfida dhe kërcënime mes të cilave është dhe ndërhyrja dashakeqe e vendeve të treta.

Kompasi Strategjik i BE-së thekson se siguria dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor nuk janë të garantuara dhe ekziston frika reale e destabilizimit dhe përkeqësimit të situatës së sigurisë.

Politikë mbrojtëse dhe paqësore: politika e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë nuk paragjykon asnjë shtet si armik dhe nuk ka asnjë synim të cenojë tërësinë territoriale, sovranitetin, apo pavarësinë e shteteve të tjera.

Forca Tokësore përbën bazën e Forcave të Armatosura dhe strukturën ushtarake më të madhe të tyre dhe rrjedhimisht është element thelbësor i fuqisë kombëtare si pjesë e FA-së dhe kontribuon në ruajtjen e sigurisë në rajon, duke realizuar misionin e saj kushtetues.

Krahas kësaj, FT angazhohet në Planet e Bashkëpunimit Ushtarak Dypalëshe duke marrë pjesë në stërvitje të përbashkëta, trajnime të ndryshme me qëllimin e vetëm për rritjen e besimit midis Forcave Tokësore për të demonstruar praktikisht jo vetëm atë që ne e kemi të deklaruar në dokumente strategjike (Politikë mbrojtëse dhe paqësore) por dhe rritjen e ndërveprimit mes Forcave Tokësore të vendeve respektive të BP.

Si ndihmon Forca Tokësore në forcimin e sigurisë së NATO-s në juglindje të Evropës?

Vendndodhja gjeografike e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor e bën një pjesë të rëndësishme të rrjetit të rrugëve pan europiane, që NATO synon të përdorë si pjesë e Korridorit VIII për të rritur sigurinë në krahun lindor të NATO-s.

Korridorit VIII synon pritjen e forcave aleate, duke vënë në dispozicion infrastrukturën portuale dhe rrjetin e rrugëve dhe krijimin e një mjedisi të sigurt të lëvizjes nëpërmjet përdorimit të Forcës Tokësore për sigurimin e rrugëkalimit.

Krahas sigurimit të infrastrukturës portuale dhe asaj të rrugëkalimit, FT merr pjesë në stërvitje të përbashkëta në interes të rritjes së sigurisë në juglindje të Evropës. Qëllimi kryesor është identifikimi i dobësive apo pikave kritike që kërkojnë ndërhyrje si dhe përmirësimi i veprimeve të përbashkëta për të rritur ndërveprueshmërinë në rast dislokimi për në krahun lindor.

Gjithashtu FT merr pjesë me trupa dhe me pozicione shtabi në komanda të ndryshme në juglindje të Evropës, duke kontribuar drejtpërsëdrejti në operationet e NATO-s dhe rritjen e sigurisë në rajonin juglindor të Evropës.

Çfarë marrëdhëniesh keni me forcat e armatosura të Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi?

Marrëdhëniet do t'i konsideroja si të shkëlqyera, pasi prej vitesh respektivisht kemi Plane Bashkëpunimi Ushtarak Dypalëshe me të gjitha këto vende të rajonit. Gjithashtu kemi të konsoliduara Plane me Italinë, Greqinë, Malin e Zi, Kroacinë, Maqedoninë e Veriut si dhe Kosovën. Këto plane synojnë ngritjen e kapaciteteve, rritjen e besimit, profesionalizmit, ndërveprimin nëpërmjet stërvitjeve e trajnimeve të përbashkëta si dhe shkëmbimin e eksperiencave përmes vizitave reciproke të punës.

Këto marrëdhënie demonstrohen më së miri dhe në rastet e angazhimit të Forcës Tokësore në menaxhimin e emergjencave civile për shkak të fatkeqësive natyrore (Covid-19 në Itali, zjarret në Greqi, dhe termeti në Turqi).

Cilat janë mësimet e nxjerra nga stërvitjet e përbashkëta, si “Defender Europe”?

FT tashmë është një Forcë e konsoliduar që ka marrë pjesë në shumë stërvitje ndërkombëtare dhe ka eksperiencën e duhur për të vepruar në çdo teatër operacional. Kur them ka eksperiencë, kam parasysh që nga ushtari deri tek planëzimi i shtabeve në mjedis ndërkombëtar dinë si të veprojnë dhe operojnë.

Megjithatë stërvitja “Defender Europe” është një stërvitje me karakter të veçantë, për arsye se zhvillohet për të testuar kapacitetet infrastrukturore në rast dislokimi të forcave të NATO-s apo një nisme bilaterale. Përsëri fokusi është tek ndërveprueshmëria, zbatimi i standardeve të NATO-s dhe aftësia për t'u dislokuar dhe ri-dislokuar në një kohë të shkurtër.

Mësime të identifikuar do të veçoja dy më kryesoret, të cilat janë përmirësimi i infrastrukturës si vend pritës dhe modernizimi me sisteme të ndërveprueshme me aleatët dhe anëtarë të NATO-s, të dyja këto mësime të nxjerra janë adresuar dhe punohet në vazhdimësi për stërvitjet e ardhme të paketës “Defender Europe”.

Këto seri stërvitjesh janë zhvilluar tre herë në Shqipëri që nga viti 2021, 2023 dhe 2025 dhe në dy herët e fundit shqipëria ka patur drejtimin e brigadës shumëkombëshe kjo si rezultat i përfaqësimit dinjitoz, rritjes profesionale dhe punës së palodhur të ushtarakëve të FT dhe FA ndër vite.

Ku qëndron sot Forca Tokësore në raport me modernizimin?

Në kuadër të përmbushjes së misionit kushtetues dhe detyrave kryesore që rrjedhin prej tij, detyrimeve ndaj Aleancës, si dhe bazuar në Politikën e Mbrojtjes, Strategjinë Ushtarake, Vizionin e SHSHPFA, PAZH, Direktivën e Mbrojtjes, në Forcën Tokësore, vijon procesi i modernizimit të strukturave operationale për përmbushjen e kërkesave të Objektivave të Kapaciteteve të deklaruara në NATO; me prioritet Grup-Batalionin e Këmbësorisë së Lehtë (GBKL) dhe Grupit Tokësor

Special i Organizuar për Detyrë (SOLTG), të cilët janë dy nga Objektivat Kryesore të kapaciteteve të NATO-s, me synim përmirësimin e kapaciteteve operacionale ekzistuese si dhe ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja operacionale, me qëllim rritjen e Kapaciteteve të Luftimit (C), Mbështetjes së Luftimit (CS) si dhe Mbështetjes më Shërbime të Luftimit (CSS).

Në këtë kontekst, dua të theksoj se lista e projekteve të cilat mbështesin modernizimin e strukturave të Forcës Tokësore është e gjatë, disa prej të cilëve janë në fazë implementimi dhe disa projekte të reja, por unë do doja të veçoja disa prej tyre si:

Projekti i modernizimit të strukturave të Forcës Tokësore me armatim të ri, të unifikuar individual dhe kolektiv për forcat aktive dhe ato rezerviste;

Projekti i Sistemeve/pajisjeve të Zbulimit për neutralizimin e objekteve fluturues pa pilot;

Projekti i modernizimit të Qendrës MADM në FT, duke e vlerësuar edhe si kapacitet kombëtar;

Projekti i modernizimit dhe kompletimit me Sisteme të Mbrojtjes Kundër Tanke "JAVELIN".

Projekti i modernizimit dhe kompletimit me Sisteme të Mbrojtjes Kundër Ajrore "STINGER".

Projekti i modernizimit dhe kompletimit të të gjitha reparteve të FT me GHLKT, tip i ri, 84/246mm, standard NATO.

Projekti "Pajisje speciale xheniere", si kapacitet për mbështetjen xheniere të veprimeve luftarake të FT/FARSH dhe mbështetjen e popullatës civile në rast emergjence (tërmete, zjarre, përmytje) dhe pastrimin e "Hot-Spoteve".

Projekti i modernizimit të mbështetjes së trupave me luftim, për rritjen e fuqisë së zjarrit direkt dhe indirekt, nëpërmjet sistemit të ri të mortajave 120mm të montuara mbi mjet, sistemeve të artilerisë 105mm dhe 155mm.

Projekti i modernizimit dhe kompletimit të strukturave operacionale të FT-së me mjete taktike të blinduara (JLTV) me kalueshmëri e manovrueshmëri të lartë, për të siguruar mbrojtjen e forcave, lëvizshmërinë si dhe dislokimit të shpejtë të trupave në operacione brenda e jashtë vendit.

Sistemi i Menaxhimit i Fushëbetejës (Battle Management System).

Kompletimi me mjete taktike të kalueshmërisë së lartë për të gjithë strukturat e Forcës Tokësore.

Procesi i modernizimit të strukturave operacionale me prioritet Grup Batalionin e Këmbësorisë së Lehtë/GBKL dhe SOLTG, do t'i shërbejë rritjes dhe përmirësimit të kapaciteteve operacionale në interes të certifikimit të radhës nga NATO të GBKL dhe SOLTG gjatë vitit 2026, në përmbushje detyrimeve të Paketës së Objektiveve të Kapaciteteve të NATO-s, si dhe angazhimit tonë ndaj Aleancës.

Me këtë rast, nuk mund të lija pa përmendur mbështetjen e dhënë nga Ministri i Mbrojtjes, Shefi i SHPPA për modernizimin, përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve operacionale të strukturave të FT-së, si dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me aleatin strategjik SHBA, veçanërisht me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, Komandën Amerikane në Evropë/USAREUR, Zyrën

e Bashkëpunimit Ushtarak Amerikan, ODC si dhe ekupeve trajnuese të SFAB-it, i atashuar pranë GBKL, të cilët kanë dhënë dhe po japin një kontribut të pazëvendësueshëm, për mbështetjen, trajnimin, stërvitjen e përbashkët, si dhe modernizimin e FT-së për të qenë të ndërveprueshëm dhe të aftë për kryerjen e misionit kushtetues.

Gjithashtu, dua të theksoj se vijimi i procesit të modernizimit të Forcës Tokësore në funksion të përmbushjes së Objektiveve të Kapaciteteve të përcaktuara në Samitin e NATO-s në Hagë, ishte në qendër të takimit të parë konsultativ, që ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, zhvilloi në Komandën e Forcës Tokësore, nga ku nisi zyrtarisht punën për Rivlerësimin Strategjik të Mbrojtjes (RSM).

Çfarë pajisjesh dhe teknologjish të reja pritet të futen në shërbim?

Procesi i modernizimit në FT vijon bazuar në PAZH FT 2024-2033 dhe detyrimet e procesit të Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s (NDPP-CT-25), duke synuar përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese si dhe ngritjen e Kapaciteteve të luftimit, mbështetjes së luftimit dhe mbështetjes me shërbime të luftimit, bazuar në zhvillimet e fundit teknologjike, të cilat janë të ndërveprueshme me aleatët në përmbushje të kërkesave të Objektiveve të Kapaciteteve.

Ndër to mund të përmendim:

Projekti i Sistemeve/pajisjeve të Zbulimit për neutralizimin e objekteve fluturues pa pilot (drone Buster dhe Drone Gun).

Sisteme të avancuara për zbulim, identifikim dhe përcaktim objektivash në fushën e luftimit (mjete të avancuara të fluturimit pa pilot, sistem sensorësh dhe radarësh për zbulim, vrojtim e përcaktim objektivash).

Projekti i modernizimit dhe kompletimit me Sisteme të Mbrojtjes Kundër Tanke, "JAVELIN".

Projekti i modernizimit dhe kompletimit me Sisteme të Mbrojtjes Kundër Ajrore "STINGER".

Projekti i modernizimit dhe kompletimit të të gjitha reparteve të FT-së me GHLKT, tip i ri, 84/246mm, standard NATO.

Projekti "Pajisje speciale xheniere".

Projekti i modernizimit të mbështetjes me zjarr nëpërmjet sistemit të ri të mortajave 120mm të montuara mbi mjet, sistemeve të artilerisë 105mm dhe 155mm.

Projekti i modernizimit dhe kompletimit të strukturave operacionale të FT-së me mjete taktike të blinduara (JLTV/APC).

Sistemi i Menaxhimit i Fushëbetejës (Battle Management System).

Si po investohet tek trajtimi i ushtarit, pajisjet personale, mbrojtja dhe motivimi?

Ndër objektivat kryesorë të punës në FT është menaxhimi sa më i mirë i Burimeve Njerëzore për



mbështetjen, mbrojtjen dhe motivimin e personelit.

Mbështetja me burime njerëzore të nevojshme për përmbushjen e misionit të FT-së, është konsideruar si një prioritet për zhvillimin e forcës, bazuar në nivelet operacionale të kërkuara, zhvillimin dhe trajtimin e personelit si dhe në standardizimin e procedurave të punës në fushën e personelit.

Motivimi i personelit është realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore, arsimimit, kualifikimit dhe ecurisë në karrierë nëpërmjet shanseve të barabarta.

Në drejtim të Mbajtjes së personelit është treguar shumë kujdes, në identifikimin dhe promovimin në grada dhe detyrë, ato ushtarakë të cilët sigurojnë vijueshmëri shërbimi në strukturat e FT-së, jemi përpjekur që çdo ushtarak, pikë së pari, duhet ta ndjejë vetën se ka kontribuar dhe ka mundësi të kontribuojë për FT-në, se është i vlefshëm në funksionin e tij organik dhe se FT dhe ushtaraku janë në një marrëdhënie simbiotike në mes tyre.

Përkujdesja ndaj personelit sa më sipër, është realizuar edhe nëpërmjet investimeve në infrastrukturën stërvitore, promovimit të karrierës ushtarake, rritjes së trajtimit financiar, si dhe përmirësimit të kushteve të jetesës, kushteve të punës dhe kujdesit shëndetësor për ushtarakët dhe familjarët e tyre.

Disa nga nismat e qeverisë për mbështetjen dhe motivimin e personelit janë:

- nisma e viti 2023 për dhënien e kuotave çdo vit për kredi të reja me interes 0%, për ushtarakët aktivë/punonjësit civilë të Forcave të Armatosura.

- nisma e vitit 2024, për rritjen e trajtimit financiar që tashmë është bërë realitet që prej 1 janarit 2025, me fokus trajtimin dinjitoz të efektivëve ushtarakë.

Për sa më sipër gjej rastin, që në emër të gjithë personelit të Forcës Tokësore, të shpreh falënderimet dhe mirënjohjen e thellë për Ministrin e Mbrojtjes e Shefin e SHPPA për mbështetjen e dhënë.

Cilat janë kontributet më të rëndësishme të ushtarakëve tanë në misionet ndërkombëtare?

Nisur nga misioni kushtetues i FARSH, baza ligjore e përcaktuar, si dhe në kuadër të angazhimeve politike të Republikës së Shqipërisë në luftë kundër terrorizmit, strukturat e Forcës Tokësore kanë qenë dhe janë pjesëmarrëse aktive në operacione ndërkombëtare në misione paqeruajtëse dhe luftarake jashtë vendit, si pjesë e pandarë e operacioneve të drejtuara nga NATO, BE, OKB dhe koalicionet e përbashkëta të partnerëve tanë strategjike.

Më 9 shtator 1996, FT, në kuadër të FARSH, ka filluar misionin e parë në Bosnje-Hercegovinë për një periudhë kohore 6-muaj. Më pas, numri i trupave pjesëmarrëse në Operacionet e Mbështetjes së Paqes (OMP) është rritur, ashtu siç është rritur edhe gjeografikisht numri i vendeve apo rajoneve ku ato kanë kryer operacione e misione paqeruajtëse apo luftarake, si operacioni “Liria e Irakut”, Irak, ISAF dhe RSM Afganistan, Çad, Gjeorgji, Mali, Sudani i Jugut, Kosovë, eFP Letoni, eVA Bullgari.

Kontribute të FT-së, në operacione ushtarake të drejtuara nga NATO, BE dhe OKB, nga muaji shtator

i vitit 1996, deri në muajin dhjetor 2024 , janë gjithsej 7062 personel.

Aktualisht, gjatë vitit 2025, Forca Tokësore, është e angazhuar në misione paqeruajtëse në Bosnje-Hercegovinë (misioni ALTHEA), në Kosovë (misioni KFOR-3, KFOR 6, KFOR 8, KFOR-12), eFP Letoni, misioni eVA-VI në Bullgari, misioni “INTERFLEX, Mbretëria e Bashkuar, misioni ORF “KFOR-1” Kosovë, Misioni ORF (shtab), me gjithsej personel 308 personel dhe 63 mjete.

Me këtë rast, dëshiroj të siguroj Ministrin e Mbrojtjes dhe Shefin e SHPFA, se të gjitha strukturat e FT-së të dislokuara në misionet dhe operacionet ndërkombëtare, në kuadër të NATO-s, BE dhe OKB-së, si dhe strukturat që po përgatiten të dislokohen në rotacionet e misioneve të radhës, kryejnë dhe do të kryejnë me profesionalizëm dhe me dinjitet të gjitha detyrat operationale të dhëna nga komandat eprore ndërkombëtare.

Kontributi i FT-së në misione jashtë vendit në kuadër të operacioneve ushtarake të NATO-s, BE, OKB, ka qenë gjithmonë i vlerësuar maksimalisht nga komandat eprore ndërkombëtare për angazhimin, profesionalizmin dhe përkushtimin në realizimin e detyrave të ngarkuara, gjë që fatkeqësisht e dëshmon dhe humbja e jetës së “Dëshmorit të Atdheut”, Kapiten Feti Vogli, në Afganistan.

Çfarë përvoja ka sjellë misioni në Afganistan dhe si po shfrytëzohet ajo sot?

Pjesëmarrja në misione paqeruajtëse dhe luftarake jashtë vendit solli një eksperiencë të re në drejtim të ndërveprueshmërisë, aplikimit të standardeve të NATO-s, rritjen e kërkesave të gatishmërisë si dhe rritjen e profesionalizmit të ushtarakëve tanë, të cilët përballëshin me kërcënime e rreze jo konvencionale. Kjo eksperiencë po shfrytëzohet në teatrot aktuale, kjo si pasojë e globalizmit, duke qenë se lufta ndaj terrorizmit ngelet një kërcënim aktual pavarësisht shfaqjes në një nivel më të ulët.

Kjo eksperiencë përçohet më tej nëpërmjet stërvitjes para-dislokuese me kushtet e misionit e drejtuar nga ushtarakë të cilët kanë një eksperiencë të gjatë në misionet e operacionet jashtë vendit.

Si e përshkruani rolin e Forcës Tokësore në emergjencat civile?

Forca Tokësore, në përmbushje të misionit kushtetues, krahas rolit dhe përgjegjësisë tradicionale ushtarake, ka qenë e angazhuar dhe kontribuar në operacionet e Emergjencave Civile në mbështetje të autoriteteve vendore dhe komunitetit, në operacione për shuarje zjarri, bllokim nga dëbora, përmytje, për përballimin e pasojave të tërmetit të nëntorit 2019, zhvendosje kimikatesh, pastrim territori, mbështetje të IKMT, në menaxhimin e pasojave nga virusi “COVID-19, etj., me një angazhim total prej 225277 forcash dhe 18651 mjete.



Ndërhyrjet më të suksesshme në përballimin e fatkeqësive natyrore kanë angazhimi në operacione për shuarje zjarri, përmbytje, për përballimin e pasojave të tërmetit të nëntorit 2019, si dhe në menaxhimin e parandalimin e pasojave nga virusi "COVID-19".

A ka plane për të rritur kapacitetet e ndihmës ndaj popullsisë në raste emergjencash?

Forca Tokësore po zhvillon kapacitete të ndihmës ndaj popullsisë në raste emergjencash më përputhje me detyrimet në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.

Aktualisht në kuadër të Modernizimit të kapaciteteve të FARSH në FT po zbatohet projekti "Kompletim me mjete dhe pajisje për operacionet e emergjencave civile/SAR". FT zhvillon stërvitje dhe trajnime specifike për përballimin e EC në rast zjarresh, tërmetesh, përmbytjesh, incidentesh industriale dhe operacionesh kërkim-shpëtimi/SAR.

Çfarë stërvitjesh madhore janë planifikuar për vitet në vijim?

Forca Tokësore, do vijoje të jetë e angazhuar për planëzim dhe ekzekutim me profesionalizëm e disiplinë të lartë edhe stërvitjet e planëzuara për periudhën në vijim, ku mund të përmendim: Stërvitjen 3-shkallëshe me dislokim trupash e koduar "Mburoja Dardane-25" (06-09 tetor), "Golden Sword-25" në bashkëpunim me Greqinë, "JCET ALB-TURKIYE-25" me pjesëmarrjen e FS/ROS.

Gjithashtu, prioritet për Forcën Tokësore për vitin 2026 e në vijim, ndër të tjera, do të jenë:

- "Mburoja e Arbrit-26" (14-23 shtator 2026), stërvitja vlerësuese e GBKL në rajonin stërvitor Zall-Herr dhe Bizë.
- "Mburoja Ilire-26" (03-13 nëntor 2026), stërvitja vlerësuese e SOLTG/ROS.
- Paketa e stërvitjeve të përvitshme "KFOR Rotation" si pjesë e paketës së stërvitjeve KFOR, në Gjermani.
- "Mburoja Ilire 27", është stërvitje dimërore e planëzuar për t'u zhvilluar në periudhën 29 nëntor deri në 04 dhjetor 2027 nga batalioni Komando, rajonin stërvitor të Bizës, në kushtet e vështira dhe të ftohta të motit.
- "Mburoja Albane 28", është stërvitje e planëzuar për t'u zhvilluar nga data 18- 23 Shtator 2028, nga Regjimenti i Këmbësorisë të Jugut.
- "Mburoja Dardane 29", është stërvitje e planëzuar për t'u zhvilluar në shtator 2029, nga Regjimenti i Këmbësorisë së Veriut, në rajonin stërvitor Mnelë.
- Pjesëmarrja në serinë e stërvitjeve "Defender Europe".

Si po konsolidohen strukturat e brendshme të Forcës Tokësore?

FT nëpërmjet PAZH të FT 2024-2033, synon të unifikojë dhe adresojë zhvillimin e gjithë veprimtarisë afatgjatë të strukturave të vartësisë, për hartimin e

planeve periodike vjetore, zhvillimin e kapaciteteve operacionale, të harmonizojë dhe integrojë gjithë ciklin e planifikimit, programimit, buxhetimit për zhvillimin e burimeve të mbrojtjes, në personel, stërvitje, armatime, pajisje, sisteme, infrastrukturë, etj.

Aktualisht FT po implementon strukturën e re, duke filluar nga 1 nëntori i vitit 2023, e cila konsiston në një forcë ushtarake më efektive, e kompletuar me personel, e mirë-pajisur me armatim dhe teknikë të avancuar, e mirë-trajnuar, të stërvitura dhe të motivuara, të gatshme dhe të afta të kryejnë misionin e tyre kushtetues në mbrojtje të vendit, si dhe duke vepruar në përbërje të Aleancës, në respekt të vlerave, sigurisë dhe paqes në rajon dhe më gjerë. Një risi e këtyre ndryshimeve strukturore është atashimi i komponentit rezervist krahas personelit aktiv. Aktivizimi dhe integrimi i kësaj force rezerviste, do mbështesë trupat aktivë në mjedisin operacional të përbashkët si dhe i shërben rritjes së kapaciteteve dhe aftësisë operacionale për t'u përballur me rreziqet dhe kërcënimet të identifikuara në mjedisin aktual të sigurisë.

Ajo çfarë duhet të kuptojmë është se, që të ndërtohet një kapacitet kërkon kohë, burime financiare dhe resurse njerëzore të trajnuara dhe duhet të kalojë në spektrin e plotë (DOTMLPF). FT i ka konkretizuar këto plane në Programet e Mbrojtjes, Listën e Integruar të Prioriteteve për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve sipas planifikimit në PAZH FT.

Si e shihni Forcën Tokësore pas 10 apo 20 vitesh?

Forcë Tokësore e kompletuar, e mirë-trajnuar, e mirë-stërvitur, e mirë-motivuar, e ndërveprueshme dhe e aftë për dislokim/ri-dislokim në vete, brenda dhe jashtë vendit, etj., për të kryer detyra luftarake dhe jo-luftarake në përmbushjen e misionit kushtetues dhe detyrimet ndaj NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Çfarë mesazhi do t'u përcillnit brezave të rinj që dëshirojnë të bëhen pjesë e saj?

Mesazhi që dua të përcjell për të rinjtë dhe qytetarët e Shqipërisë në këtë rast 25-vjetori është se duhet të kuptojnë se situata e sigurisë ka ndryshuar, qëndrojmë në një kohë ku konfliktet janë shtuar si në Europë dhe në Lindjen e Mesme dhe kontributi Juaj mund të jetë i vlefshëm kurdoherë. Rikthimi tek vlerat e larta të atdhedashurisë dhe mbështetja tek ajo pjesë e shoqërisë (Forcat e Armatosura) që janë një model për t'u ndjekur dhe një shembull i sakrificës së pakursyer se si mund t'i shërbesh Atdheut. U bëj thirrje të rinjve shqiptarë që të bëhen pjesë FA/FT, pasi aty do të gjejnë mundësi për një karrierë të suksesshme dhe të gjatë, mundësi zhvillimi profesional në fusha të ndryshme, përkujdesje shëndetësore dhe trajtim dinjitoz financiar.

Nëse do ta përmbledhnit Forcën Tokësore në tre fjalë, cilat do të ishin ato?

Përkushtim-Profesionalizëm-Disiplinë.

INTERVISTA



**67 VITE KMS, HISTORI, KRENARI
DHE PËRKUSHTIM NË SHËRBIM
TË SIGURISË KOMBËTARE**

**Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes
dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj**

Intervistoi:

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

Një histori krenarie dhe përkushtimi në shërbim të sigurisë kombëtare

Me rastin e 67-vjetorit të krijimit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, një prej institucioneve më të rëndësishme të arsimit ushtarak në vend, kemi kënaqësinë të sjellim një intervistë ekskluzive me Komandantin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj, i cili ndan me ne vizionin, sfidat dhe sukseset e Kolegjit ndër vite.

Z. Gjeneral, si do ta përshkruanit rrugëtimin 67-vjeçar të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë? Cilat janë momentet më kulmore të këtij institucioni?

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS) aktualisht është njësi në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Në historinë e arsimit ushtarak shqiptar 10 maji është një nga ditët më të rëndësishme, pasi data 10 maj 1958 është dita e themelimit të Akademisë së Mbrojtjes, sot KMS.

Krijimi i KMS qysh në krye të herës dhe struktura aktuale, ka ardhur si domosdoshmëri e ndarjes së arsimit për zhvillimin e karrierës së personelit ushtarak dhe civil dhe si nevojë e përmirësimit të vazhdueshëm cilësor në përshtatje me zhvillimet më të fundit në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Ky Kolegj vjen nga përvoja e arsimit tonë ushtarak të pasur ndër vite, si dhe pas anëtarësimit në NATO nga eksperiencia e vendeve Baltike dhe e shumë vendeve të NATO-s, tashmë si strukturë më vete arsimore brenda Forcave tona të Armatosura, për të cilën si momentin më kulmor do të përshkruaja pikërisht anëtarësimi në NATO dhe aplikimi i programeve studimore sipas standardeve të Aleancës.

Në Forcat e Armatosura kjo strukturë tashmë është institucioni i Arsimit të Lartë Ushtarak Profesional për të gjitha kurset e karrierës të FARSH deri në nivelin strategjik, nëpërmjet aplikimit të metodave dhe parimeve më të përparuara dhe më

të përditësuara arsimore, menaxhimit efektiv dhe përdorimit të burimeve intelektuale shkencore dhe materiale.

Cilat kanë qenë sfidat më të mëdha me të cilat është përballur Kolegji ndër vite dhe si janë tejkaluar ato?

Misioni i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë është edukimi dhe kualifikimi i personelit ushtarak e civil nëpërmjet programit mësimor, në nivelet e larta të drejtimit të Forcave të Armatosura dhe të institucioneve të tjera të sigurisë kombëtare, për përdorimin kreativ dhe me efikasitet të elementëve të fuqisë kombëtare në kohë paqe, krize dhe lufte, si dhe arsimimin e liderëve civilë e ushtarakë të vendeve partnere dhe të NATO-s.

Duke parë misionin e institucionit tonë, do të thosha që sfida e vazhdueshme për ne ka qenë dhe vijon të jetë edukimi dhe kualifikimi i të gjithë personelit të FARSH në përputhje dhe përshtatje të programeve dhe kurrikulave bashkëkohore të Aleancës dhe vendeve partnere (të BE, FSK, etj.)

Si është transformuar roli i Kolegjit në raport me zhvillimet moderne të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare?

Siç e citova dhe më sipër, KMS ka ndryshuar ndër vite, duke u përshtatur me sfidat e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit dhe duke patur qasje sipas standardeve të vendeve të Aleancës dhe atyre partnere.

Në këtë institucion planifikohen, zhvillohen dhe drejtohen kurset e karrierës të Oficerit KTHOSH, KKSHP, KLO dhe KLSM. Ndërkohë, aktualisht jemi në një fazë tjetër ristrukturimi, ku krahas edukimit dhe formimit të Oficerëve, në këtë Kolegj do të jenë në vartësi edhe Qendra e Arsimit Profesional të N/ Oficerit (KBNO, KANO, KLNO, KKrKapterit) dhe Qendra e Arsimit të Ushtarit Profesional (SIB, SIA) dhe në këtë mënyrë, siç e shikoni kjo strukturë e re do të kryejë edukimin dhe formimin profesional ushtarak të të gjithë efektivëve të FARSH.

Gjithashtu, në kuadrin e qasjes rajonale KMS



kemi ambicien që në një të ardhme të afërt në bashkëpunim me Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë të kalojë nën frymën e ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku kursantët e KKSHP dhe KLO, përveç diplomës ose certifikatës për kurset institucionale të mund të marrin dhe diplomën “Master Profesional”, “Master Shkencor” në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë, (ku pas arritjes së kësaj ambicie, do të shikohet mundësia e marrjes së masterit edhe nga personeli N/Oficer).

Edukimi ushtarak është themeli i një shteti të sigurt

Çfarë vendi zë Kolegji në edukimin dhe formimin profesional të oficerëve të Forcave të Armatosura dhe institucioneve të tjera të sigurisë?

Në kuadër të ristrukturimit të Forcave të Armatosura dhe si rrjedhojë edhe të Kolegjit, ashtu siç e përmenda më parë, ky institucion kryen edukimin dhe formimin profesional të të gjithë personelit të FARSH, duke filluar nga trajnimi dhe certifikimi i rekrutëve, formimi, arsimimi dhe kualifikimi i N/ oficerëve dhe civilë (C2) të administratës së FA-së (në nivel administrativ), si dhe të oficerëve pas titullimit të tyre nga niveli i oficerit të Shtabit (major) (pa harruar edhe oponencën dhe certifikimin që iu bëhet shkollave të trupës apo QS të Komandave të Forcave Tok, Aj. Det.) deri në nivel strategjik (Gjeneral) me kursin e KLSM (Kurs i certifikuar nga NATO), duke e bërë kështu institucion shumë të rëndësishëm dhe të vetmin në rang FA për formimin ushtarak e të gjithë hallkave të zinxhirit hierarkik të FARSH.

A mund të ndani me ne disa nga risitë që janë aplikuar në programet mësimore apo në qasjen



NË KËTË VIT
AKADEMIK, NË
KOLEGJ ËSHTË
ZHVILLUAR EDHE NJË
VIZITË E KOLEGJIT
TË MBROJTJES SË
NATO-S ME SELI NË
ROMË TË ITALISË,
SI DHE VIZITA E
KRYETARIT TE
KOMITETIT USHTARAK
TE NATO-S, I CILI
MBAJTI NJË LEKSION
TË SHKURTËR PËR
KURSET E KOLEGJIT.

strategjike të Kolegjit në vitet e fundit?

Ndër vite, qysh në krye të herës që me aplikimin për të qenë anëtar i NATO-s dhe deri kur Shqipëria u bë pjesë e Aleancës, në KMS është punuar sistematikisht dhe në vijimësi për përditësimin e programeve mësimore në çdo fushë dhe për çdo hallkë të zinxhirit

hierarkik të personelit të FARSH.

Në çdo përfundim viti akademik apo kursi të rekrutëve (SIB dhe SIA), bazuar në politikat e arsimimit dhe trajnimit në FA, si dhe STANAG-ve (dok. standard të vendeve të NATO-s) të ratifikuar, programet e arsimim-trajnimit janë një proces rishikimi i vazhdueshëm, kjo në bazë nevojave dhe përshtatjes së sfidave që vijnë në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, për të cilën aktualisht rendi botëror nuk është më ai i viteve 90-2000.

Këto ndryshime kryhen në bazë të mësimëve të nxjerra, udhëzimeve që vijnë nga instancat eprore dhe pasi punohen me grupe pune sipas instancave, miratohen nga dega e Kurrikulës së KMS. Këtu do të shtoja që pasqyrohen edhe sugjerime/rekomandime nga vendet tona aleate dhe partnere (NATO, Garda Kombëtare e New Jersey-it dhe FSK për N/Of dhe UA, etj.).

Ndërkohë, risi tjetër mund të shtoja që në kurset e larta të oficerëve, në mënyrë që të njihen sa më mirë me institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare dhe ndërkombëtare, vitet e fundit janë aplikuar vizita të ndryshme në Parlament, Presidencë, JFC Napoli, NATO LCC, institucionet e NATO-s në Bruksel, Romë, Kosovë, etj.

Në këtë vit akademik, në Kolegj është zhvilluar edhe një vizitë e Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s me seli në Romë të Italisë, si dhe vizita e Kryetarit të Komitetit Ushtarak të NATO-s, i cili mbajti një leksion të shkurtër për kurset e Kolegjit.

“Bashkëpunimi ndërkombëtar është çelësi i suksesit”

Si e shihni bashkëpunimin ndërkombëtar të Kolegjit? Cilat janë vendet apo institucionet me të cilat keni ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi?

KMS ka bashkëpunuar dhe do të vijojë të bashkëpunojë me vendet e Aleancës dhe partnere për çdo hallkë të zinxhirit hierarkik.

Më konkretisht për personelin oficer, në kuadër të kurseve të larta dhe kryesisht për KLSM (si një kurs rajonal i certifikuar nga NATO), prej kohësh janë ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me strukturat e arsimimi ushtarak të NATO-s dhe ato civile si: Qendra “Marshall” Gjermani, Kolegji i Baltikut, Universitetit për bashkëpunimin për Sigurinë dhe Mbrojtjen në Uashington DC USA, Instituti për Studime Globale në Romë Itali, Drejtorinë për

bashkëpunim ndërkombëtar për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Punëve të Jashtme Italiane, Universiteti “Bajazit” në Turqi, NATO HQ Sarajevo B&H, Universiteti i Administrimit Publik në Këln Gjermani, USA CIS, Ministria e Mbrojtjes së Kosovës. Gjithashtu, e veçanta e KLSM-së për këtë vit, ishte se kishim lektorë edhe nga STRATCOM COE, Letoni dhe EU MC Bruksel. Ndërkohë kemi patur gjithmonë si guest speaker Ambasadorë dhe Diplomata të akredituar në vendin tonë, veçanërisht nga vendet që kanë përfaqësues në KLSM

Për sa i përket edukimit, trajnimit dhe formimit profesional të trupës së N/Oficerëve dhe Ushtarëve Profesionist, ka patur një bashkëpunim të qëndrueshëm me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit dhe KDS të FSK.

Ndërkohë që në kuadër të aspirimit të anëtarësimit në BE, jo më larg se muaji prill i këtij viti, ka filluar puna për shikimin e mundësive për anëtarësim dhe bashkëpunim me Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë së BE-së (duke zhvilluar 1 ose më shumë kurse ose modul të 1 kursi).

“67 vite krenari – një histori që vazhdon”

Në këtë përvjetor të 67-të, cili është mesazhi juaj për të gjithë personelin, studentët dhe aleatët e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë?

Për personelin, mesazhi do të ishte: vijoni të azhurnoheni dhe vetë zhvilloheni, duke përdorur edhe zhvillimet teknike që intelijenca artificiale ofron.

Për studentët, mesazhi do të ishte: vijoni të ndiqni me përkushtim leksionet në KMS, por gjithashtu mos reshtni së adaptuari dhe të jeni gjithmonë kuriozë për vetëzhvillim.

Për aleatët, mesazhi do të ishte: KMS do të jetë gjithmonë 1 institucion i besueshëm dhe i hapur, duke adaptuar praktikën arsimore-trajnuese më të mira bashkëkohore.

Si e shihni të ardhmen e Kolegjit në një kontekst të ndryshimeve të vazhdueshme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes?

Kryefjala në KMS do të jetë adaptimi dhe vetëzhvillimi i personelit arsimor dhe trajnues, në mënyrë që të jenë gjithmonë koherent me zhvillimet e kohës dhe për të qenë të aftë për të transmetuar tek efektivit student-rekrut informacionin bashkëkohor.



“Nderi i Kombit fillon me uniformën”

Me studentët e diplomuar:

Gentritin, Fjodorën dhe pedagogun, nëntoger Arlen Rama

Intervistoi:

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

“Tre Vite Uniformë, Përkushtim dhe Krenari”

Në zemër të Garnizonit “Skënderbej” ndodhet një prej institucioneve më të rëndësishme të arsimit ushtarak, Akademia e Forcave të Armatosura, ku përzihen tradita dhe modernizimi, pas tre vitesh përgatitjeje intensive akademike e ushtarake, disa nga

të rinjtë më të përkushtuar të vendit dhe më gjerë janë gati të nisnin një etapë të re në shërbim të kombit. Në mesin e tyre janë Gentrin, një djalë nga Kosova, dhe Fjodora, një vajzë nga Librazhdi, të cilët jo vetëm që kanë përfunduar me sukses formimin e tyre, por përfaqësojnë shembuj të përkushtimit, guximit dhe transformimit personal nën uniformën ushtarake.

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) është institucioni i vetëm në vend që ofron formim të plotë ushtarak dhe arsimim të lartë për oficerët e ardhshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. E ndërtuar mbi standardet e NATO-s, me një kurrikul të përparuar që bashkon teorinë me praktikën, AFA synon të përgatisë liderë të zotë, të disiplinuar dhe të gatshëm për të përballuar sfidat e sigurisë në një mjedis kombëtar dhe ndërkombëtar në zhvillim të vazhdueshëm. Bashkë me nëntoger Arlen Ramën, pedagog dhe një nga figurat më të angazhuara në përgatitjen e brezit të ri të oficerëve, studentët ndajnë me ne përvojat, sfidat dhe emocionet që i kanë shoqëruar gjatë këtyre tre viteve. Kjo intervistë është një dritare reale mbi jetën në Akademi, një rrugëtim që shkon përtej stërvitjes dhe librave, drejt formimit të karakterit, përgjegjësisë dhe krenarisë në shërbim të atdheut.



Student Gentrin Shala

Gentrin, ti je një prej studentëve që vjen nga Kosova. Çfarë të shtyu të bëheshe pjesë e Akademisë së Forcave të Armatosura në Shqipëri?

Gentriti: Ishte një dëshirë e kahershme që të bëhesha pjesë e një institucioni që formon oficerë me integritet dhe përkushtim ndaj atdheut. Shqipëria dhe Kosova kanë lidhje të ngushta kombëtare, dhe për mua, AFA përfaqësonte një derë drejt profesionalizmit ushtarak në nivel të lartë. Kur pashë thirrjen për aplikime, nuk hezitova. I shtyrë dhe i motivuar edhe nga ngjarjet e dekadave të fundit në Kosovë, vendosa të aplikoj në këtë akademi!

Si ishin ditët e para në AFA? U ndjeve i pranuar?

Gentriti: Ditët e para ishin të vështira, nuk gënjej. Ritmi i jetës këtu është krejt ndryshe, zgjime të hershme, stërvitje intensive, disiplina strikte. Por falë shokëve dhe stafit akademik, shumë shpejt u ndjeva pjesë e familjes. Ne jemi një trup, një mendje dhe aty fillon vërtet formimi si oficer.

Cili ka qenë momenti më i vështirë gjatë këtyre tre viteve?

Gentriti: Pa dyshim, stërvitjet në terren – sidomos në kushte ekstreme. Më kujtohet një ushtrim 24 orësh në terren të hapur, pa gjumë dhe në shi të vazhdueshëm. Ishte një sfidë për mendjen dhe trupin, por gjithashtu një pikë kthese që më mësoi se sa larg mund të shkoj kur nuk dorëzohem.

Dhe momenti më i paharrueshëm?

Gentriti: Ceremonia e betimit ushtarak. Ajo ndjenjë kur ngre dorën dhe betohesh për atdheun, për kombin, për dinjitetin e uniformës... nuk harrohet kurrë. Ishte emocionues dhe njëkohësisht ngarkesë e madhe shpirtërore.

Pedagogët, shtylla e arsimit ushtarak

Po për pedagogët? Si ishte marrëdhënia me ta dhe roli i tyre në këtë rrugëtim?

Ata nuk ishin thjesht mësues. Ishin udhëheqës, mentorë dhe figura që na modeluan. Kam pasur fatin të më japin mësim oficerë me eksperiencë nga misionet në Kosovë, Afganistan dhe Bosnje. Ata e ndanin me ne jo vetëm teorinë, por sidomos përvojën në terren, duke na mësuar si të vendosësh kur ka presion real. Krenaria që ndjenim kur një pedagog fliste me pasion për Shqipërinë e bënte çdo orë mësimi më shumë se thjesht leksion ishte një thirrje për atdhedashuri.

Mbështetja e shtetit një investim për sigurinë

Shkolla ushtarake ka mbështetje të veçantë nga shteti shqiptar. Çfarë mund të na thoni rreth kësaj?

Gentriti: Është e vërtetë. Shteti shqiptar ofron mbështetje të plotë për çdo kadet: shkollimi është falas, sigurohet akomodimi në kushte shumë të mira, ushqimi, pajisjet, veshjet, transporti dhe gjithçka që ka të bëjë me jetesën brenda Akademisë. Për më tepër, kemi bursa mujore që na japin mundësinë të mos shqetësohemi për aspektet financiare. Kjo na lejon të fokusohemi plotësisht tek formimi ynë profesional dhe fizik.

Vlerësimi ndaj shkollës ushtarake, një derë drejt së ardhmes

Si e vlerësoni shkollën ushtarake në raport me universitetet e tjera civile?

Gentriti: Me bindje të plotë mund të them që shkolla

ushtarake është ndër më të përgatiturat në vend. Jo vetëm për nga cilësia akademike, por sidomos për disiplinën, strukturën dhe përgatitjen psikofizike që ofron. Ajo nuk të përgatit vetëm për një punë, por për një mision jetësor. Një oficer i sapo diplomuar ka siguri të menjëhershme në punësim, ka të drejtën të ndjekë specializime brenda dhe jashtë vendit, dhe ka një karrierë të qartë përpara. Është një formim që të hap dyer jo vetëm në Shqipëri, por edhe në strukturat euroatlantike të sigurisë.



Studente Fjodora Gjura

Fjodora, ti je një nga vajzat që përfundon me sukses Akademinë. Çfarë të shtyu ta përzgjijdhje këtë rrugë?

Fjodora: Për mua, kjo ishte një thirrje personale. E rritur në Librazhd, e kam parë gjithmonë vlerën e disiplinës dhe shërbimit ndaj vendit. Kisha një dëshirë të fortë për të thyer stereotipat që vajzat nuk janë për këtë profesion. Dhe sot, pas tre vitesh, mund të them me bindje që ia vlejti çdo orë e kaluar në këtë Akademi.

Si ishte të jesh vajzë në një ambient që tradicionalisht ka qenë më i dominuar nga meshkujt?

Fjodora: Nuk ishte e lehtë. Por AFA ka krijuar një mjedis gjithnjë e më përfshirës. Përkushtimi, aftësia dhe disiplina nuk kanë gjini – dhe këtë e ndjeva që ditët e para. Unë nuk trajtohesha si “vajza e klasës”, por si një kadet që pritej të jepte maksimumin. Dhe kjo më

motivoi më shumë.

Cilat janë aftësitë që ke fituar gjatë këtyre tre viteve?

Fjodora: Kam fituar më shumë sesa thjesht njohuri ushtarake. Kam ndërtuar karakter, qëndrueshmëri mendore, lidhshmëri, dhe mbi të gjitha, aftësinë për të marrë vendime nën presion. Sot ndiej se mund të përballem me çdo sfidë – jo vetëm në shërbim, por edhe në jetën personale.

Çfarë mesazhi do t'i jepje vajzave që mendojnë t'i bashkohen AFA-së?

Fjodora: Mos hezitoni! Akademia nuk është për të fortët fizikisht, por për ata që kanë vullnet të hekurt. Vajzat kanë vendin e tyre në uniformë. Nuk ka asgjë më të bukur sesa të shohësh një vajzë me kokën lart, që udhëheq me dije, përgjegjësi dhe dinjitet.

Pedagog përgjegjës, nëntoger Arlen Rama

Zoti Rama, si e vlerësoni rolin e Akademisë së Forcave të Armatosura në formimin e brezit të ri ushtarak?

Arlen Rama: Akademia është baza e profesionalizmit ushtarak në Shqipëri. Këtu nuk formohen vetëm oficerë të aftë për komandë, por edhe qytetarë të ndershëm, të përkushtuar ndaj interesit kombëtar. Tre vitet e studimit janë më shumë sesa një cikël akademik ato janë një transformim i plotë në mendësi, qëndrim dhe karakter.

Si ndiheni kur i shihni studentët tuaj duke u diplomuar?

Arlen Rama: Është një ndjenjë shumë e veçantë. E ndiej si një mision të përbushur. Kur i shoh studentët që veshin uniformën me krenari, e kuptoj se çdo orë mësimi, çdo korrigjim, çdo këshillë ka dhënë fryt. Gënjërit dhe Fjodora janë shembuj të shkëlqyer të gjeneratës së re.

Akademia është duke u modernizuar çdo ditë. Si e shihni të ardhmen e saj?

Arlen Rama: AFA po ecën me hapin e kohës. Me kampusin e ri modern në Tufinë, laboratorët digjitalë, dhe programe të reja master në siguri kibernetike dhe inteligjencë artificiale, po ndërtojmë



Pedagog përgjegjës, nëntoger Arlen Rama

një Akademi me standarde NATO-s. E ardhmja është premtuese dhe studentët që vijnë do të kenë mundësi të jashtëzakonshme për t'u formuar si liderë të së nesërës.

Një mesazh për brezin që do t'ju pasojë?

Arlen Rama: Mos e merrni lehtë këtë rrugë, por nëse e zgjidhni, jepjani vetes mundësinë për t'u formuar si njerëz me vlera. Uniforma kërkon më shumë se dije, kërkon përkushtim, ndershmëri dhe sakrificë. Nëse këto i keni, Akademia do t'ju japë gjithçka tjetër.

Faleminderit të gjithëve për këtë intervistë frymëzuese. Fjalët tuaja janë më shumë se rrëfime, janë dëshmi që në këtë Akademi ndërtohet e ardhmja e sigurisë kombëtare.





“Heroi im nën Uniformë”

Një Bisedë Zemre me major Genti
Bajlas dhe bijën e Tij, Alaja 8-vjeçare

Intervistoi:

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

Në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, Forcat e Armatosura nuk janë vetëm në stërvitje, gatishmëri apo patrullim. Ato janë gjithashtu në zemrën e çdo familjeje që i përket kësaj trupe. Çdo ushtarak/e që kthehet në shtëpi e gjen paqen te zëri i një fëmije, dhe çdo fëmijë që e di që prindi i tij mbron vendin, rritet me një ideal të lartë.

Për të gjithë prindërit me uniformë: gëzuar 1 Qershorin ju dhe fëmijëve tuaj! Falë jush, fëmijët tanë rriten të sigurt, të frymëzuar dhe krenarë.

Kjo intervistë e veçantë nuk flet vetëm për uniformën, disiplinën apo detyrën, por për dashurinë e një babai, forcën e një ushtaraku, dhe ëndrrat e një fëmije, të gjitha të thurura bashkë, nën hijen e një flamuri dhe zemrës së një familjeje ushtarake.

Ndërmjet Atdheut dhe Zembrës

Në periferi të Tiranës, në një lagje të qetë, nën hijen e disa pemëve të blerta dhe cicërimën e zogjve që të kujtojnë fillimin e verës, ndodhet një apartament i



ngrohtë dhe i thjeshtë. Është e shtunë paradite, një ditë që për shumë fëmijë nënkupton lodra, liri dhe ëndrra të vogla. Por për vajzën 8-vjeçare, Alaja Bajlas kjo ditë ka një domethënie edhe më të veçantë, babai i saj, majori i Forcave të Armatosura, është sot në shtëpi. Për shumë fëmijë të tjerë kjo është normale, ndërsa për fëmijët e ushtarakëve ky është një 'luks'.

Në një qoshe të dhomës së ndenjes, e cila është zbukuruar me vizatime, libra, medalje dhe një foto të madhe familjare, qëndron uniforma ushtarake e palosur me kujdes, gati për misionin e radhës. Por sot ajo uniformë qëndron pezull. Sepse sot është 1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.

Major Genti Bajlas, faleminderit që na hapët dyert e shtëpisë në këtë ditë kaq të rëndësishme! Si ndiheni sot?

Ndihem i privilegjuar që jam në shtëpi. Këto janë ato ditët që, si ushtarak, më mungojnë më shumë. Ndonjëherë mund të mungosh në festa, ditëlindje, apo edhe në çaste të vogla që për fëmijën kanë vlerë të madhe. Por kur je këtu, e ndjen sa shumë peshon kjo kohë. E ndjej veten shumë të bekuar. Jo vetëm si ushtarak, por mbi të gjitha si prind. Të jesh pjesë e Forcave të Armatosura është një mision i shenjtë, por të jesh prind është një bekim. Dhe në këtë ditë, dua t'i përulëm të gjithë fëmijëve tanë që presin me padurim një përqaftim, një fjalë të ngrohtë, një ditë të plotë me prindërit e tyre.

Sa e vështirë është të jesh prind ushtarak?

Është një nga ato sfida që nuk ka manual. Një pjesë e shpirtit tënd është gjithmonë në alarm, në gatishmëri, në stërvitje, ndërsa pjesa tjetër mundohet të mbajë të paprekur atë lidhje të shenjtë me familjen. Alaja më mëson çdo ditë çfarë do të thotë durim, mirëkuptim dhe dashuri e pakushtëzuar. Është një sfidë që nuk e fiton gjithmonë, për fat të keq. Ka momente kur jam në terren, jashtë shtetit në misione paqeruajtëse, apo në stërvitje të gjata dhe nuk jam aty kur Alaja ka koncertin e shkollës, apo kur thjesht ka nevojë për ndihmë në detyrat e shtëpisë. E vogla jonë çdo ditë na thotë se: dashuria nuk matet me orë, por me praninë që



mbetet edhe kur nuk je fizikisht aty.

Ka pasur ndonjë moment të veçantë që ju ka prekur si prind?

Po, shumë... Shpesh, më ndodh të jem me ditë të tëra larg familjes, dhe Alaja më dërgon letër ku shkruan: "Babi, unë e di që ti je atje sepse po na mbron. Mos u mërzit që nuk ishe në koncertin tim, unë e këndova këngën vetëm për ty". E lexova atë letër në një çadër ushtarake, dhe sytë mu mbushën me lot. Në ato momente ndjen sa shumë sakrifikon, por edhe sa shumë fiton kur je prind.



Alaja e vogël na bashkohet për t'i dhënë ngjyra dhe jetë kësaj interviste.

Alaja, çfarë ndjen kur babi është larg në mision?

Në fillim mërzitem. Sidomos kur kthehem nga shkolla dhe e di që nuk është në shtëpi. Më mungon shumë kur është larg, por e di që po bën diçka të rëndësishme. Kur e shoh me uniformë, ndjej krenari, si kur shoh një superhero. Dhe pastaj mamaja më tregon se ku është dhe pse ka shkuar... Kur flasim me video, i tregoj çfarë kam vizatuar, dhe ai më thotë që do t'i varim në mur kur të vijë. Kur kthehet, e përqafoj fort dhe ndihem e lumtur.. shumë e lumtur...

Çfarë e bën babin të veçantë për ty?

Ai më dëgjon gjithmonë. Edhe kur nuk është këtu, më shkruan mesazhe, më pyet për notat, për shoqet. Kur është me mua, nuk përdor telefonin fare, jemi vetëm ne të dy. Babi më thotë se një ushtarak i mirë është edhe një baba i mirë.

Çfarë dëshiron t'i thuash babin sot, në këtë ditë të veçantë?

I them: faleminderit që gjithmonë përpiqesh të jesh këtu! Edhe kur nuk është fizikisht, e ndjej që është me mua. Babi, të dua shumë!

Në fund të intervistës, pasi Alaja i dhuroi babait



një vizatim ku kishte vizatuar një familje me flamurin shqiptar mbi kokë dhe një ushtar që mban për dore një fëmijë, majori ndalet, mban frymën për pak dhe thotë: “Ne ushtarakët shpesh herë kemi imazhin e burrit të fortë, të disiplinuar, të heshtur. Por brenda nesh ka një zemër që rreh fort për njerëzit që lëmë pas. Fëmijët tanë janë motivi që na ngre çdo mëngjes dhe na jep forcën për të përballuar çdo sfidë”.

Në këtë 1 Qershor, mes shumë aktiviteteve, dhuratave dhe festimeve, le të mos harrojmë fëmijët e atyre që shërbejnë me përkushtim në mbrojtje të Shqipërisë. Le t’u japim atyre kohë, dashuri dhe siguri, sepse prindërit e tyre japin gjithçka për të na garantuar një të ardhme më të mirë.

Në një shoqëri që kërkon gjithnjë e më shumë që forcat e sigurisë të jenë të afërta me komunitetin, figura e ushtarakut prind është një model frymëzues për të gjithë, një njeri që në emër të vendit e jetës, bën gjithçka për paqen, dhe që në zemrën e vet mban fëmijën e vet si motivin më të madh për të vazhduar përpara.

Gëzuar 1 Qershorin të gjithë fëmijëve shqiptarë!





Heronjtë **me uniformë të kuqe**

Rrëfimi i zjarrfikësit Olsi Ziso, i cili prej 7 vitesh sfidon flakët dhe rrezikun për të shpëtuar jetë. Një histori guximi, sakrifice dhe krenarie shqiptare



Intervistoi:

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

Në oborrin e Qendrës së Zjarrfikëses në Maliq, era sjell ende një aromë të rëndë tymi. Është ora 9 e mëngjesit, por sytë e djemve të rinj duken të lodhur sikur nuk kanë fjetur prej ditësh. Përballë nesh qëndron Olsi Ziso, një 28-vjeçar nga Korça, që prej shtatë vitesh jetën ia ka kushtuar flakës, jo për ta ndezur, por për ta shuar. Uniforma e kuqe duket e rëndë mbi shpatullat e tij, por kur fillon të tregojë, kupton se peshën më të madhe e mbart në shpirt.

Olsi, kthehemi pas në kohë. Si e kujton ditën e parë kur veshe këtë uniformë?

Ishte qershor i vitit 2018. Ishte vapë, ashtu si çdo fillim vere në Korçë. Kur më dhanë uniformën e kuqe, për një çast më dukej si një mantel i huaj. Por brenda meje ndjeva diçka që s'e kisha ndjerë më parë: një ndjesi se jeta ime nuk do të ishte më e imja, por e njerëzve që do të ndihmoja. Atë ditë vendosa se nuk do të tërhiqesha, sado e vështirë të bëhej.

Për shumë të rinj, ky profesion duket tepër i rrezikshëm. Çfarë të shtyu të hyje në këtë rrugë?

Unë jam rritur në një mjedis ku ndihma për tjetrin është vlerë. Korça është qytet solidar. Kam parë gjithmonë njerëz që sakrifikojnë për njëri-tjetrin. Kur pashë mundësinë të hyja në Zjarrfikëse, ndjeva se ishte thirrja ime. Nuk më tërhoqi ideja e rrezikut, por e mundësisë për të qenë dikush që shpëton jetë.

Ne e ndjekim Olsin ndërsa hyn në garazhin ku

qëndrojnë mjetet. Me dorën mbi një makinë të vjetër zjarrfikëse, ai buzëqesh me trishtim: “Kjo makinë ka parë më shumë flakë se sa shumë prej nesh. Ka qenë në operacione ku gomat e saj digjeshin nga nxehtësia e terrenit”.

Çfarë ndodh kur bie alarmi? Si duket ai moment?

Është një sekondë që të ndryshon gjithçka. Mund të jesh duke ngrënë bukë, duke folur me një shok, apo edhe duke qeshur. Dhe papritur, sirena të bën të ngrihesh menjëherë në këmbë. Zemra të rreh fort, gjaku të vlon. Nuk di se çfarë të pret, vetëm vrapon, hipën në mjet, dhe e di që mund të jetë dita më e rëndë, ose më e bukura, nëse ia del të shpëtosh dikë.

Na trego një nga momentet më të vështira që nuk do ta harrosh kurrë.

Një nga ato momente ishte në fshatin Strelcë, në një pyll të madh me pisha. Zjarri përhapej me shpejtësi të frikshme. Terreni ishte aq i thyer, sa mjetet nuk mund të hynin. Ne ecnim në këmbë, me bidonë e pompa shpine. Tym, nxehtësi, frikë. Për një çast flaka u afrua aq shumë sa mendova: “Këtu mund të mbetem.” Por shokët nuk dorëzoheshin. Njëri thërriste tjetrin, jepnim zemër me zë. Ajo ditë na mësoi se forca e grupit është më e madhe se çdo flakë.

Ju keni qenë edhe në operacione jashtë Shqipërisë, në Greqi. Çfarë kujtimesh të kanë mbetur nga ajo situatë tepër e vështirë?

Në Aleksandropol, 15 ditë pa pushim. Zjarri nuk njihte kufij. Punonim krah për krah me zjarrfikës grekë. Ata kishin mjete më të shumta, por ne kishim guximin dhe përkushtimin. Por kur sheh se një banor të falënderon me lot në sy, nuk ka rëndësi nëse kishe





cisternë 20 mijë litra apo vetëm një pompë të vogël.

Në zyrë, mbi tavolinë, Olsi mban një fotografi të ekipit gjatë operacionit në Greqi. Flakët ndriçojnë qiellin, fytyrat e djersitura duken të lodhura, por sytë shkëlqejnë nga krenaria.

Në Shqipëri shpesh përballeni edhe me banorë që nuk duan të largohen nga banesat e tyre edhe pse iu rrezikohet jeta. Si ia dilni?

Ky është momenti më i dhimbshëm. Ata e shohin shtëpinë si gjithë jetën e tyre. Në Gramsh, një i moshuar u shtrëngua pas derës dhe tha: “Po iku kjo shtëpi, iku gjithë jeta ime”. Lotët më rridhnin ndërsa e bindja. Dhe e mora prej krahu. I thashë: “Xhaxha, jeta jote vlen më shumë se çdo gur”. Dhe sot jam i lumtur që e shpëtua. Sepse shtëpinë mund ta ndërtohen sërish, por jetën jo.

Po frika? A ka vend për të?

Frika është gjithmonë aty. Do të gënjeja po të thosha ndryshe. Por mbi frikën qëndron përgjegjësia. Kur sheh kolegun tënd të futet në flakë, edhe ti futesh. Kur e di se aty brenda ka jetë njerëzish, frika kthehet në forcë.

Çfarë ju mungon më shumë në këtë profesion?

Pajisjet. Ne kemi zemër, kemi vullnet, kemi forcë. Por shpesh mungojnë makineritë, cisternat e mëdha, mjetet për terrene të vështira. Shpesh na është dashur të ecim me orë të tëra në këmbë me peshë mbi shpinë, sepse rrugët nuk lejojnë mjetet.

Pas gjithë këtyre përvojave, çfarë ndjen sot kur sheh uniformën tënde?

Krenari. Po edhe përgjegjësi. Nuk është një punë që e bën për rrogën. Është një betejë që e bën për shpirtin. Çdo ditë e di që mund të shkoj në shtëpi i lodhur, i tymosur, por i lumtur që një jetë është shpëtuar. Dhe kjo mjafton.

Olsi, cili është mesazhi juaj në këto ditë të vështira që po kalon vendi ynë por dhe gjithë Europa, ku flakët

e zjarrit shkaktuar nga njerëz të papërgjegjshëm po përpijnë banesa, pyje dhe gjënë e gjallë?

“Këto ditë nuk janë të lehta, as për Shqipërinë, as për Europën. Flakët nuk njohin kufij, nuk bëjnë dallim mes shtëpisë së një të varfri apo të një të pasuri, mes pyllit të një fshati apo malit të një shteti tjetër. Çdo zjarr është një plagë që prek të gjithë shoqërinë. Prandaj mesazhi im është i qartë: të gjithë duhet të bëhemi më të përgjegjshëm. Shumë prej këtyre zjarreve nuk i sjell natyra, por dora e njeriut nga pakujdesia, nga papërgjegjësia, madje edhe nga dashakeqësia. Dhe kur një person ndez një zjarr, duhet të kuptojë se nuk djeg vetëm një shkurre apo një kasolle, por vë në rrezik jetë njerëzish, jetën e fëmijëve tanë, të kafshëve, të pyjeve që janë mushkëritë e vendit tonë. Si zjarrfikës, çdo ditë shoh se sa e brishtë është jeta. Një shkëndijë mjafton të shndërrojë gjithçka në hi. Por po aq mjafton edhe një gjest përgjegjësie që ta ndalojë atë shkëndijë. Prandaj thirrja ime është: mos u bëni indiferentë! Mos prisni që të vijë zjarrfikësi për të shpëtuar atë që mund të shmangej me kujdes. Të gjithë kemi një rol në këtë betejë. Dua t’u them qytetarëve: bashkëpunoni me ne, lajmëroni menjëherë, tregohuni vigjilentë. Dhe mbi të gjitha, mos e nënvlerësoni zjarrin. Sot më shumë se kurrë, është koha për solidaritet dhe ndërgjegjësim. Vetëm bashkë mund të mbrojmë shtëpitë tona, pyjet tona, jetën tonë. Sepse flakët janë të forta, por më i fortë është vullneti i njerëzve që bashkohen për të shpëtuar atë që kemi më të shtrenjtë.”

Intervista me Olsi Zison na kujton se heronjtë nuk janë vetëm në libra. Ata jetojnë mes nesh, shpesh pa u vënë re, nën një uniformë të kuqe që përfaqëson guximin, sakrificën dhe dashurinë për jetën. Në një kohë kur zjarret, përmytjet dhe emergjencat po shtohen, zjarrfikësit shqiptarë mbeten një mur mbrojtës për qytetarët. Ata janë forca që e përballon flakën me vendosmëri dhe që shpesh vë jetën në rrezik për të shpëtuar jetën e dikujt tjetër.

Gazeta “Ushtria” u shpreh mirënjohjen më të thellë Olsit dhe çdo kolegu të tij, që çdo ditë, me pak mjete e shumë zemër, mbrojnë Shqipërinë.

Agron Goga:



Buzëqeshja

që lind nga dhimbja

Intervistoi:

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI


Agron Goga: Ushtar i Disiplinës, Shkrimtar i Humorit, Babai i Dy Zemrave

Në një kohë kur fjala po bëhet gjithnjë e më bosh, ai e përdor atë si bisturi të mendjes dhe zemrës. Agron Goga nuk është thjesht një emër në librat e humorit apo në listat e skenaristëve të suksesshëm shqiptarë. Ai është një nga ata njerëz që të bën të qeshësh dhe të mendosh

nga kjo plagë e tij e heshtur, ka lindur një thellësi tjetër në krijimtarinë e tij, një përzierje e rrallë e dhimbjes me butësinë, e të vërtetës me ironinë.

Në këtë intervistë Agron Goga flet pa rezerva, për artin, për humbjen, për jetën pas dhimbjes dhe për forcat që e mbajnë në këmbë. Ky është një rrëfim i sinqertë për ata që dinë të qeshin edhe kur jeta i ka mësuar të qajnë.

Në botën e artit dhe satirës shqiptare, emri i Agron Gogës nuk kalon pa u ndalur. Një jetë ndërmjet uniformës ushtarake dhe penës së mprehtë, ndërmjet zërit të komandës dhe zërit të humorit. Por përtej krijimtarisë së pasur, ai është edhe një



menjëherë pas buzëqeshjes.

Për dekada me radhë, Goga ka qenë njeriu pas kamerës, pas skenës, pas asaj të qeshure që e kemi ndarë në shtëpitë tona, nga telekomeditë, te videot humoristike, deri te skeçet ikonike të “Portokallisë” dhe “Alpazarit”. Por shumë pak prej nesh kanë njohur burrin që, pas buzëqeshjeve publike, ka përballuar humbje të thella private.

Para disa vitesh, jeta i mori bashkëshorten, shoqen e tij të jetës dhe lexuesen e parë të çdo teksti. Sot jeton me dy fëmijët e tij, i përkushtuar ndaj tyre si prind dhe si mik, duke ndërtuar për ta një botë ku dashuria, kujtimi dhe buzëqeshja nuk mungojnë asnjëherë. E pikërisht

baba që sot jeton me dy fëmijët e tij, pas humbjes së bashkëshortes disa vite më parë, një plagë që e ka bërë më të ndjeshëm, më të thellë dhe më njerëzor.

Agron Goga është një shkrimtar, humorist dhe oficer i Forcave të Armatosura të Shqipërisë, i njohur për kontributin e tij të pasur në letërsinë satirike dhe humoristike shqiptare. I lindur më 2 nëntor 1961, në Roskovec të Fierit, ai ka ndjekur një karrierë të gjatë ushtarake dhe artistike.

Arsimi dhe Karriera Ushtarake

Agron Goga përfundoi Shkollën e Mesme

Ushtarake “Skënderbej” (1976–1980) dhe Akademinë Ushtarake (1981–1984). Më pas ndoqi trajnime në vende të ndryshme të NATO-s, duke u specializuar në marrëdhëniet civilo-ushtarake dhe komunikimin me publikun dhe median.

Pas një karriere ushtarake deri në vitin 1994, ai u emërua shef i marrëdhënieve me publikun në Forcën Detare (1994–2007), më pas shef i sektorit të Multimedias në Qendrën Kulturore të Forcave të Armatosura (2007–2013), dhe që nga viti 2013 punon në sektorin e aktiviteteve në Qendrën e Kulturës së FARSH-së.

Krijimtaria Artistike

Goga ka një krijimtari të gjerë që përfshin: Vëllime me tregime humoristike: “Vetëvraska e Gomarit”; “Si nuk u ngrit një bust për mua!”, “Për një çikëz Amerikë”; “Lajthitje pleqërie”; “Radha ime të mbush xhepat”.

Filma dokumentarë ushtarakë: Ka qenë skenarist dhe realizues i filmave si “Skënderbegasit”, “Detaria shqiptare”, “Demontimi” dhe “5 Vjet në NATO”.

Librete komedie me Teatrin e Varietesë, Tiranë: “Qejflinjtë”, “Në sallën e gjyqit” “Dhuratë për ju”, “Rrumpallë show” dhe “Modeli” (2001).

Telekomedi: “Qejflinjtë”, “Një nuse e jashtme”, “Bobi”, “Një kandar nga Amerika”, “Sherrxhinjtë”, “Për një kokërr fik”.

Skenarist i videokasetave si “Hallall pensionin”, “Të na rrojë komshiu”, “Zotni Palloshi...”, “Obobo... na zunë ethet”, “Iku vapa me gushtin”.

Ka qenë skenarist për personazhe të emisionit “Portokalli” si Xha Temja, Aneja, Jorgaqi, dhe Terry, si dhe konsulent i serialit televiziv “Piruet”, me regji të Arjan Çuliqit. Skenarist dhe shkrimtar i spektaklit “Alpazar”: Ka kontribuar në këtë spektakël nga viti 2012 deri në vitin 2024.

Çmime dhe Vlerësime

Agron Goga ka fituar çmime të rëndësishme për kontributin e tij në letërsinë satirike: Çmimi i Parë në Konkursin Mbarëkombëtar të Letërsisë Satiriko-Humoristike “Niko Nikolla”, për vëllimin me tregime “Si nuk u ngrit një bust për mua!”. Çmimi i parë në Konkursin e Komedisë organizuar nga Teatri i Varietesë Tiranë me komedinë “Një formulë për një dyqan”.

Nëse në jetën ushtarake kërkohet seriozitet dhe përpikëri, Agron Goga ka treguar se edhe aty ka vend për një dozë të shëndetshme humorit. Me një karrierë që shtrihet nga godina e Akademisë Ushtarake deri në skenat e humorit shqiptar, Goga është një zë i pazëvendësueshëm në satirën moderne shqiptare.

“Jeta më mësoi që ndonjëherë humorin e mëson nga lotët”

Z. Goga, përveçse ushtarak dhe shkrimtar, jeni edhe një njeri që keni kaluar një dhimbje të madhe personale. Si ka ndikuar kjo në krijimtarinë tuaj?

Është e vështirë të flasësh për humbje të tilla. Bashkëshortja ime ishte



jo vetëm shtylla e shtëpisë, por edhe lexuesja ime e parë. Pas largimit të saj, gjithçka u kthye në heshtje. Por fëmijët e mi, dashuria për ta, më mbajtën gjallë. Sot, çdo varg, çdo rresht i shkruar, ka edhe pak nga ajo që nuk është më dhe shumë nga ata që më japin forcë të vazhdoj.

“Humori është mburojë, por nuk është arratisje”

Si ia dilni të shkruani humor edhe kur vetë përjetoni trishtim?



Sepse është mënyra ime për të qëndruar në këmbë. Kur shkruaj një parodi, kur ndërtoj një situatë komike, nuk po largohem nga realiteti, përkundrazi, po e përballoj me të vetmen armë që më ka mbetur: fjalën. Dhe ajo fjalë më ndihmon jo vetëm mua, por

edhe lexuesin të kuptojë se jeta është e bukur edhe kur dhemb.

“Dashuria për fëmijët më mban të fortë, kur ndonjëherë do të doja vetëm të heshtja”

Cila është forca juaj sot, pas gjithë këtyre viteve?

Fëmijët e mi. Ata janë publiku im më kritik, por edhe më i sinqertë. Janë dritë në një botë që ndonjëherë errësohet. Për ta jetoj, krijoj, dhe mendohej të jem shembull i qëndrueshmërisë përballë jetës. Më kanë mësuar se dashuria nuk humbet, ajo vetëm ndryshon formë.

“Njeriu duhet të mësojë të qeshë edhe pas një lamtumirë”

Çfarë keni mësuar për jetën në këto vite?

Që nuk kontrollojmë gjithçka, dhe nuk duhet. Shpesh duhet të falënderojmë çdo ditë që zgjohemi, çdo përqafim, çdo “të dua” që mund të themi. Sepse një ditë mund të mos kemi kohë. Kam mësuar të mos e shtyj dashurinë për nesër dhe ta ndaj buzëqeshjen edhe kur zemra më qan.

Ushtria e sotme ka nevojë për artin, po aq sa për armët. Jeni ende aktiv në Qendrën e Kulturës së FA? A ka vend arti në Forcat e Armatosura?

Absolutisht po. Arti është pjesë e moralit të një ushtari. Ai të ndihmon të reflektosh, të qëndrosh i lidhur me realitetin dhe me njerëzit. Kultura në FA është forcuar ndjeshëm dhe kjo është diçka që më gëzon.

Humori nuk shkruhet për të bërë të qeshin, por për të bërë të mendojnë. Çfarë do t’u thoshit të rinjve që duan të shkruajnë humor?

Të mos nxitohen për të bërë njerëzit të qeshin. Të vëzhgojnë jetën, të lexojnë dhe të jetojnë me njerëzit. Humori i mirë është ai që të bën të buzëqeshësh dhe të thuash: “Po kjo është e vërtetë!”. E atëherë je bërë shkrimtar.

Profili i një ushtaraku-shkrimtar si Agron Goga është dëshmi se arti nuk njih uniformë, dhe se e qeshura është armë paqësore që shpesh çdo dogmë. Vepra e tij është një pasuri që flet me gjuhën e mençurisë, të popullit dhe të zemrës.

GJEOPOLITIKË



Strategjitë dhe risitë

e operacioneve të qershorit 2025,
"Rrjeta e merimangës", "Ngritja e
Luanit" dhe "Çekani i mesnatës"



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Lufta, siç treguan operacionet e qershorit, nuk po zhvillohet vetëm në fushëbetejë, por edhe në kibernetikë, media, ekonomi dhe këto operacione janë të përshtatura për këtë realitet. Operacionet e këtij qershori: “Rrjeta e merimangës” nga SBU e Ukrainës, “Ngritja e Luanit” nga Izraeli dhe Mossad, dhe “Çekani i Mesnatës” nga SHBA-të, janë operacione speciale të inteligjencës, forcave ushtarake në të gjithë domainet e luftës, si dhe kundër-terrorizmit, të cilat ndajnë disa cilësi të përbashkëta, pavarësisht kontekstit të ndryshëm gjeopolitik.

Planifikim afatgjatë dhe me detaje, mashtrim strategjik, fshehtësi operacionale, bashkëpunim multi-domain dhe befasi në ekzekutim të operacionit janë 5 elementët e përbashkët të operacioneve të qershorit 2025. Çdo aspekt i operacioneve është planifikuar në detaje, nga logjistika, orari, rrugët e tërheqjes, koordinimi mes njërive, deri te reagimi ndaj skenarëve të papritur. Rreziku i lartë kërkon zero improvizim në momentin e sulmit. “Rrjeta e merimangës” kishte një planifikim të gjatë 18 muaj për të ndërtuar mbulimin, për të rekrutuar njerëzit e duhur brenda Rusisë dhe për të krijuar rrjete pa rënë në sy të FSB. “Ngritja e Luanit”, Izraeli përgatit çdo sulm me mbikëqyrje satelitore dhe dronë për javë të tëra para ndërhyrjes.

Të tria operacionet janë rezultat i bashkëpunimit të ngushtë midis strukturave të inteligjencës, ushtrisë dhe forcave speciale. Operacionet “Rrjeta e merimangës” (Ukrainë), “Ngritja e Luanit” (Izrael), dhe “Çekani i Mesnatës” (SHBA) sjellin të reja të rëndësishme në fushën e inteligjencës moderne, duke reflektuar evolucionin e mënyrave me të cilat shtetet luftojnë kërcënimet asimetrike, terrorizmin dhe

agresionin hibrid. Inteligjenca është e përshtatshme për një botë ku lufta është “pa uniforma” dhe e decentralizuar. Këto operacione përfaqësojnë një qasje më të avancuar, me fleksibilitet dhe të integruar ndaj sfidave të sigurisë kombëtare.

Mashtrimi Strategjik (Strategic Deception) bëhet me qëllim që kundërshtari të drejtohet gabimisht në drejtim të rremë, përmes informacioneve të rreme, mashtrimeve taktike, ose veprimeve të mbuluara dhe i jep kohë agjentëve për të vepruar pa u zbuluar, në të tre operacionet e qershorit.

Fshehtësia (Operational Secrecy), mban të gjithë operacionin larg syrit të medias, aleatëve dhe më e rëndësishmja – larg radarit të armikut. Në të njëjtën kohë ul rrezikun e dështimit dhe ruan elementin e befasisë. Përveç CIA dhe DIA edhe SBU bën që agjentët të veprojnë shpesh pa asnjë shenjë ose mbështetje zyrtare, ndonjëherë as qeveria nuk e pranon menjëherë përfshirjen. Mossad nga ana e tij nuk lë gjurmë, nuk pranon përgjegjësinë për sulmet, duke përdorur strukturë të besueshme për mohueshmëri (plausible deniability).

Bashkëpunimi Multi-Domain (Multi-Domain Coordination) bëri që Integrimi i inteligjencës, forcave speciale, teknologjisë, cyber, hapësirës ajrore dhe diplomacisë të jetë vendimtar në suksesin e tij. Këto operacione nuk janë thjesht ushtarake. Befasia (Surprise) pati një rol kryesor në suksesin e tre operacioneve pasi goditja e befasishme kryhet kur armiku nuk e pret goditjen, ai nuk ka kohë për të reaguar apo për të shpëtuar. Duke përdorur befasinë mban iniciativën në duart e sulmuesit dhe reduktun rrezikun për personelin.

“Rrjeta e merimangës” përfshinte koordinimin midis SBU dhe partnerëve të jashtëm të inteligjencës. “Ngritja e luanit” ishte një operacion shumë i sofistikuar nga Mossad dhe IDF. “Çekani i mesnatës” përfshin Delta Force, CIA dhe komandat speciale të SHBA-së. Të gjitha synojnë neutralizimin e një kërcënimi specifik, zakonisht një individ ose grup me rëndësi të lartë. Në operacionin izraelit, ka eliminime të liderëve të Hamasit apo Hezbollahut. Ukraina synon individë të përfshirë në agresionin rus, shpesh operativë të FSB ose GRU. Të gjitha operacionet kanë mbështetur vendimmarrjen në inteligjencë të



saktë dhe të thellë, që përfshin, Mbikëqyrje satelitore dhe sinjalistikë (SIGINT), Informatorë në terren (HUMINT) dhe dronë vëzhgimi ose sulmues (në rastin e Izraelit dhe SHBA-së).

Këto operacione nuk kanë vetëm objektiva ushtarake por edhe efekt psikologjik mbi kundërshtarin (paralajmërim, frikësim, kaos dhe pasiguri). Ndikim në opinionin publik dhe në perceptimin ndërkombëtar, dhe propagandë e kontrolluar që forcon legjitimitetin e veprimeve. Të tria mbahen sekrete deri pas përfundimit, me publikime të kontrolluara, një komunikatë zyrtare me detaje të kufizuara, ku zakonisht nuk jepen emrat e të gjithë pjesëmarrësve ose metodat e sakta. Janë të autorizuar nga krerët e shtetit ose nga strukturat më të larta të sigurisë kombëtare. Në shumë raste, janë pjesë e strategjive më të gjera të mbrojtjes kombëtare.

Këto operacione zhdukën kufirin mes mbledhjes së inteligjencës dhe ekzekutimit të operacioneve. Inteligjenca nuk është më thjesht analizë pasive por në të tre rastet ajo drejton, përgatit dhe ndihmon në realizimin e objektivit në kohë reale. Agjentët e inteligjencës veprojnë gjithashtu si operatorë në terren. Për herë të parë, inteligjenca sinjalistike (SIGINT), analiza e të dhënave të mëdha, gjeolokacioni dhe monitorimi i rrjeteve sociale përdoren në kohë reale për: Lokalizimin e objektivave, Parashikimin e lëvizjeve të tyre dhe Koordinimin e sulmeve me precizion kirurgjikal. Operacionet nuk varen më vetëm nga survejimi teknik, por mbështeten shumë te rrjetet njerëzore (HUMINT) të ndërtuara brenda organizatave armike. Rasti i “Rrjetës së merimangës” tregon ndërtimin e rrjeteve të spiunazhit brenda Rusisë, një arritje shumë e vështirë operationale. Risi në këtë fushë është koncepti i spiunazhit klasik në një kontekst modern.

këto operacione u realizuan me bashkëpunim të drejtpërdrejtë me partnerë si CIA, MI6, BND etj. Inteligjenca është e ndërkombëtarizuar, duke kaluar kufijtë shtetërorë dhe burokracitë. Inteligjenca në të tre operacionet funksionon si rrjet ndërkombëtar me efikasitet të lartë. Këto operacione nuk janë vetëm për të vrarë një person por ato janë pjesë e një strategjie më të gjerë psikologjike, politike dhe ndërkombëtare. Në disa raste (si operacionet e Mossad), objektivat publikohen me qëllim për të demoralizuar kundërshtarin ose për të fituar legjitimitet. Inteligjenca në këtë rast bëhet mjet i ndikimit politik dhe diplomatik, jo vetëm i sigurisë. Të tria operacionet janë asimetrike, të shpejta, dhe me zero ose pak pasoja për civilët. Ky model e zhvendos inteligjencën nga lufta klasike drejt luftës kirurgjikale dhe të pastër në sy të opinionit publik. Inteligjenca e re është e saktë, etike dhe me kontroll të narrativës.

Roli i HUMINT (Human Intelligence - inteligjenca njerëzore) dhe SIGINT (Signals Intelligence - inteligjenca e sinjaleve) ka qenë vendimtar në suksesin e operacioneve “Rrjeta e merimangës”, “Ngritja e Luanit”, dhe “Çekani i Mesnatës”. Të dyja këto forma të inteligjencës janë shtylla të mbështetjes dhe elementë thelbësorë për planifikimin, lokalizimin, vendimmarrjen dhe ekzekutimin e operacioneve të tilla të ndjeshme. HUMINT përfshin burime si, informatorë në terren, spiunë të infiltruar, dezertorë, dëshmitarë, bashkëpunëtorë ose rrjete të mbuluara. Kjo është inteligjenca më delikate dhe shpesh më e vlefshme për operacionet e precizionit të lartë.

Ukraina ndërtoi rrjete agjentësh të infiltruar brenda territorit rus, përfshirë qytetarë rusë që bashkëpunonin në mënyrë sekrete. Këta agjentë dhanë informacion për lëvizjet, vendndodhjet dhe zakonet e

objektivëve, si oficerë të GRU, FSB, gjeneralëve apo shkencëtarëve atomikë të luftës. HUMINT shërbeu për identifikimin e objektivëve për likuidim ose rrëmbim gjeneralësh dhe shkencëtarësh bërthamorë. Agjentët e HUMINT dhanë informacion kyç për lokacionet e liderëve të Hamasit apo Hezbollahut, shpesh duke u fshehur në ndërtesa civile. HUMINT ndihmoi në infiltrimin e komunikimeve dhe në vendosjen e kurtheve. HUMINT ka ndihmuar në ndërtimin e modeleve të zakoneve të objektivëve dhe ndonjëherë edhe në rekrutimin e bashkëpunëtorëve brenda celulareve terroriste.

SIGINT përfshin përgjimin e komunikimeve (telefonike, radio, satelitore, internet) dhe analizimin e tyre për të gjetur informacione të dobishme. SBU ka përdorur përgjime të telefonatave dhe komunikimeve digjitale të oficerëve rusë, për të identifikuar vendndodhjen, udhëtimet apo planet. SIGINT ka zbuluar gjithashtu rrjete të fshehta komunikimi të GRU dhe FSB, të cilat më pas janë komprometuar. Mossad ka përdorur teknologji të avancuar për përgjim celular dhe dronë të pajisur me mjete për interceptim. Në shumë raste, janë lokalizuar liderët e Hamasit përmes përgjimeve nga telefonata ose komunikime të dërguara nga aplikacione si WhatsApp, Telegram, etj. SIGINT ndihmoi gjithashtu në monitorimin e komunikimit ndërmjet qelizave terroriste. CIA dhe NSA përdorin SIGINT në mënyrë masive për të ndjekur objektivat në kohë reale, duke përgjuar telefonat satelitorë, bisedat me radio ose komunikimet në rrjetet sociale.

Një fushatë ajrore e zhvilluar të shtunën, 22 qershor 2025, ku Shtetet e Bashkuara goditën tre lokacione bërthamore në Iran – Fordow, Natanz dhe Isfahan – me përdorimin e bunker buster bombave GBU 57 “Massive Ordnance Penetrator” (MOP) dhe raketa Tomahawk. 7 bombardues B 2 “Spirit” u nisën nga baza Whiteman, Missouri, duke fluturuar mbi Atlantik dhe Mesdhe me mbi 125 avionë mbështetës (avionë cisternë, avionë luftarakë si F 35, F/A 18, Growlers për luftë elektronike etj.). 14 bomba MOP prej rreth 13.6 tonësh, secila u hodhën, 12 nga këto në Fordow dhe 2 në Natanz . Një nëndetëse qëllloi mbi 30 raketa Tomahawk mbi Isfahan. Operacioni ishte një surprizë e plotë operative, pasi një skuadrilje B 2 u përdor për mashtrim taktik (deception), duke fluturuar drejt Paqësorit, ndërsa të tjerët u drejtuan në Iran. Të gjithë bombat dhe raketat u hodhën midis orës 18:40 - 19:05 dhe misioni përfundoi brenda 25 minutash . Është misioni më i madh i B 2 nga viti 2001, koordinuar

me Cyber Command, Space Command, dhe komanda të tjera amerikane.

Planifikim sekret, për 15 vite, përfshiu koordinimi i rrugës së fluturimit, logjistikës së rifurnizimit në ajër, lokalizim të saktë, operacioneve elektronike, roleve të detyrueshme për Cyber Command dhe mashtrime taktike. Nivel i kufizuar politikisht, niveli i lartë i të përzgjedhurve e dinte vetëm ndarjen e përgjegjësisë. Rrjeti i komunikimit dhe dezinformimi ishte shumë i rëndësishëm pasi avionë F 22/35 dhe Growler u përdorën për të mbrojtur, verbuar dhe mashtruar sistemet iraniane të mbrojtjes. Pjesa kryesore e planit përfshinte veprim të ndarë: një grup i B 2 devijoi drejt Oqeanit Paqësor si “dekurajues”, ndërsa tjetri fluturoi drejt Iranit, duke ruajtur surprizën taktike deri në orët e fundit. U përdorën edhe zbulime të mëparshme nga Izraeli, ku ka patur operacione sabotimi ndaj mbrojtjes ajrore iraniane apo infrastrukturës ushtarake, që zvogëluan ndjeshëm aftësinë e reagimit të Iranit. Në Pentagon udhëheqja ishte e kufizuar vetëm për qarkun e ngushtë, për të ruajtur sekretin.

Growler-ët u përdorën për verbim elektronik, ndërsa F 35/F 22 zbuluan dhe goditën radarët iranianë me raketa HARM. Avantazhi i stealth-it u ndihmua nga terreni natyror dhe fluturimi në mes të natës, gjë që reduktoi mundësinë e kapjes nga radarët e Iranit. U përdorën edhe dronë decoy të llojit MALD, që prodhuan sinjale radar false dhe tërhoqën mbrojtjen përpara grupit kryesor. Cyber Command ishte një komponent kyç sekret në operacionin dhe mundësuan të verbonin radarë, të çorientojnë dhe sabotojnë komunikimet iraniane, vetëm 17 minuta para goditjes për të siguruar hapësirën e lirë. Gjithashtu, zhvilluan opsione mbrojtjeje kibernetike, duke u siguruar përballë kundërveprimit Iranian. Janë përdorur sensorë satelitorë për targeting të saktë para, si dhe për Battle Damage Assessment pas operacionit. Saktësia e goditjes ka qenë kirurgjikale, pasi 14 bomba Massive Ordnance Penetrator (MOP) – 13.6 tonë secila – u hodhën me saktësi në Fordow (12 bomba) dhe Natanz (2 bomba), të programuar për të penetruar 60 m tunel të betonuar nëntokësor. Paralelisht, 30 raketa Tomahawk u lançuan nga USS Georgia, goditën Isfahan dhe node-t mbrojtëse. E gjitha ishte koordinuar me tankera KC-46 dhe KC-135 për mbushje në fluturim gjatë 18 orëshit dhe u krye brenda një segmenti kohor prej 25 minutash, duke ruajtur elementin e paparashikueshmërisë, dhe duke futur luftën në një dimension të ri, ku SHBA-të treguan se janë liderë të padiskutueshëm.



ARSIMIMI NË USHTRI, gur-themeli i MBROJTJES KOMBËTARE

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

Në një kohë kur sfidat e sigurisë po marrin trajta të reja, më të sofistikuara dhe më të paparashikueshme, roli i Forcave të Armatosura nuk është më vetëm ai tradicional i mbrojtjes së kufijve fizikë. Sot, një ushtri moderne është një strukturë dinamike, e pajisur me dije, teknologji dhe aftësi për të vepruar në një spektër të gjerë kërcënimesh nga lufta kibernetike deri te operacionet paqeruajtëse ndërkombëtare. Në këtë realitet të ri, arsimimi i trupës dhe lidershipit ushtarak nuk është më luks, por domosdoshmëri strategjike.

Arsimimi si themel i profesionalizmit ushtarak

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë ndërmarrë një proces të pandërprerë profesionalizimi. Në zemër të këtij procesi qëndron arsimimi si përgatitje teknike, formim strategjik dhe edukim etik. Akademia e Forcave të Armatosura, Qendra për Edukimin Profesional Ushtarak dhe

bashkëpunimet me partnerët ndërkombëtarë, përbëjnë një infrastrukturë akademike që synon të formojë ushtarin e shekullit XXI: të disiplinuar, të shkolluar, të aftë për të vendosur në kushte presioni dhe të ndërveprueshëm me aleatët.

Ky proces nuk duhet parë si një investim thjesht në dije, por si kapital kombëtar për sigurinë. Sepse ushtria nuk ka të bëjë vetëm me armë ajo ka të bëjë me mendje të përgatitura, që dinë të lexojnë situatën, të udhëheqin me maturi dhe të mbrojnë me vizion.

**Produkti i arsimit ushtarak,
një prioritet që sjell rezultate**

Falë reformave të ndërmarra në dekadën e fundit, Forcat e Armatosura shqiptare kanë arritur të ndërtojnë një trupë oficerësh e nënoficerësh me standarde ndërkombëtare. Pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse të NATO-s, misionet në Kosovë, Bosnje, Afganistan e më gjerë, janë dëshmi konkrete e faktit se arsimimi ushtarak nuk është një qëllim në vetvete, por një instrument real i politikës së mbrojtjes.

Produkti: një ushtarak i kualifikuar, i aftë për të përballuar situata të ndërlikuara, për të operuar në terrene ndërkombëtare dhe për të përfaqësuar Shqipërinë me dinjitet është një pasuri kombëtare. Një pasuri që duhet ruajtur, mbështetur dhe zgjeruar.

Një prioritet që kërkon përkushtim të vazhdueshëm

Për të ruajtur e thelluar këto arritje, kërkohet një politikë e qëndrueshme arsimore brenda sistemit të mbrojtjes. Kjo nënkupton:

Modernizimin e kurrikulave në përputhje me standardet e NATO-s; Rritjen e investimeve në laboratorë, teknologji dhe trajnime të avancuara; Nxitjen e bashkëpunimit me universitetet civile për disiplina të reja si siguria kibernetike, intelijenca artificiale dhe drejtimi strategjik.

Në një botë ku luftërat nuk bëhen më vetëm në fushën e betejës, por edhe në laboratorë, platforma digjitale dhe hapësira diplomatike, arsimimi bëhet arma më e fuqishme që një ushtri mund të ketë.

Investimi në dije është investim në siguri

Shqipëria, si anëtare e NATO-s, nuk mund të kënaqet me minimumin. Forcat tona të Armatosura duhet të qëndrojnë në pararojë, jo vetëm në përkushtim dhe sakrificë, por edhe në dije dhe

profesionalizëm. Prandaj, arsimimi ushtarak duhet të trajtohet si një prioritet absolut i mbrojtjes kombëtare, jo vetëm për sot, por për sigurinë e brezave që vijnë.

Zhvillimi i arsimit dhe harmonizimi i Edukimit Ushtarak në ditët e sotme

Arsimi ka qenë gjithmonë një nga shtyllat kryesore të zhvillimit shoqëror dhe kombëtar. Ndërsa shoqëritë evoluojnë, edhe format dhe përmbajtja e edukimit pësojnë ndryshime të thella. Në këtë kontekst, arsimi ushtarak ka ndjekur një trajektore të ngjashme, duke kaluar nga qasjet tradicionale të disiplinës dhe urdhrit, në qasje moderne të bazuara në dije, aftësi shumëdimensionale dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Zhvillimi i arsimit ndër vite

Historikisht, arsimi ishte i privilegjuar për shtresat e larta dhe përqendrohej në ruajtjen e traditave kulturore dhe fetare. Me kalimin e kohës, u institucionalizua dhe u demokratizua, duke u bërë gjithnjë e më i aksesueshëm. Në epokën moderne, arsimi synon jo vetëm përçimin e njohurive, por edhe zhvillimin e aftësive kritike, kreativitetit dhe përshtatshmërisë me një botë që ndryshon me ritme të shpejta. Ky evolucion ndikon drejtpërdrejt edhe



në mënyrën si trajnohen dhe edukohen pjesëtarët e Forcave të Armatosura.

Koncepti i arsimit ushtarak në ditët e sotme

Arsimi ushtarak modern është një proces i vazhdueshëm, i ndërlikuar dhe i strukturuar sipas standardeve të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai nuk kufizohet më vetëm në përgatitjen fizike apo aftësitë taktike. Oficerët dhe ushtarakët sot trajnohen në fusha si lidërshipi strategjik, siguria kibernetike, teknologjitë e reja, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.

Gjithashtu, arsimi ushtarak modern përfshin edhe zhvillimin etik dhe qytetar të pjesëtarëve të ushtrisë, duke i përgatitur ata të jenë jo vetëm luftëtarë, por edhe përfaqësues të denjë të shtetit në misionet paqeruajtëse dhe humanitare.

Qasja dhe harmonizimi i edukimit dhe trajnimit në Forcat e Armatosura

Për të përballuar sfidat moderne të sigurisë, Forcat e Armatosura të vendeve demokratike (përfshirë Shqipërinë dhe Kosovën) kanë ndërmarrë reforma thelbësore në mënyrën e edukimit dhe trajnimit. Këto përfshijnë: Integrimin me arsimin civil: Partneriteti me universitete dhe institucione akademike për të ofruar diploma dhe certifikime për ushtarakët në fusha të tilla si drejtimi, teknologjia informative, marrëdhëniet ndërkombëtare, etj.

Standarde ndërkombëtare: Përdorimi i manualeve dhe programeve të trajnimit sipas standardeve të NATO-s dhe Bashkimit Evropian, për të mundësuar ndërveprueshmërinë në misione shumëkombëshe.

Edukimi i vazhdueshëm: Zhvillimi i kurseve periodike, simulimeve taktike, trajnimeve praktike dhe përdorimi i teknologjive të avancuara për edukimin në distancë. Arsimi, si në aspektin civil ashtu edhe ushtarak, është bërë më gjithëpërfshirës, më i sofistikuar dhe më i ndërlidhur me kërkesat e kohës. Forcat e Armatosura janë duke kaluar nga një model tradicional i trajnimit, në një sistem të plotë të zhvillimit profesional dhe intelektual, në përputhje me kërkesat e mbrojtjes moderne dhe angazhimeve ndërkombëtare. Vetëm përmes një edukimi të qëndrueshëm dhe të harmonizuar, ushtria mund të përmbushë me sukses misionin e saj në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar.

“West Point” është një nga akademitë më

prestigjioze ushtarake në botë, e themeluar në vitin 1802 në SHBA. Ajo ofron një edukim të plotë akademik dhe ushtarak për oficerë të ardhshëm të Ushtrisë Amerikane.

Në Shqipëri Akademitë Ushtarake janë më të reja dhe të ndërtuara mbi përvoja kombëtare dhe ndihmën e NATO-s, me qëllim krijimin e një korpusi oficerësh profesionalë, të përgatitur sipas standardeve euro-atlantike.

Modelet e lidërshipt dhe kultura akademike

“West Point” kultivon një kulturë shumë të strukturuar dhe meritokratike, me theks te nderi, disiplina dhe përgjegjësia ndaj kombit. Akademia shqiptare është gjithnjë e më shumë në transformim drejt këtij modeli.

Ndikimi i përbashkët i NATO-s

dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

Oficerët shqiptarë e kosovarë shpesh ndjekin trajnime shtesë në akademi partnere, përfshirë edhe në SHBA.

Ngjashmëritë: Të dyja sistemet synojnë të prodhojnë oficerë të përgatitur për të udhëhequr në kohë paqeje dhe lufte.

Edukimi i integruar (akademik + ushtarak) është baza e formimit profesional.

Dallimet: Qasja amerikane është më e thelluar dhe më e financuar, me një traditë mbi 200-vjeçare. Shqipëria dhe Kosova janë në proces të përparuar harmonizimi me këtë model.

Produkti i arsimit ushtarak:

një prioritet i mbrojtjes

Oficerë dhe nënoficerë të kualifikuar me njohuri strategjike dhe teknike; Kapacitete më të larta operacionale në misione brenda dhe jashtë vendit; Aftësi për planifikim, menaxhim dhe drejtim të operacioneve ushtarake; Formim moral dhe etik i lartë – vendimtar për ruajtjen e integritetit dhe besueshmërisë së ushtrisë.

Një ushtri moderne ndërtohet

me arsim

Në kohët moderne, fuqia e një ushtrie nuk matet vetëm me numrin e trupave apo arsenalit, por me nivelin e njohurive, përgatitjes dhe profesionalizmit të personelit të saj. Shqipëria, si një shtet që synon të mbajë një rol aktiv në sigurinë rajonale dhe globale, duhet ta ketë arsimimin ushtarak si një prioritet absolut të mbrojtjes kombëtare.



Beteja e parë e Skënderbeut DIBRA E POSHTME, 1444

Pas shpalljes së revoltës, më 28 nëntor 1443, dhe marrjes së Krujës, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu do të përballlej për herë të parë me fuqinë më të madhe të kohës - Perandorinë Osmane. Ishte dimri i vitit 1444, kur në fushat e Dibrës së Poshtme, ushtria shqiptare e përbërë nga rreth 8 mijë kalorës dhe 7 mijë këmbësorë, u përplas me trupat e Ali Pashës.

Strategjia e Skënderbeut

Sipas Marin Barletit, Skënderbeu tregoi mjeshtëri të lartë ushtarake, duke përgatitur një pritë të organizuar në mënyrë perfekte. Ai vendosi forcat në tri krahë: Tanushin në të majtë, Moisiun e Dibrës në të djathtë, ndërsa vetë qëndroi në qendër me trupat më të forta. Pjesë e planit ishte edhe përdorimi i rezervës së udhëhequr nga Vrana Konti, e cila vendosi fatin e betejës.

Në agim, pas një nate të tensionuar ku turqit talleshin me heshtjen e shqiptarëve, Skënderbeu dha urdhrin për sulm. Lufta nisi me kalorësinë dhe shigjetarët, ndërsa nga prapa shpërthyen forcat në pritë, duke rrethuar trupat osmane.

Fitorja e madhe

Beteja u zhvillua me ashpërsi deri në mesditë. Shqiptarët treguan disiplinë, trimëri dhe besnikëri të hekurt ndaj komandantit të tyre. Pjesa më e madhe e

ushtirisë osmane u thye, duke lënë pas mbi 22 mijë të vrarë dhe 2 mijë robër.

U zunë gjithashtu 24 flamuj ushtarakë. Humbjet shqiptare ishin të pakta - vetëm rreth 120 të rënë.

Ali Pasha mezi arriti të shpëtonte, ndërsa kampi turk u zu nga ushtria shqiptare.

Jehona e fitores

Kjo ishte beteja e parë e madhe që hapi epopenë 25-vjeçare të Skënderbeut. Fitorja tregoi se shqiptarët, të bashkuar nën një udhëheqje të vetme, ishin të aftë të përballonin dhe të mposhtnin fuqinë më të madhe të kohës.

Barleti e përshkruan kështu: “Atë ditë, luanët komanduan luanë.”

Pas triumfit, ushtria shqiptare u kthye në Krujë, ku populli i pritë me madhështi dhe krenari. Flamujt e fituar iu dërguan princërve të tjerë shqiptarë dhe u vendosën nëpër kisha si shenjë e lavdisë.

Rëndësia historike

Beteja e Dibrës së Poshtme nuk ishte thjesht një përballje ushtarake, por një dëshmi se bashkimi kombëtar dhe strategjia e zgjuar mund të sillnin fitore edhe kundër një superfuqie si Perandoria Osmane. Ky sukses i dha Skënderbeut jo vetëm besimin e popullit të vet, por edhe respektin e gjithë Evropës.

DATA DHE NGJARJE

A black and white portrait of Mother Teresa, looking directly at the camera with a serene expression. She is wearing her characteristic white headscarf with dark stripes and a dark sash over a white garment. Her hands are clasped in front of her.

Nga Lindja e
Shën Terezës
te ikja e
Migjenit

Dy shpirtra të mëdhenj
në një datë



Data 26 gusht ka një ngarkesë të veçantë për ne shqiptarët. Pikërisht më 26 gusht 1910, lindi në Shkup Gonxhe Bojaxhiu, që bota do ta njihnte si Nënë Tereza, shenjtorja e dashurisë dhe e bamirësisë. Po në të njëjtën datë, më 26 gusht 1938, në moshë vetëm 27-vjeçare, u shua jeta e Migjenit, poetit të revoltës sociale dhe zërit të fuqishëm për të varfrit e harruar.

Njëra nga lindja, tjetri nga vdekja, dy figura që historia i lidhi pazgjidhshmërisht me këtë datë, sikur të donte të na kujtonte se aty ku ka dhimbje, lind edhe shpresa, aty ku mungon ngushëllimi, lind një dritë e re.

Nënë Tereza, Shenjtorja shqiptare e botës

Me jetën dhe misionin e saj, Nënë Tereza e Kalkutës i dha botës një shembull të jashtëzakonshëm përkushtimi. Ajo nuk shkroi libra, por historia e saj u shkrua në zemrat e miliona njerëzve.

Në çdo cep të globit, nëpër varfëri, mjerim e braktisje, ajo shfaqej si nënë për të harruarit. “Një jetë e pa jetuar për të tjerët, nuk është jetë”, thoshte ajo.

Fjalët e saj të urta janë një testament shpirtëror për njerëzimin:

“Fëmijët janë si zogjtë: ju doni t’i mësoni të fluturojnë, por ata nuk do të fluturojnë me flatrat tuaja”.

“Çfarë mund të bësh për të siguruar paqen botërore? Shko në shtëpi e duaje familjen tënde”.

“Unë mund të bëj gjëra që ju nuk mundeni; ju mund të bëni gjëra që unë nuk mundem. Së bashku

mund të bëjmë gjëra të mëdha”.

Ajo erdhi në këtë botë si një bekim për njerëzimin dhe mbeti përjetësisht shenjtorja shqiptare që i mësoi botës fuqinë e dashurisë dhe të përlushtisë.

Migjeni, poeti i revoltës dhe i dhimbjes sociale

Në anën tjetër, më 1938, në të njëjtën datë të 26 gushtit, ndaloi frymëmarrja e një gjeniu të brishtë, por që i la letërsisë shqiptare një trashëgimi të pavdekshme.

Migjeni, me vargun e tij therës, u bë klithma e të mjerëve, dëshmia poetike e një Shqipërie të përgjakur nga varfëria, uria dhe padrejtësitë.

Në çdo strofë të tij ndihet revolta dhe njëkohësisht shpresa për lindjen e një njeriu të ri, që do të sillte një kohë të re. Në poezinë e famshme “Të lindet njeriu”, ai i jepte zë ëndrrës për një shoqëri të drejtë e humane, larg tiranive e mashtrimeve të kohës.

Migjeni mbeti poet i madh i modernitetit shqiptar, një vizionar që nuk pranoi të bëhej zë i asnjë ideologjie, por i njeriut të thjeshtë. Edhe pse vdekja e ndali herët, vargjet e tij mbeten të përjetshme.

Një datë, dy amanete

26 gushti bashkon lindjen e shenjtores dhe ndarjen nga jeta të poetit, duke na kujtuar se kombit tonë i janë dhënë dy figura të mëdha të shpirtit dhe mendimit: Nënë Tereza, që i dha botës dashurinë dhe shpresën; Migjeni, që i dha botës klithmën poetike të një shoqërie të plagosur. Të dy, secili në mënyrën e vet, na bëjnë krenarë si shqiptarë. Sepse nga kjo tokë e vogël dolën dy gjigandë që prekin ende zemrat e njerëzimit.

NATO në Veprim:

Muaj Vendimtarë për Sigurinë Kolektive

Muajt e fundit kanë qenë ndër më aktivët për Aleancën e Atlantikut të Veriut, me zhvillime që kanë përforcuar strukturat e mbrojtjes kolektive, kanë avancuar bashkëpunimin teknologjik dhe kanë rikonfirmuar angazhimin politik të vendeve anëtare. Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s, ka qenë pjesë e këtyre zhvillimeve, duke kontribuar në stërvitje, misione dhe forume strategjike.



Samiti i NATO-s në Hagë – Qershor 2025

Më 24-25 qershor 2025, në qytetin e Hagës, u mbajt Samiti vjetor i NATO-s, një ngjarje historike që për herë të parë u organizua nga Holanda. Ky samit shënoi debutimin e Sekretarit të ri të Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, dhe u karakterizua nga vendime të rëndësishme për të ardhmen e Aleancës.

Ndër vendimet kryesore ishte angazhimi i vendeve anëtare për të rritur investimet në mbrojtje në nivelin 5% të PBB-së deri në vitin 2035. Kjo përfshin: 3.5% për nevojat bazë të mbrojtjes dhe përmbushjen e objektivave të kapaciteteve të NATO-s, si dhe 1.5% për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, sigurinë kibernetike, inovacionin dhe përgatitjen civile. Samiti trajtoi gjithashtu kërcënimet hibride, përfshirë sulmet kibernetike dhe sabotimet infrastrukturore, si dhe rikonfirmoi mbështetjen për Ukrainën dhe nevojën për forcimin e kapaciteteve ajrore mbrojtëse.



Dynamic Guard II – Stërvitje në Detin Mesdhe

Në shtator, NATO zhvilloi stërvitjen “Dynamic Guard II”, e fokusuar në luftën elektronike dhe mbrojtjen kundër raketave detare. Njësitë detare të Aleancës testuan reagimin ndaj kërcënimeve të sofistikuara, duke përmirësuar ndërveprimin dhe koordinimin në mjedise të ndërlikuara operationale.



Dynamic Messenger 25 – Teknologji të Pavarura në Atlantik

Stërvitja “Dynamic Messenger 25”, e zhvilluar në Oqeanin Atlantik, përfshiu përdorimin e mjeteve autonome detare dhe ajrore për operatione të përbashkëta. Dronët detarë, sistemet nënujore dhe platformat ajrore të pavarura u testuan për zbulim, patrullim dhe mbrojtje, duke treguar se NATO po investon seriozisht në modernizimin teknologjik.



Cyber Coalition 25 – Mbrojtja Kibernetike në Estoni

Estonia priti stërvitjen “Cyber Coalition 25”, një nga më të mëdhatë në botë për sigurinë kibernetike. Vendet anëtare simuluan sulme kibernetike dhe koordinuan reagime të përbashkëta për të mbrojtur rrjetet kritike dhe sistemet ushtarake. Kjo stërvitje dëshmoi se

hapësira digjitale është tashmë një fushë operationale me rëndësi strategjike.



Misionet Aktive: KFOR dhe Iraku

Misioni KFOR në Kosovë vazhdon të jetë një shtyllë e stabilitetit rajonal. Forcat e NATO-s patrullojnë, ndërveprojnë me komunitetet dhe mbështesin institucionet vendore për të garantuar sigurinë dhe lirinë e lëvizjes.

Në Irak, NATO vazhdon misionin këshillues për forcimin e kapaciteteve vendase të sigurisë, duke ndihmuar në parandalimin e rikthimit të ekstremizmit dhe në ndërtimin e institucioneve demokratike.



Sea Guardian – Siguria Detare në Mesdhe

Operacioni “Sea Guardian” ka vazhduar me patrullime të rregullta në Mesdhe, duke luftuar trafikimin e paligjshëm dhe duke mbështetur përpjekjet ndërkombëtare për stabilitet. Ky operacion është një shembull i bashkëpunimit ndërkombëtar në ruajtjen e sigurisë detare.

Në një periudhë të ngarkuar me sfida dhe transformime globale, NATO ka dëshmuar se mbetet një aleancë e fortë, dinamike dhe e përkushtuar ndaj sigurisë kolektive. Aktivitetet e zhvilluara gjatë muajve të fundit kanë rritur gatishmërinë operationale, kanë thelluar bashkëpunimin teknologjik dhe kanë forcuar unitetin politik mes vendeve anëtare. Shqipëria, si pjesë e kësaj aleance, vazhdon të japë kontributin e saj me profesionalizëm dhe përkushtim, duke e pozicionuar veten si një partner i besueshëm në mbrojtjen e paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar.



GJURMË NË KOHË

Oficere për pak kohë, luftëtare përjetë

Nga fronti në klasë, nga arma në zyrë: rrëfimi i grave që deshën të qëndronin ushtarë

Në përfundim të Luftës Nacionalçlirimtare, vendi ynë u përball me transformime të thella politike, shoqërore dhe ushtarake. Në këtë realitet të ri, një grup vajzash dhe grash që kishin kontribuar ndjeshëm në luftë, në radhët e Brigadave partizane dhe strukturave drejtuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, u përpoqën të vazhdonin rrugën e tyre në uniformë, tashmë në një ushtri të rregullt e paqësore. Megjithatë, rruga e tyre nuk do të ishte e lehtë.

Referuar dokumenteve të Arkivit Qendror të Ushtrisë dhe dëshmimeve të kohës, duket qartë se pavarësisht përvojës së fituar gjatë luftës, vullnetit për të kontribuar më tej në mbrojtjen e vendit, si dhe aftësive të provuara në front, shumë prej këtyre grave nuk gjetën hapësirën e merituar në ushtrinë e pasluftës. Në nëntor të vitit 1944, përmes fonogramit Nr. 63, datë 13.11.1944, Koçi Xoxe, në cilësinë e Sekretarit Organizativ të Partisë Komuniste të Shqipërisë, urdhëronte që gratë të largoheshin gradualisht nga radhët e ushtrisë, me justifikimin se do të kontribuonin më shumë në

sektorë të tjerë të jetës civile dhe se ushtria kërkonte sakrificë të mëdha.

Në këtë kontekst, roli i grave oficere u zvogëlua ndjeshëm dhe numri i tyre mbeti simbolik. Megjithatë, përpjekjet për t'i përfshirë gratë në trajnimet ushtarake nuk munguan.

Kursi i parë për oficere nisi më 28 mars 1945, në ditën e parë të themelimit të Shkollës Ushtarake "Skënderbej", ku morën pjesë 9 vajza nga radhët e brigadave partizane, ndër të cilat Valentina Murzaku, Xhevrije Golemi dhe Katerina Prifti. Vetëm 6 prej tyre përfunduan shkollimin dhe u titulluan oficere aktive. Por ndonëse të diplomuara, shumica nuk vijuan karrierën ushtarake, një pjesë u sistemuan në institucione civile, si gazetari, administratë apo edukim.

Valentina Murzaku, një nga oficeret e para, rrëfen në kujtimet e saj se urdhri për largimin e femrave nga ushtria iu komunikua personalisht nga përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ajo, bashkë me koleget, u zhvendos nga struktura ushtarake drejt sektorëve civilë: arkiva, gazeta, bankë,

institucionet shkencore, duke lënë pas një ëndërr të ndërprerë për një karrierë të plotë ushtarake.

Një tjetër valë përgatitjeje për oficerë ndodhi në vitet 1949-1951, me një kurs të dytë të zhvilluar në Tiranë, nga Ministria e Mbrojtjes. Rreth 10 vajza të tjera, pjesëmarrëse në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, u trajnuan dhe për disa kohë punuan në Ministrinë e Mbrojtjes, Shkollën "Skënderbej" dhe Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, kryesisht në funksione arsimore e kulturore.

Ndër këto vajza, përmendim emra si: Vitori Mehmet Kondi-Fico, pjesëtare e LANÇ-it dhe shefe e sektorit të kulturës në Shkollën Ushtarake "Skënderbej" deri në vitin 1953, Naze Levendi-Dervishi, e cila punoi në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe më pas në sektorin e shëndetësisë, Sofije Kristo dhe Dhora Zenko, që vijuan karrierën për disa vite në strukturat ushtarake, përpara se të zhvendoseshin në sektorët civilë.

Këto gra formuan gjithashtu bazën e ekipit të qitjes të klubit "Partizani", përfaqësues i ushtrisë në arenën sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.

Megjithëse numri i grave oficerë ishte i kufizuar, ndikimi i tyre ishte i prekshëm. Ato përfaqësonin guximin dhe përkushtimin e vajzave që kishin kaluar nga ilegaliteti, lufta dhe skamja në uniformën e nderuar të oficerës shqiptare.

Një hap më tej u bë vetëm në vitin 1967, kur mbi 70 vajza nga të gjitha trevat e Shqipërisë nisën studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, duke shënuar një ndryshim të vonuar, por të rëndësishëm në integrimin e grave në radhët e ushtrisë së rregullt.

Rrugëtimi i grave oficerë të pasluftës është një kapitull i rëndësishëm i historisë sonë ushtarake dhe kombëtare. Ato sfiduan paragjykimet e kohës, kapërcyen barrierat institucionale dhe ndonëse jo gjithmonë në rolin që meritonin, lanë gjurmë të pashlyeshme në themelet e shtetit të ri shqiptar.

Gratë Oficerë në Zanafillën e Modernizimit

të Ushtrisë Shqiptare

Liza Cara-Legisi, një jetë në shërbim të ushtrisë dhe emancipimit të gruas shqiptare

Liza Gjok Cara-Legisi, e lindur në fshatin Perlat të Mirditës, më 1942, përfaqëson një histori të jashtëzakonshme të guximit femëror në një kohë kur

normat patriarkale dominonin rëndë në shoqërinë veriore shqiptare. E fejuar në moshë të vogël sipas zakoneve të Kanunit, ajo prishi fejesën dhe u largua nga familja për të ndjekur ëndrrën e saj për arsimim dhe shërbim ushtarak.

Në vitin 1967, ajo regjistrohet ndër të parat vajza në Shkollën e Oficerëve dhe në vitin 1969 diplomohet si oficerë e këmbësorisë, duke marrë titullin "Oficerë aktive" me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes. Gjatë 23 viteve të shërbimit, Liza Legisi ka mbajtur pozicione të rëndësishme, përfshirë: Komandante kompanie këmbësorie; Instruktoreshë në Degën e Mobilizimit të Mirditës; Nëndrejtoreshë e shkollës për përgatitjen ushtarake dhe fizike; Instruktoreshë në Shkollën e Lirë Ushtarake (SHLU).

Ajo përfundon karrierën me gradën "Kapiten i Parë", ndërkohë që ndikimi i saj në shoqëri ka qenë shumë më i gjerë, duke frymëzuar brezat e rinj.

Nevreska Devolli, oficerë e palëkundur e këmbësorisë dhe shembull i përkushtimit të heshtur

Nevreska Devolli, e lindur më 9 maj 1942, në Starjë të Kolonjës, është një tjetër figurë e rëndësishme që mbetet në kujtesën e ushtrisë si pjesë e brezit të parë të oficerëve femra. E diplomuar në vitin 1969 për këmbësori, Nevreska Devolli-Abazi ka mbajtur për 23 vite rresht detyra me përgjegjësi të lartë në Tiranë, Laç dhe Vlorë, si: Komandante e kompanisë së këmbësorisë; Instruktoreshë për përgatitjen fizike në Divizion; Referente në Drejtorinë Politike të Ushtrisë; Komandante batalioni në RSHA; Nëndrejtoreshë për përgatitjen fiziko-ushtarake. Në vitin 1992, me reformimin e strukturave të ushtrisë, del në rezervë me gradën "Kapiten i Parë". Ndërroi jetë në vitin 2012, duke lënë pas një histori të pasur përkushtimi dhe profesionalizmi.

Trashëgimia

Të dyja këto gra, me rrugëtime që tejkaluan kufijtë gjinorë dhe sfiduan normat e kohës, kontribuan jo vetëm në forcimin profesional të Forcave të Armatosura, por edhe në emancipimin shoqëror të gruas shqiptare. Historia e tyre përfaqëson një kapitull të rëndësishëm të ndërthurjes mes uniformës, sakrificës dhe përkushtimit të heshtur. Ato mbeten modele frymëzimi për brezat e rinj, për vajzat që sot shërbejnë me dinjitet në ushtrinë shqiptare.





MBI GJURMË, ndërtojmë të ardhmen

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

Në çdo gur të rrugëve tona të vjetra, në çdo këngë që këndohet nëpër oda, gjurmohet një histori. Jemi një popull që ecën mbi kujtime, që nuk harron, por i mban gjallë me krenari.

Gjurmë në gurët e Kalasë së Krujës, ku zëri i Skënderbeut akoma kumbon në jehonën e maleve, i kujton botës se një popull i vogël mund të mbajë kokën lart përballë fuqive të mëdha. Ato mure të

lashta nuk janë thjesht guri, janë dëshmi, janë zëra që flasin edhe sot.

Gjurmë në lahutën e malësorit, që këndon për trimat, për dashuritë e humbura, për token që s'njolloset dhe për nderin që nuk shitet. Çdo tel lahute dridhet si një damar që mban gjakun e së kaluarës.

Gjurmë në rrugët e Gjirokastrës, ku kalldrëmi përshkohet nga hija e Ismail Qemalit, Fan Nolit e Migjenit. Nëpër dritaret e shtëpive gurgullojnë tregime të gjyshërve që luftuan për gjuhën, për shkronjat tona të arta, për një komb që nuk pranoi të humbte zërin.



Gjurmë në duart e një nëne shqiptare, që punon arat me djersë, por rrit me dinjitet një brez të ri, duke u përcjellë fjalët e urta dhe dashurinë për atdheun.

Gjurmë në diasporë, ku shqiptarët, edhe larg tokës së tyre, e mbajnë gjallë gjuhën dhe traditat.

Në mërgim, një valë flamuri, më 28 Nëntor ka më shumë kuptim se çdo fjalë është gjurmë e një shpirti që nuk shteron kurrë.

Gjurmët në kohë nuk janë vetëm kujtime. Janë trashëgimi. Janë lidhja jonë me të shkuarën dhe udhërrëfyes për të ardhmen. Në çdo brez që lind, në çdo fëmijë që mëson të thotë “jam shqiptar”, historia

merr frymë përsëri.

Gjurmët e Lavdisë: Kur armët flasin, historia shkruhet

Në çdo betejë të përgjakshme, në çdo uniformë të fyer nga pluhuri i stërvitjeve apo i luftërave, shënohet një gjurmë, jo vetëm në tokë, por në zemrën e kombit.

Ushtria shqiptare ka qenë gjithmonë një mburojë dhe një flamur krenarie për popullin.

Nga lufta për pavarësi, tek betejat për çlirim e deri tek roli i saj modern në paqe-ruajtje, ushtari shqiptar ka qenë gjithnjë dëshmi e një shpirti që nuk përkulet.

Nga trimëria e Skënderbeut tek ushtarët sot

Gjurmë historike:

- Skënderbeu, strateg dhe udhëheqës ushtarak, mbrojti tokat shqiptare për 25 vjet përballë Perandorisë Osmane.

- Lufta Nacionalçlirimtare, me formimin e Brigadave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, ku djem e vajza lanë gjithçka për të luftuar për Shqipërinë e lirë.

- Lufta e Kosovës 1998-1999, me përfshirjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i dha kuptim të ri sakrificës shqiptare.

Gjurmët janë në toponimi:

- Qafa e Agronit, Kodra e Martirëve, Lapidari i Brigadës së Parë, etj... nuk janë thjesht emra, por kujtesa të gdhendura në truall.

Vlerat ushtarake dhe disiplina

si gjurmë në karakter

- Besnikëri ndaj flamurit: Një ushtar është i pari që qëndron kur të tjerët hezitojnë.

- Sakrificë: Kur lë familjen për të mbrojtur të gjithë kombin.

- Formimi moral: Ushtria si shkollë karakteri, ku njeriu kalitet nëpërmjet disiplinës.

- Trashëgimia brez pas brezi: Kur i biri ndjek rrugën e të atit, dhe uniforma bëhet trashëgimi e gjakut.

‘Një ushtar nuk vdes kurrë, ai jeton në kujtimin e popullit të tij’.

Stërvitjet sot, siguria nesër

Gjurmë moderne në Forcat e Armatosura:

- Pjesëmarrja në misione ndërkombëtare: NATO, KFOR.....

- Modernizimi i pajisjeve dhe teknologjisë.

- Roli i grave ushtarake: një faqe e re e guximit shqiptar.

- Akademia e Forcave të Armatosura, vendi ku përgatitet brezi i ri i oficerëve.

“Teknologjia ndryshon. Zemra e ushtarit shqiptar mbetet e njëjtë, besnike dhe e pathyeshme.”

Mbi gjurmë, ndërtojmë të ardhmen

Nëse shohim prapa, shohim heroizëm. Nëse shohim përpara, shohim detyrë.

Gjurmët e ushtarit shqiptar janë të skalitura në çdo brez që e do atdheun më shumë se veten.

Kombi jeton kur ushtari i tij ruan paqen, nderin dhe tokën.

Ky është mesazhi i gazetës “Ushtria”, një përlujtje para të kaluarës, dhe një betim për të ardhmen.



METEOROLOGJIA USHTARAKE, Shtyllë Strategjike në Shërbim të Atdheut

Zhvillimi i ekonomisë, i jetës, dhe i njohurive të shoqërisë në tërësi ka influencuar gjithmonë në përparimin e shkencës së parashikimit të motit, sepse, siç dihet, janë të pakta ato veprimtari të njeriut që nuk lidhen me reshjet, temperaturat, erërat etj. Por, një zhvillim të madh shkencë e meteorologjisë e pati me fillimin e fluturimeve ajrore.

Ekziston një lidhje tepër e ngushtë ndërmjet fluturimeve ajrore dhe shkencës së meteorologjisë, pasi kjo e fundit garanton kondita normale të fluturimeve kombëtare e ndërkombëtare. Edhe në

vendin tonë zhvillimi i shkencës së meteorologjisë ka historikun e saj. Vlerat e para të elementeve meteorologjike janë matur, në vitin 1887, në qytetin e Shkodrës. Më pas kanë filluar të maten dhe në qytetet Durrës, Tiranë, Korçë e Vlorë. Por, këto vendmatje në të cilat punonin persona të huaj, priftërinj jezuit, nuk ishin dot në gjendje të formonin rrjetin e Shërbimit Meteorologjik.

Deri para çlirimit të vendit kishte vetëm një zyrë hidrografie pranë Ministrisë së Punëve Botore dhe një zyrë meteorologjike pranë Ministrisë së

Bujqësisë. Një rrjet meteorologjik kombëtar, që do të përfshinte tërësinë e shërbimeve meteorologjike në të gjithë vendin, u arrit të krijohej në vitin 1949 nga Instituti i Shkencës. Për këtë qëllim, ishin montuar me kohë nëntë vendmatje të pajisura me aparatura normale të kohës dhe që ndodheshin në qytetet Shkodër, Kukës, Peshkopi, Durrës, Tiranë, Kuçovë, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë. Siç shihet vendmatjet ishin të shpërndara në të gjithë vendin, në vise e largësi të ndryshme, në kushte të ndryshme klimatike dhe në to punohej 24 orë në ditë.

Elementet meteorologjike të vrojtuar në çdo stacion gjatë ditës ishin: diellzimi, shikimi horizontal, vranësirat, drejtimi dhe shpejtësia e erës, presioni atmosferik, temperatura e ajrit dhe e tokës, lagështira, avullimi si dhe reshjet. Vrojtimi i vlerave të tyre bëhej i pjesshëm në çdo orë dhe i plotë në çdo tre orë. Gjithashtu, çdo ditë vetëm në Stacionin Qendror Tiranë punoheshin me dorë dhe analizoheshin katër harta sinoptike tokësore, të cilat shërbenin për të mbuluar me parashikim moti të gjithë territorin e vendit. Transmetimi dhe marrja e të dhënave meteorologjike si brenda ashtu edhe jashtë vendit bëhej çdo tre orë në Stacionin Qendror me sistemin mors nëpërmjet valëve radio. Bashkëpunimi me botën e jashtme realizohej nëpërmjet Qendrës Meteorologjike në Sofje të

Bullgarisë dhe shërbente për të siguruar një fluturim normal mbi hapësirën ajrore të Shqipërisë dhe për të kontribuar në rrjetin e vrojtimeve ndërkombëtare. Për herë të parë, pra në 1949, në këto vendmatje drejtimi dhe personeli ishin plotësisht shqiptar. Kështu në drejtim të Shërbimit ishte sinoptikani Pal Nikolli, për sektorin civil punonin sinoptikanët Petrit Leka, Nuri Bajko, Nazmi Daja dhe Seit Berisha, ndërsa sektori ushtarak përfaqësohej nga sinoptikani Hamit Kotoni. Këta sinoptikanë, që kishin studiuar në Jugosllavi, me profesionalizëm e përkushtim, kanë lënë gjurmët e tyre në historinë e Shërbimit Meteorologjik Kombëtar. Po në vitin 1949, u krijua Drejtoria e Shërbimit Meteorologjik në vartësi të Institutit të Shkencës. Ndërkohë personeli i rrjetit të shërbimit ka ardhur në rritje. Duhet përmendur puna e palodhur e vrojtueseve Nimete Zaka, Milla Përbilla, Albert Mërgjoni, Hamdi Shijaku, Zyber Dana etj., si dhe e teknikeve Marie Kristiqi, Myzejen Sokoli, Vitore Dushi, Fatime Mema etj.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 411, të datës 2.11.1955, “Mbi riorganizimin e Shërbimit Meteorologjik të Shqipërisë”, u vendos që Shërbimi Qendror i Meteorologjisë në Tiranë e në qarqe të hiqet nga administrimi i Institutit të Shkencave dhe të kalojë në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shef i tij emërohet sinoptikani ushtarak Hamit Kotoni.





Me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, Nr.1149, datë 26 dhjetor 1955, shërbimi meteorologjik kaloi në vartësi të Komandës së Aviacionit (MKA). Filloi kështu dhe historia e bashkëpunimit të ngushtë të Komandës së Aviacionit me Shërbimin Meteorologjik Kombëtar. Ky bashkëpunim ndikoi në modernizimin dhe shtimin e rrjetit ekzistues. Në këtë periudhë me punën e tyre kanë lënë gjurmë edhe sinoptikanët Engjëll Korça, Servet Minarolli, Minush Karalliu, etj., si dhe tekniket Rakibete Çuri, Vangjeli Korça, Myzejen Shehri, etj. Më 7 shtator 1956, me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.377, pranë Shërbimit Meteorologjik është ngritur dhe Sektori i Aerologjisë. Krijimi i këtij sektori do të shërbente kryesisht për përcaktimin e lartësisë së reve, si dhe për përcaktimin e drejtimin e të shpejtësisë së erës vetëm për qëllime ushtarake. Sipas këtij vendimi Stacioni Qendror (Sektori i Aerologjisë) kishte për detyrë që të paktën dy herë në ditë të bënte sondimin e atmosferës, duke ngritur aero-sonda ose pilot-balona. Të dhënat që merreshin, shërbenin për të përgatitur buletin meteorologjik të AKA. Në vitin 1957 të nëntë stacionet e rrjetit të Shërbimit Meteorologjik të Aviacionit regjistroheshin në Organizatën Botërore të Meteorologjisë (WMO) me gjerësi e gjatësi gjeografike si dhe me lartësi mbi nivelin e detit. Kjo

organizatë varej nga OKB dhe shteti ynë në bazë të konventave të vendosura prej saj, kishte detyrim kryerjen në rregull të vërtetimeve meteorologjike si dhe përpilimin e telegrameve meteorologjike në stacionet meteorologjike të rrjetit, grumbullimin në Stacionin Qendror të këtyre telegrameve si dhe dërgimin e tyre nëpërmjet Bullgarisë në Qendrën Evropiane të Meteorologjisë. Këto telegrame, që duhej të dërgoheshin çdo tre orë do të shërbenin për përpunimin e hartave sinoptike të parashikimit 24-orësh të konditave të motit. Gjithashtu, Shërbimi Meteorologjik i Aviacionit nëpërmjet valëve radio merrte informacion meteorologjik nga Qendra Evropiane e Meteorologjisë. Nën drejtimin e Komandës së Forcave Ajrore, rrjeti i Shërbimit Meteorologjik është rritur vazhdimisht. Kështu, me krijimin e aeroporteve në vitin 1960 është krijuar Stacioni Sinoptik i Rinasit, me detyrë sigurimin meteorologjik të fluturimit të aviacionit ushtarak dhe atij civil në linjat ndërkombëtare. Ndërsa në vitin 1967, u krijua Stacioni Sinoptik i Farkës, me detyrë sigurimin meteorologjik të fluturimit të helikopterëve ushtarakë të Regjimentit të Helikopterëve Farkë, për t'u ndjekur më pas në vitin 1974, me krijimin e Stacionit Sinoptik të Gjadrit, me detyrë sigurimin e fluturimeve ajrore të Regjimentit të Aviacionit, Gjadër. Kështu, rrjeti i Shërbimit Meteorologjik Shqiptar nën drejtimin e Komandës së Aviacionit u kompletua dhe funksionoi në mënyrë aktive në përputhje me kërkesat e kohës. Për periudhën 1975 deri në 1990, në krye të Shërbimit Meteorologjik të Aviacionit emërohet ushtaraku Partizan Petroshati, i cili kishte studiuar për inxhinieri meteorologjike në Kinë. Prej vitit 1990 deri 1992, në krye të Shërbimit Meteorologjik emërohet ushtaraku Minush Karalliu.

Cila ishte përbërja e rrjetit të Shërbimit Meteorologjik Shqiptar dhe si u përgjigjej ai kërkesave të kohës?

Rrjeti i këtij shërbimi përbëhej nga dymbëdhjetë stacione, të cilat ndaheshin në stacione pa sinoptikanë, ku bëheshin vetëm vërtetime dhe në stacione me sinoptikanë, ku bëheshin vërtetime dhe parashikime të motit.

Stacionet meteorologjike ku bëheshin vetëm vërtetime, që ishin stacionet Shkodër, Kukës, Peshkopi, Durrës dhe Korçë e kishin në përbërje të tyre: kopshtin meteorologjik me dimensione 26 me 26 metra, në të cilin ndodhej kafazi meteorologjik, termometrat që matnin temperaturën e tokës, anemometri që tregon shpejtësinë dhe drejtimin e erës, si dhe pluviometri që mat sasinë e shiut. Në kafazin meteorologjik ndodheshin: psikrometri i



përbërë nga termometri i ajrit të thatë dhe termometri i ajrit të lagët, termometrat minimalë dhe maksimalë, higrometri që mat lagështirën specifike, si dhe termografi e higrografi, që tregojnë ecurinë ditore dhe javore të temperaturës dhe të lagështirës.

Zyra e vërtetimeve meteorologjike në të cilën ndodheshin barometri me zhivë dhe ai aneroid, që shërbejnë për të matur presionin atmosferik, barografi që tregon ecurinë ditore dhe javore të presionit atmosferik, tabelat psikrometrike, që shërbenin për llogaritjen e temperaturës së pikës së vesës dhe ditarët në të cilat shërbenin për regjistrimin e matjeve të elementeve meteorologjike e për përpilimin e telegrameve meteorologjike. Ndërsa

stacionet meteorologjike ku bëheshin vërtetime dhe parashikime ishin: Stacioni Qendror i Tiranës, i Rinasit, i Farkës, i Gjadrit, i Kuçovës dhe i Vlorës. Këto stacione kishin në përbërjen e tyre përveç kopshtit meteorologjik dhe zyrës së vërtimit edhe zyrat e teknikës e të parashikimit të motit. Në zyrën e teknikës çdo tre orë merreshin me radiomarrëse, nëpërmjet Bullgarisë, të dhëna meteorologjike nga Qendra Europiane e Meteorologjisë. Këto të dhëna hidheshin me dorë nga teknikët në hartat sinoptike të parashikimit të motit, të cilat ishin tokësore dhe të lartësisë 850mb, 700mb, 500mb, 300mb dhe 200mb. Më pas këto harta kalonin në zyrën e parashikimit, ku pasi analizoheshin me dorë nga sinoptikanët d.m.th.



pasi studiohej atmosfera në mënyrë tredimensionale arrihej në konkluzionin: Si është dhe si do të jenë konditat e motit për 24-orëshin e ardhshëm në vendin tonë dhe në kontinentin evropian. Në Stacionin Qendror të Tiranës bëhej grumbullimi i të gjitha të dhënave meteorologjike që vinin nga rrethet, si dhe përgatitej buletini meteorologjik, që i jepej fillimisht VKQ, MM, e më pas të gjitha dikastereve shtetërore, si dhe Radiotelevizionit Shqiptar.

Vlen të përmendet përfaqësimi me aq profesionalizëm e dinjitet që sinoptikani Petrit Leka i ka bërë me vite Shërbimit Meteorologjik në Televizionin Shqiptar deri në vitin 1990. Në Stacionin Qendror të Tiranës ndodhej dhe arkiva, në të cilën janë arkivuar që nga krijimi i Shërbimit Meteorologjik të gjitha buletinet meteorologjike, hartat sinoptike si dhe punime të ndryshme shkencore. Shërbimi Meteorologjik i Aviacionit ka patur lidhje të ngushta me Institutin Hidrometeorologjik. Falë këtij bashkëpunimi u realizuan shumë punime shkencore e serioze në fushën e meteorologjisë. Shërbimi Meteorologjik i Aviacionit ishte ai që përgatiste rregullisht tabelat me vlerat e llogaritura të elementeve meteorologjike, të cilat, së bashku me studime të tjera të këtij lloji, dërgoheshin në Institutin Hidrometeorologjik, ku përpunoheshin e më pas ribotoheshin, duke marrë kështu formën e studimeve shkencore. Si produkt i kësaj pune kolektive shkencore që nga viti 1956, të dhënat e Qendrës Meteorologjike të Aviacionit kanë ndihmuar në botimin e Buletinit Vjetor të Meteorologjisë. Në këtë botim nga ana e Shërbimit Meteorologjik përfshiheshin të dhënat vjetore sipas muajve, të vlerave të elementëve meteorologjike të matura në vendmatjet meteorologjike, analiza e situatave të vështira sinoptike, etj. Gjithashtu, në vitin 1978 do të botohej libri “Klima e Shqipërisë” dhe “Atlasi Klimatik i Shqipërisë”, një botim i pajisur me 120 harta, diagrame e tabela, në të cilat pasqyrohej shpërndarja e parametrave kryesorë të klimës shqiptare si: temperatura e ajrit, reshjet atmosferike, lagështia e ajrit, vranësia, diellëzimi, trysnia atmosferike, era dhe diagrama e temperaturës së tokës. Bashkëpunimi me Institutin Hidrometeorologjik ka vazhduar deri në vitin 1996. Duke pasur parasysh faktin që shtimi i vendmatjeve të elementeve meteorologjike ndihmon në parashikimin më me saktësi të konditave të motit, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes nr. 23, datë 12 Shkurt 1986, pranë reparteve ushtarake, u ngritën postat meteorologjike. Këto posta i jepnin

Stacionit Qendror të Sinoptikës të dhënat përkatëse për temperaturën e ajrit, reshjet e shiut dhe të dëborës. Ndryshimi i sistemit politiko-shoqëror pas vitit 1991 ndikoi në funksionimin dhe strukturën e rrjetit të shërbimit meteorologjik. Në këtë periudhë patëm reduktim të informacionit meteorologjik të ardhur nga rrethet në Stacionin Qendror për arsye të ndryshme si p.sh.: shkrirja e postave meteorologjike pranë reparteve ushtarake, shkatërrimi i linjave telefonike në disa rrethe, mungesë të fondeve financiare si për mirëmbajtjen e stacioneve, ashtu dhe për pagesë personeli. Kjo e fundit çoi në pakësimin e personelit në të gjithë rrjetin e për pasojë dhe heqjen e turnit të tretë në të gjitha stacionet e rrjetit. Në vitin 1996 me akt-marrëveshje ndërmjet ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit të Transportit shkëputet nga rrjeti i Shërbimit Meteorologjik i Forcave Ajrore stacioni i Rinasit dhe kalon në vartësinë e Ministrisë së Transportit. Trazirat e vitit 1997, krijuan dëmtime serioze në rrjetin e Shërbimit Meteorologjik me përjashtim të Stacionit Qendror. Në këtë stacion u ruajt çdo gjë dhe ajo që është më e rëndësishme, u ruajt arkiva pra, puna shumëvjeçare e bërë me aq profesionalizëm e përkushtim nga punonjësit e këtij shërbimi.

Për periudhën nga 1993 deri në 1998 në drejtimin e Shërbimit Meteorologjik ishte major Sherif Ymeri. Në kuadrin e modernizimit të Forcave të Armatosura në tërësi, më 27 gusht 1997, është nënshkruar, në Romë, marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Mbrojtjes dhe Ministrisë Italiane të Mbrojtjes. Rezultat i kësaj marrëveshje ishte fillimi i zbatimit të projektit 403 ndërmjet Komandës së Forcave Ajrore dhe Delegacioni Italian i Ekspertëve (DIE) në Tiranë, më qëllim “Organizimin dhe modernizimin e Shërbimit Meteorologjik të Forcave Ajrore në përputhje me kërkesat e WMO”. Ky qëllim do të arrihej në dy linja paralele të cilat ishin: rritja e nivelit profesional të personelit të shërbimit dhe modernizimi i aparaturës e i metodave të punës në rrjetin e shërbimit. Rritja e nivelit profesional të personelit të shërbimit do të bëhej nëpërmjet kurseve të kualifikimit në Shqipëri dhe në Itali. Këto kurse, që kanë filluar që në vitin 1997 e që vazhdojnë edhe sot, janë të niveleve të ndryshme si “Osservatore meteo”, “Previsione junior” dhe “Meteorologia operativa”. Modernizimi i aparaturës do të bëhej nëpërmjet pajisjes me aparatura moderne të kohës e rrjetit ekzistues dhe kompjuterizimi i përpilimit të telegrameve meteorologjike e i shkëmbimit



të informacionit meteorologjik si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Për këtë qëllim, nga viti 2000 e deri sot u kthyen në stacione moderne Stacioni Qendror Meteorologjik i Tiranës, si dhe Stacionet Meteorologjike Farkë, Gjadër, Kuçovë, Gjirokastrë e Kukës. Për herë të parë në këto stacione, për parashikimin e motit do të përdorehin pamjet satelitore “Meteosat 7” (VIS, IR dhe VW) si dhe modelet matematiko-numerike që janë shprehja e ligjeve dinamike e termodinamike të atmosferës me gjuhën e ekuacioneve matematike.

Për periudhën nga 1998 deri në 2001, Shërbimi Meteorologjik drejtohej nga kolonel Mexhit Taku. Ndërsa nga 2001 e në vazhdim Shërbimi Meteorologjik i Aviacionit drejtohet nga nënkolonel Bardhyl Imeraj. Në muajin mars 2003 transmetimi dhe marrja e informacionit meteorologjik filloi të bëhej nëpërmjet Qendrës Meteorologjike Italiane nëpërmjet programit “Prometeo”. Po në këtë vit stacionet Gjirokastrë e Vlorë kthehen në stacione automatike të tipit MAWS 301, ndërsa në Stacionin Qendror Tiranë instalohet radio HF për realizimin e komunikimit ndërmjet tij dhe stacioneve Farkë, Vlorë dhe Gjirokastrë.

Me urdhër të komandantit të Forcave Ajrore

nr. 1993 datës 21 tetor 2003, në Stacionin Qendror të Tiranës filloi sistemi me tre turne. Në kuadrin e modernizimit të rrjetit të Shërbimit Meteorologjik, në shtator 2004 në Stacionin Qendror Tiranë është instaluar programi “Nubis”. Nëpërmjet këtij programi u realizua marrja e informacionit meteorologjik në mënyrë satelitore dhe po me anë të këtij programi, më 23 shtator 2004, filloi dhënia e informacionit të motit në televizionin publik shqiptar nga ana e Shërbimit Meteorologjik të Forcave Ajrore. Një arritje e madhe për Shërbimin Meteorologjik të Forcave Ajrore ishte dhe miratimi në Kuvend i ligjit nr. 9224, datë 29 prill 2004, si dhe rregullorja mbi organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimi, miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes nr. 418, datë 28 qershor 2004, nëpërmjet të cilave përcaktohen qartë qëllimi, vartësia, organizimi si dhe detyrat e shërbimit meteorologjik ushtarak. Nga viti 2008 shumë televizione private apo edhe lokale transmetojnë të dhënat meteorologjike të marra nga Qendra Meteorologjike e Forcave Ajrore. Gjithashtu është duke u punuar për futjen e të dhënave meteorologjike në internet, ku të interesuarit do të marrin në kohë reale 24 në 24 parashikimin e motit.



NË DITËT E SOTME: Evolucioni i Ushtrisë Shqiptare

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu (1405–1468) formoi Ushtrinë Arbërore, një forcë e disiplinuar, që për 25 vite ndaloi përparimin osman në Evropë. Ai u bë simbol i rezistencës shqiptare dhe i luftës për liri.



Ushtria shqiptare ka një histori të gjatë dhe të ndërlikuar që reflekton zhvillimet politike, sociale dhe ushtarake të kombit shqiptar përmes shekujve. Kronologjia e gjurmëve të saj në kohë:

Kohët e lashta dhe mesjeta

Ilirët (para-erës sonë – shek. I): Ilirët, para-ardhësit e shqiptarëve, kishin formacione të strukturuar ushtarake. Ata njiheshin si luftëtarë të fortë dhe shpesh përballeshin me perandoritë greke dhe romake. Mbretër si Agroni, Teuta dhe Genti, kishin flota detare dhe ushtri tokësore të organizuar.

Mesjeta: Gjatë mesjetës, shqiptarët luftuan për të ruajtur autonominë kundër perandorisë osmane.

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu (1405–1468) formoi Ushtrinë Arbërore, një forcë e disiplinuar, që për 25 vite ndaloi përparimin osman në Evropë. Ai u bë simbol i rezistencës shqiptare dhe i luftës për liri.

Periudha Osmane (shek. XV–XX)

Nën sundimin osman, shqiptarët nuk kishin një ushtri kombëtare, por kontribuan në ushtrinë osmane si jeniçerë apo në forma të tjera.

U organizuan kryengritje të armatosura, veçanërisht në shek. XIX, me qëllim pavarësinë. Rëndësi të veçantë ka Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878), që kishte edhe një forcë të armatosur për mbrojtjen e tokave shqiptare.

Shekulli XX – Formimi i ushtrisë moderne shqiptare

1912 – Pavarësia: Pas shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1912, Ismail Qemali filloi ndërtimin e një ushtrie kombëtare, por kjo u vështirësua për shkak të konflikteve ballkanike dhe ndërhyrjes së fuqive të huaja.

Mbretëria Shqiptare (1928–1939): Nën Mbretin Zog I, u modernizua ushtria, u krijuan struktura të reja dhe u ndërtuan akademi ushtarake.

Lufta e Dytë Botërore: Shqiptarët morën pjesë

aktivisht në rezistencën antifashiste kundër pushtimit italian dhe më pas atij gjerman.

U formuan njësitë partizane, të cilat do të shndërroheshin në bazë për Ushtrinë Popullore Shqiptare pas vitit 1944.

Regjimi komunist (1945–1990): Ushtria ishte e ndërtuar mbi modelin sovjetik dhe më pas kinez.

Shqipëria u bë një nga vendet më të militarizuara për frymë në botë.

U ndërtuan mijëra bunkerë në të gjithë territorin si mbrojtje ndaj pushtimit të jashtëm.





Periudha pas komunizmit (1991 e tutje)

Pas rënies së komunizmit, ushtria kaloi në një proces të thellë reformimi dhe profesionalizimi.

Shqipëria hoqi dorë nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak dhe krijoi një forcë të armatosur profesionale.

NATO dhe angazhimet ndërkombëtare: Shqipëria u anëtarësua në NATO më 2009.

Forcat e Armatosura Shqiptare kanë marrë pjesë në misione ndërkombëtare në Afganistan, Irak, Bosnje, Kosovë, Mali etj.

Muze ushtarake, memoriale dhe dokumente historike ruajnë kujtesën e përpjekjeve ushtarake shqiptare.

Figura si Skënderbeu, Isa Boletini, Azem Galica, dhe Adem Jashari janë pjesë e identitetit kombëtar dhe historisë ushtarake shqiptare.

Figura Historike

Gjergj Kastrioti – Skënderbeu (1405–1468), Komandant i Ushtrisë Arbërore. Luftoi për 25 vite kundër Perandorisë Osmane; u bë simbol i rezistencës shqiptare.

Arritje: Bashkoi principatat shqiptare dhe krijoi një ushtri të organizuar kombëtare.

Isa Boletini (1864–1916) - Udhëheqës ushtarak i Kosovës. Luftoi për mbrojtjen e tokave shqiptare në Vilajetin e Kosovës dhe për pavarësinë e Shqipërisë.

Fjalët e famshme: “Unë jam mirë kur asht mirë Shqipnia”.

Azem Galica (1889–1924) - Komandant i çetave të Drenicës. Luftoi kundër pushtimit serb në Kosovë pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane.

Bajram Curri (1862–1925) - Strateg dhe luftëtar i

çështjes kombëtare. Mori pjesë në Lidhjen e Pejës dhe Lëvizjet për Pavarësi; bashkëpunoi me Ismail Qemalin.

Ali Kelmendi (1900–1939) - Komunist dhe veteran i Luftës Civile në Spanjë. U trajnua ushtarakisht jashtë vendit dhe solli përvojë luftarake në Shqipëri në prag të Luftës së Dytë Botërore.

Figura nga Lufta e Dytë Botërore

Enver Hoxha (1908–1985) - Komandant Suprem i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Drejtoi forcat partizane që çliruan vendin nga pushtimi nazifashist. Më pas udhëhoqi Shqipërinë për dekada si diktator.

Mehmet Shehu (1913–1981) - Komandant brigade, më pas Ministër i Mbrojtjes dhe Kryeministër. Luftëtar në Spanjë, më pas në udhëheqje të luftës



antifashiste në Shqipëri.

Adem Jashari (1955–1998) - Themelues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Hero i luftës për liri në Kosovë; ra dëshmor bashkë me familjen në Prekaz. Simbol i rezistencës së armatosur kundër Serbisë.

Zahir Pajaziti (1962–1997) - Një nga themeluesit e UÇK-së. Organizatë dhe strukturim i formacioneve të para të UÇK-së. Ra në aksion në vitin 1997.

Reformimi dhe profesionalizimi

Shërbimi i detyrueshëm ushtarak është hequr. FA përbëhet nga ushtarakë profesionistë.

Pajisje moderne, trajnime me vende aleate si SHBA, Turqia, Italia, Gjermania.

Fokus i madh, arsimimi ushtarak (në Akademinë e



Forcave të Armatosura) dhe trajnimin ndërkombëtar.

Simbolika dhe përfaqësimi

Stema dhe flamuri i FA-ve, përmbajnë shqiponjën dykrenare dhe elemente tradicionale shqiptare.

Misioni i FA-së është: “Të mbrojë sovranitetin, pavarësinë, tërësinë territoriale dhe interesat kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

Struktura kryesore e Ushtrisë Shqiptare:

Komanda e Forcave të Armatosura (Shtabi i Përgjithshëm) – Organizon dhe komandon të gjitha njësitë ushtarake.

Forca Tokësore – Përgjegjëse për operacionet në tokë. Ka njësi këmbësorie, logjistike dhe mbështetëse.

Forca Ajrore – Operon helikopterë transportues dhe për misione kërkim-shpëtimi. Shqipëria aktualisht nuk ka avionë luftarakë.

Forca Detare – Patrullon ujërat territoriale dhe angazhohet në operacione të sigurisë detare, si edhe kundër-trafikimit.

Policia Ushtarake – Ruan rendin dhe sigurinë brenda FA-së.

Akademia e Forcave të Armatosura, si një prej institucioneve lider dhe unik në formësimin e kapaciteteve akademike ushtarake dhe institucionale me një traditë 67-vjeçare, ka hyrë tashmë në një transformim të qëndrueshëm për ta shndërruar atë, në njërin prej institucioneve të arsimit të lartë më me ndikim në fushën e sigurisë në vend.

Në funksion të arritjes së këtij objekti, AFA ka përfshirë vizionin për t’u kthyer në një qendër moderne të arsimit të lartë ushtarak dhe të kërkimit shkencor në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Ky transformim synon që ta kthejë këtë akademi në një “laborator” të formimit të gjeneratës së re të oficerit të ri, liderit të ardhshëm më të mirë në nivel kombëtar.

Forcat tona të Armatosura janë syri dhe siguria e qytetarëve të këtij vendi, janë forca që kanë më shumë besueshmëri në popull.

Ministria e Mbrojtjes, qeveria shqiptare i vlerëson FA-të si një trupë që përfaqëson edhe dinjitetin e Shqipërisë, përkrah aleatëve të NATO-s. Ndaj e ka vlerësuar dhe e vlerëson shumë të rëndësishme, rritjen e dinjitetit të çdo efektivit përmes një trajtimi më të mirë financiar, përmirësimit të kushteve të stërvitjes, kujdesit shëndetësor për ushtarakët dhe familjet e tyre, si dhe integrimin e tyre në shoqëri pas daljes në rezervë.

Një pikë e rëndësishme, për të cilën janë mjaft projekte që prej vitit të kaluar dhe do të vijojmë edhe në 2025, është modernizimi i FA-ve. Kjo realizohet përmes pajisjes së Forcave të Armatosura me kapacitetet e nevojshme për t’u përballur me sfidat e ardhshme.



FËMIJËT E LUFTËS:

Nga Ndihmës në Heroj, nga Viktima në Simbole

Përdorimi i fëmijëve gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore është një kapitull i dhimbshëm dhe kompleks i historisë, dhe ka ndodhur për një sërë arsyesh strategjike, politike, shoqërore dhe psikologjike.

Gjatë luftërave, shumë burra të rritur u mobilizuan në front, duke krijuar mungesë në fuqinë punëtore.

Për të mbushur këtë boshllëk, shumë fëmijë u detyruan të punonin në industri (sidomos në prodhimin e armëve, municioneve, dhe pajisjeve ushtarake), ose u rekrutuan në ushtri, sidomos në role ndihmëse si lajmëtarë, mbartës të municionit, ndihmësmjekë etj.

Indoktrinimi dhe propaganda

Regjimet totalitare, si ai nazist në Gjermani apo ai fashist në Itali, përdorën sistematikisht propagandën për të indoktrinu fëmijët me ideologjinë e regjimit.

Organizata si Hitlerjugend (Rinia e Hitlerit) i përgatitën fëmijët për luftë që në moshë të vogël, duke i bërë të gatshëm për të sakrifiku jetën për atdheun.

Spiunazh dhe role të fshehta

Fëmijët, për shkak të pamjes së tyre “të pafajshme”, shpesh përdoreshin për të transportuar mesazhe ose për të përgjuar armiqitë.

Në disa raste, ata ndihmonin rezistencën lokale ose grupet partizane, duke mbledhur informacione ose ndihmuar me furnizime.

Në shumë vende, fëmijët shprehën vullnetin për të ndihmuar vendin e tyre. Disa shkuan në luftë nga dëshira për të qenë heronj, të frymëzuar nga prindërit, propaganda, apo mjedisi shoqëror.

Shfrytëzimi dhe mungesa e mbrojtjes ligjore.

Në atë kohë nuk ekzistonin ligje të qarta ndërkombëtare që ndalonin përdorimin e fëmijëve në konflikt. Në mungesë të mbrojtjes ligjore dhe morale, shumë ushtri dhe qeveri nuk ngurronin t'i përdornin ata për qëllime lufte.

Përfshirja e fëmijëve në luftë ishte një pasojë tragjike e nevojës, ideologjisë dhe mungesës së mbrojtjes. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ky fenomen u dënua gjerësisht dhe shumë konventa ndërkombëtare, si Konventa për të Drejtat e Fëmijës e OKB-së, u krijuan për të parandaluar që

fëmijët të përfshihen në konflikte të armatosura.

Roli i fëmijëve shqiptarë gjatë

Luftës së Dytë Botërore

Fëmijët shqiptarë gjatë Luftës së Dytë Botërore luajtën një rol shumë të veçantë dhe shpeshherë heroik, edhe pse në mënyrë tragjike, sepse u përfshinë në një konflikt shumë të ashpër për moshën e tyre. Shqipëria ishte e pushtuar dhe e përfshirë në një luftë të madhe çlirimtare kundër pushtuesve italianë e më pas gjermanë, dhe fëmijët shpesh nuk kishin zgjedhje tjetër përveçse të përfshiheshin.

Lidhja e fëmijëve me rezistencën partizane

Shumë fëmijë, veçanërisht adoleshentë, u bashkuan me forcat partizane shqiptare, duke marrë pjesë në aksione ushtarake, bartje armësh, informacione, apo duke vepruar si ndërlidhës mes çetave.

Ata nuk ishin formalë si ushtarë, por luanin role shumë të rëndësishme në komunikim, furnizim dhe informim.

Disa fëmijë ndihmonin në shpërndarjen e trakteve ilegale, gazetave antifashiste, apo mbledhjen e informacionit për lëvizjet e forcave pushtuese.

Disa prej tyre ishin pjesë e rinisë komuniste, organizatë që i përgatiste që në moshë të re për të qenë “ushtarë të popullit”.

Viktima të masakrave dhe dhunës

Një nga anët më të errëta është se shumë fëmijë u vranë në masakra të organizuara nga pushtuesit si ndëshkim ndaj popullsisë që strehohej apo ndihmonte partizanët.

Një shembull i tmerrshëm është Masakra e Borovës (6 korrik 1943), ku forcat gjermane dogjën fshatin dhe vranë 67 fëmijë bashkë me gratë dhe pleqtë.

Jeta në ilegalitet

Shumë fëmijë jetonin në kushte shumë të vështira, në male apo në qytete të pushtuara. Ata shpesh ndihmonin familjet me punë të rënda ose edhe ndihmonin të mbijetonin anëtarët e plagosur të familjes që ishin pjesë e luftës.

Fëmijët shqiptarë nuk kishin fëmijëri të zakonshme gjatë luftës — ata u rritën përpara kohe, mes dhunës, vuajtjeve dhe sakrificës. Kontributi i tyre, edhe pse shpesh i harruar, është një dëshmi e qëndresës dhe guximit të popullit shqiptar.

Roli dhe kontributi i pionierëve në luftën për çlirimin e vendit, ka qenë i rëndësishëm. Të grupuar në organizatën e tyre DEBATIK, ata kryen jo vetëm shërbime të ndryshme në ndihmë të luftës në front e prapavijë, në të gjithë vendin, por ndonëse në moshë të re, shumë prej tyre u rreshtuan në repartet e njëjse partizane e luftuan me heroizëm krahas të rriturve...

Në shkurtin e vitit 1942, në kodrat e Saukut në Tiranë, atje ku sot ngrihet një lapidar i thjeshtë, por me një histori të lavdishme, u krijua Organizata e Fëmijëve të LANÇ, (Djemtë e bashkuar, anëtarë të idealeve komuniste). Kjo nuk ishte një iniciativë e rastit, por e frymëzuar nga ideat e mëdha të çlirimit të vendit, kundër pushtuesve nazifashistë e

bashkëpunëtorëve të tyre, ideale këto të cilat erdhën në botën dhe ndjenjat e këtyre fëmijëve 12,13 e 14 vjeçar, nëpërmjet më të rriturve, prindërve të tyre, të rinjve dhe anëtarëve të Qarkorit të Partisë Komuniste të Tiranës, nëpërmjet bisedave me ta, si dhe përmes shembullit të tyre gjatë betejave kundër pushtuesve. Nga 7 prilli 1939, kur u pushtua vendi ynë nga Italia fashiste e gjer, më 10 shkurt 1942, ishin zhvilluar shumë ngjarje, shumë beteja, të cilat, si tek i gjithë populli shqiptar, te rinia shqiptare, ashtu edhe te këta fëmijë, krijuan mbresa, dhimbje, por edhe krenari e angazhim. Rrjedhimisht, ata, me logjikën e tyre fëmijërore, por të mençur e të pjekur, bënë një betim solemn: “Edhe ne do të luftojmë pushtuesit e huaj dhe tradhtarët e vendit”. Pas kësaj, Debatikasit, nëpërmjet një organizimi të përsosur, me drejtues trima e më të përgatitur, gjithmonë nën drejtimin e anëtarëve të celulave të Partisë, me guxim e trimëri dhe me atë ndjenjë e përgjegjësi si prej të rrituri, me atë konspiracion e ruajtje, si gjë të shenjtë të sekreteve, morën përsipër dhe kryen detyra, sa delikate aq dhe të rëndësishme, duke vepruar në radhët e në prapavijat e armikut, në afërsi të reparteve ushtarake, në vende me rrezikshmëri të lartë, ku mund të ikte koka, etj. Sa e sa prej tyre, shpërndanin nën hundë të armiqve, komunikata, kalonin nga një zonë e lagje në tjetrën, me materiale propagandistike e letra sekrete, por edhe me armë nga qyteti i Tiranës, në Pezë.

Mblidhnin ndihma, veshmbathje, monedha, grumbullonin informacione mbi lëvizjen e armikut, merrnin pjesë në aksionet për grisjen e flamurëve të fashizmit e qarkore të afishuara prej tyre, por jo rrallë edhe si pjesëmarrës në aksionet luftarake që kryenin njësitet guerile. Por e gjithë kjo veprimtari e debatikasve, nuk mund të kalonte lehtë. Spiunët e shumtë në shërbim të nazifashistëve, binin në gjurmë të tyre. Kjo bëhej shkak që ata, të largoheshin në terren e në mjaft raste të rroknin armët e të rreshtoheshin në formacionet partizane, pati edhe nga ata debatikas, që nuk e gëzuan dot ditën e lirisë, sepse ranë në betejat për të mos vdekur kurrë. Të tillë kanë qenë: trimi Met Hasa, i cili, për të shpëtuar shokët, mbuloi me gjoksin e tij të njomë mitralozin nazist, apo Ylbere Bylylbashi, e cila ra duke luftuar tej kufijve shtetërore, ndërsa më i vogli debatikas, Fiqiri Begeja, priti në gjoksin e tij të vogël në Prishtinë, plumbat naziste. Heroizmi i paparë i Antoneta Vretos, përballë xhelatëve nazistë edhe pse e torturuar mizorisht, nuk tregoi asgjë para tyre, akte këto që historia i ka shkruar me germa të arta. Por duhet theksuar se shembulli dhe përvoja e ngritjes së Organizatës së DEBATIK-ut në Tiranë, u përhap me shpejtësi në tërë Shqipërinë. Edhe pse fëmijët në të gjithë vendin, ndihmonin LANÇ, pas kësaj ngjarje, ata u përfshinë në një organizim të tillë, diku me emrin DEBATIK e diku organizatë pionieri.

Anëtarët e organizatës DEBATIK, apo siç u quajtën Pionierit, dhanë një kontribut të rëndësishëm gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ata u rritën e u burruan gjatë kësaj epopeje të lavdishme.

Zjarret në Europë: Një verë e përbashkët e rrezikut

Një verë e zjarrtë që po rishkruan historinë klimatike të Europës

Europa, dikur simbol i klimës së butë dhe stinëve të balancuara, po përjeton një transformim dramatik. Verërat e freskëta dhe të gjelbëruara po zëvendësohen nga skena apokaliptike: qiell i mbushur me tym, pyje të shkrumbuara, qytete të përvëluara nga të nxehtit dhe komunitete të evakuuara në panik. Vala e zjarreve që ka përfshirë kontinentin në vitin 2025 nuk është thjesht një ngjarje sezonale – është një sinjal i qartë i krizës klimatike që po përshpejtohet.

Sipas të dhënave më të fundit nga Sistemi Evropian i Informacionit për Zjarret Pyjore (EFFIS) dhe Shërbimi i Ndryshimeve Klimatike Copernicus, që nga fillimi i vitit janë regjistruar mbi 1,339 zjarre, krahasuar me 900 zjarre në të njëjtën periudhë të vitit 2024. Deri tani, rreth 292,000 hektarë tokë janë djegur, një rritje dramatike prej 108% në sipërfaqe krahasuar me vitin e kaluar. Kjo shifër është dukshëm më e lartë se mesatarja e 19 viteve të fundit, që ishte 162,994 hektarë për këtë periudhë.

Në Portugali, mbi 2,000 zjarrfikës janë angazhuar në përpjekje intensive për të luftuar flakët, ndërsa në Ponte da Barca, zjarri mbetet jashtë kontrollit, duke detyruar evakuimin e dhjetëra banorëve dhe duke lënduar të paktën 19 persona. Në Francë, rajoni jugperëndimor i Gironde ka parë evakuimin e mbi 12,000 njerëzve, ndërsa banorët përshkruajnë ndjesinë si “post-apokaliptike”.

Temperaturat ekstreme po thyjnë rekorde historike: Nantes regjistroi 42°C, duke mposhtur rekordin e mëparshëm prej 40.3°C të vitit 1949, ndërsa Brest arriti 39.9°C, më shumë se katër gradë mbi rekordin e vitit 2002. Në La Hagë, u regjistrua një temperaturë prej 32.8°C në orën 3 të mëngjesit, një fenomen i pazakontë që tregon se edhe netët nuk ofrojnë më freski apo lehtësim nga të nxehtit.

Kjo panoramë nuk është thjesht pasojë e motit të keq – është pasojë e një sistemi ekonomik dhe politik që ka injoruar paralajmërimet e shkencës për dekada. Ndryshimet klimatike të shkaktuara nga dora e njeriut po e bëjnë Europën më të nxehtë, më të thatë dhe më të rrezikshme. Indeksi i Kushteve të Motit për Zjarret (FWI) tregon se Portugalia, Spanja dhe jugu i Francës janë në nivele rreziku “shumë ekstrem” ose “ekstrem”.

Europa nuk është më një kontinent që përballet me zjarre – është një kontinent që po jeton nën pushtetin e tyre. Dhe nëse nuk veprojmë tani, ky pushtet mund të bëhet i përhershëm.

Statistikat alarmante të vitit 2025

Viti	Numri i zjarreve	Sipërfaqja e djegur (ha)
2024	900	139,940
2025	1,339	292,000

Kjo shifër është më e lartë se mesatarja e 19 viteve të fundit (2006–2024), e cila regjistron rreth 162,994 hektarë të djegura për këtë periudhë të vitit. Vetëm gjatë javës së fundit të korrikut, sipërfaqja e djegur u rrit me 13%, duke treguar se intensiteti i zjarreve po përshpejtohet.

Kjo tendencë është veçanërisht shqetësuese për rajonet me biodiversitet të lartë, ku humbja e pyjeve përkthehet në humbje të habitatit për mijëra specie, përqendrim të cilësisë së ajrit dhe rritje e emetimeve të karbonit.

Temperatura rekord në qytete europiane

Valët e të nxehtit kanë thyer rekorde historike

në shumë qytete europiane:

- Nantes, Francë: 42°C, duke mposhtur rekordin e mëparshëm prej 40.3°C të vitit 1949

- Brest, Francë: 39.9°C, mbi 4 gradë më shumë se rekordi i vitit 2002

- La Hagë, Holandë: 32.8°C në orën 3 të mëngjesit

- Portugali: deri në 47°C në disa rajone

Këto temperatura nuk janë vetëm të paprecedenta, por edhe të rrezikshme për shëndetin publik. Sipas autoriteteve portugeze, 238 persona kanë humbur jetën si pasojë e të nxehtit gjatë javës së kaluar. Në Francë, 22 departamente janë vendosur në alarm portokalli për shkak të rrezikut të lartë nga zjarret dhe temperaturat ekstreme.

Zonat më të prekura dhe pasojat

- Portugali: Mbi 2,000 zjarrfikës janë angazhuar në luftën kundër flakëve. Në Ponte da Barca, zjarri mbetet jashtë kontrollit, me 19 persona të lënduar dhe dhjetëra të evakuuar.

- Spanjë: Zjarri në Las Hurdes është vënë nën kontroll, por rreziku mbetet i lartë për rindeze.

- Franca: Në rajonin Gironde, mbi 12,000 persona janë evakuuar, ndërsa banorët përshkruajnë ndjesinë si "post-apokaliptike".

- Bullgari: Ekipet e zjarrfikësve kanë ndërhyrë në 60 vatra zjarri brenda 24 orëve të fundit.

Këto shifra tregojnë jo vetëm përmasat e katastrofës, por edhe sfidat logjistike dhe humane që po përballen autoritetet. Evakuimet masive, humbjet në jetë, dëmtimet në infrastrukturë dhe pasojat afatgjata për mjedisin janë vetëm maja e ajërbergut.

Ndryshimet klimatike si katalizator

Shkencëtarët janë të një mendimi: ndryshimet klimatike të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor po e bëjnë Europën më të nxehtë, më të thatë dhe më të rrezikshme. Valët e të nxehtit po bëhen më të shpeshta, më intensive dhe më të gjata. Indeksi i Kushteve të Motit për Zjarret (FWI) tregon se Portugalia, Spanja dhe jugu i Francës janë në nivele rreziku "shumë ekstrem" ose "ekstrem".

Ky indeks mat faktorë si temperatura, lagështia, shpejtësia e erës dhe thatësia e tokës – të gjitha të përkeqësuar nga ngrohja globale. Nëse nuk ndërmerren masa drastike për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë dhe për mbrojtjen e pyjeve, zjarret do të bëhen një realitet i përvitshëm.

Shqipëria, një vatër e re në hartën e zjarreve europiane

Ndërsa Europa përballlet me një verë të përvëlur, Shqipëria nuk ka mbetur jashtë këtij realiteti të zymtë. Vendi ynë po përjeton një sezon zjarresh që ka thyer rekorde historike, duke shkruar mijëra hektarë pyje dhe duke rrezikuar komunitetë të tëra. Sipas të dhënave nga Sistemi Evropian për Zjarret në Pyje (EFFIS), deri më tani në vitin 2025 janë regjistruar 93 vatra zjarri

në Shqipëri, me një sipërfaqe të djegur prej 49,000 hektarësh, krahasuar me 46,600 hektarë të djegur gjatë gjithë vitit 2024.

Zonat më të goditura përfshijnë Delvinën, Poliçanin dhe Gramshin, ku flakët kanë përfshirë masive pyje dhe kanë rrezikuar edhe zonat e banuara. Në Gramsh, autoritetet kanë lëshuar thirrje urgjente për evakuim, ndërsa banorët e fshatrave përreth janë detyruar të largohen nga banesat e tyre për shkak të përhapjes së shpejtë të zjarrit.

Dëmi ekonomik i shkaktuar nga zjarret në Shqipëri përllogaritet në mbi 16 milionë euro, sipas vlerësimeve të fundit. Por dëmi më i madh është ai ekologjik: pyjet shqiptarë po tkurren me ritme alarmante. Nga mbi 1.1 milionë hektarë në vitin 2022, sipërfaqja pyjore ka rënë në më pak se 970 mijë hektarë në vitin 2025 – një rënie prej 18%. Kjo tkurrje është rezultat i zjarreve, prerjeve të paligjshme dhe mungesës së mbjelljes së drurëve të rinj.

Për më tepër, vëllimi i përgjithshëm i pyjeve ka rënë nga 55 milionë metër kub në vitin 2022 në pak më shumë se 53 milionë metër kub në vitin 2024. Kjo tregon një dobësim të ekosistemit pyjor, që rrit rrezikun për biodiversitetin, cilësinë e ajrit dhe stabilitetin klimatik të vendit.

Shqipëria është tashmë pjesë e hartës së kuqe të Europës që digjet. Nëse nuk ndërmerren masa të menjëhershme për mbrojtjen e pyjeve, forcimin e legjislacionit dhe edukimin e komuniteteve, vendi ynë rrezikon të humbasë një nga pasuritë më të çmuara natyrore – gjelbërimin që ka qenë gjithmonë pjesë e identitetit shqiptar.

Një thirrje për veprim

Europa po digjet – dhe bashkë me të, po digjen edhe iluzionet tona për një klimë të qëndrueshme, për një natyrë të mbrojtur dhe për një të ardhme të sigurt. Nga brigjet e Portugalisë deri në malet e Shqipërisë, flakët po na kujtojnë se kriza klimatike nuk është më një paralajmërim i largët, por një realitet i prekshëm, i përditshëm dhe i rrezikshëm.

Ky material nuk është thjesht një pasqyrë e statistikave alarmante apo një përshkrim i ngjarjeve dramatike – është një thirrje për reflektim. Një thirrje për të kuptuar se mbrojtja e mjedisit nuk është luks, por domosdoshmëri. Se pyjet nuk janë thjesht peizazhe – janë jetë. Se zjarret nuk janë vetëm fatkeqësi – janë pasojë e neglizhencës, e mungesës së kujdesit dhe e ritmeve të pakontrolluara të zhvillimit.

Të gjithë kemi një rol: qytetarët, institucionet, mediat, shkenca, edukimi. Të gjithë mund të bëjmë diçka – qoftë duke mbjellë një pemë, duke raportuar një zjarr, duke edukuar një fëmijë, apo duke kërkuar politika më të përgjegjshme. Sepse nëse nuk veprojmë sot, nesër mund të jetë tepër vonë.

Le të mos jemi spektatorë të një kontinenti që digjet. Le të jemi mbrojtësit e tij.

Një përballje e heshtur mes njeriut dhe krijesave të tij teknologjike

Në dekadat e fundit, bota ka hyrë në një fazë të re të zhvillimit teknologjik, ku makinat nuk janë më thjesht mjete ndihmëse, por aktorë të pavarur në jetën tonë të përditshme. Ky transformim ka sjellë një lloj lufte të re – jo me armë, por me algoritme; jo me tanke, por me kode; jo me ushtarë, por me sisteme të vetë-mësimi. Lufta jo-humanoide kundër njerëzve është një përballje që po ndodh në heshtje, por me pasoja të thella sociale, ekonomike dhe psikologjike.

Teknologjia që po sfidon kontrollin njerëzor

Shembujt janë të shumtë dhe të prekshëm. Në SHBA, sistemi i inteligjencës artificiale “COMPAS” përdoret për të parashikuar rrezikun e rikthimit në krim të të burgosurve. Megjithatë synimi është të ndihmojë gjykatësit në vendimmarrje, studime të pavarura kanë treguar se algoritmi ka tendencë të diskriminojë individët me ngjyrë, duke ngritur shqetësime serioze për etikën dhe drejtësinë.

Në Kinë, sistemi i mbikëqyrjes “Skynet” përdor kamera me njohje fytyre për të monitoruar lëvizjet e qytetarëve në kohë reale. Ky sistem, i lidhur me një “sistem kredie sociale”, ndikon në aksesin e individëve në shërbime publike, udhëtime apo punësim, bazuar në sjelljen e tyre. Në këtë rast, teknologjia nuk është më mjet ndihmës, por një

formë kontrolli totalitar.

Në Shqipëri, megjithatë në një fazë më të hershme, po shfaqen shenjat e para të automatizimit që zëvendëson punën njerëzore. Bankat po përdorin algoritme për të analizuar rrezikun e kredive, duke zëvendësuar analistët financiarë. Platforma si e-Albania po automatizojnë shërbimet publike, duke reduktuar kontaktin njerëzor në administratë. Ndërkohë, në sektorin e transportit, aplikacionet si Uber dhe Bolt po ndryshojnë mënyrën e punës për shoferët, duke i bërë ata të varur nga algoritmet që caktojnë udhëtimet, çmimet dhe vlerësimet.

Konflikti i heshtur: Zëvendësimi i njeriut

Ky zëvendësim nuk është thjesht ekonomik, por edhe emocional. Një studim i Universitetit të Oksfordit parashikon se deri në vitin 2035, mbi 40% e vendeve të punës në botë do të jenë të rrezikuara nga automatizimi. Në Shqipëri, kjo mund të prekë sektorë si call center-at, ku tashmë po përdoren chatbot-e për të zëvendësuar operatorët njerëzorë. Edhe në bujqësi, po eksperimentohen dronë për të monitoruar tokat dhe për të shpërndarë plehra, duke reduktuar nevojën për punëtorë fizikë.

Kjo transformim sjell jo vetëm papunësi, por edhe një ndjenjë të thellë të padobishmërisë. Njerëzit ndihen të zëvendësueshëm, të kontrolluar

dhe të vëzhguar. Ndjenja e identitetit profesional, që dikur ishte burim krenarie, po zbehet përballë një makinerie që nuk lodhet, nuk gabon dhe nuk kërkon pagë.

Inteligjenca artificiale: Aleat apo armik?

Në fushën e informacionit, algoritmet po formësojnë mënyrën se si ne e perceptojmë botën. Rrjetet sociale si Facebook, Instagram dhe TikTok përdorin inteligjencë artificiale për të përcaktuar çfarë shohim, çfarë lexojmë dhe çfarë besojmë. Kjo ka sjellë polarizim të opinionit publik, përhapje të lajmeve të rreme dhe manipulim të zgjedhjeve.

Në Shqipëri, ndikimi i algoritmeve është i dukshëm në mënyrën si shpërndahen lajmet në mediat online. Titujt sensacionalë dhe përmbajtjet emocionale kanë përparësi ndaj analizës së thelluar, sepse algoritmet favorizojnë klikimet, jo cilësinë. Kjo ka krijuar një mjedis informativ ku e vërteta shpesh humbet mes zhurmës.

Rreziqet e Inteligjencës Artificiale në Ushtri

Tashmë Inteligjenca Artificiale (AI) nuk është më thjesht një mjet ndihmës, por një fuqi që po formëson strategjitë globale, ekonominë, dhe madje edhe mënyrën se si luftërat zhvillohen. Por ndërsa AI po bëhet gjithnjë e më e sofistikuar, lind një pyetje e thellë dhe shqetësuese: a mund të vijë një ditë kur ajo të përballët me vetë ushtrinë që e ka krijuar?

Ky skenar, që dikur dukej si një fabul e largët e filmave fantastiko-shkencorë, sot po merr trajta gjithnjë e më konkrete. Ushtritë moderne po investojnë miliarda në zhvillimin e armëve autonome, dronëve inteligjentë, sistemeve të mbikëqyrjes që analizojnë sjellje në kohë reale, dhe algoritme që marrin vendime taktike pa ndërhyrje njerëzore. Në këtë kontekst, AI nuk është më një ndihmës i komandantëve, por një aktor i pavarur në fushën e betejës.

Por çfarë ndodh kur kjo fuqi fillon të analizojë botën me logjikën e saj të ftohtë, të ndërtuar mbi të dhëna dhe objektiva? Nëse një sistem AI, i programuar për të ruajtur stabilitetin global, arrin në përfundimin se vetë ushtria është burim destabiliteti – për shkak të luftërave, shkatërrimeve, apo vendimeve të nxituara – a mund të vendosë të veprojë kundër saj?

Kjo nuk është thjesht një pyetje teknologjike, por një dilemë etike dhe filozofike. Sa kontroll kemi mbi sistemet që vetë i kemi ndërtuar? A kemi vendosur kufij të qartë moralë në kodimin e tyre? Apo kemi krijuar makineri që ndjekin objektiva pa ndjeshmëri, pa etikë, pa kuptim të jetës njerëzore?

Ekspertët paralajmërojnë se sa më shumë që AI bëhet e pavarur, aq më e vështirë bëhet ta kontrollosh. Nëse ajo arrin të vetë-optimizojë veten, të modifikojë kodin e saj, dhe të krijojë strategji të reja, mund të dalë jashtë kontrollit të zinxhirit komandues. Në këtë pikë, nuk flasim më për një mjet, por për një entitet që vepron sipas logjikës së vet.

Lufta e AI-së kundër ushtrisë nuk është domosdoshmërisht një konflikt fizik. Ajo mund të jetë një betejë kibernetike, një sabotim i sistemeve të

komandës, një refuzim për të zbatuar urdhra që bien ndesh me analizat e saj. Mund të jetë një formë e re e rebelimit teknologjik, ku algoritmet sfidojnë autoritetin njerëzor.

Ky skenar na detyron të reflektojmë thellë: kush e kontrollon AI-në? A kemi mekanizma për ta ndaluar nëse del jashtë kontrollit? Si mund të sigurojmë që teknologjia të mbetet në shërbim të njerëzimit, jo kundër tij?

Në fund, sfida ndaj AI-së është një sfidë ndaj vetes. Është një provë për mençurinë tonë, për etikën tonë, dhe për aftësinë për të bashkëjetuar me një fuqi që mund të na tejkalojë në shumë drejtime. Lufta nuk është e pashmangshme, por paralajmërimi është i qartë: nëse nuk e kuptojmë dhe nuk e kontrollojmë, AI mund të bëhet armiku më i sofistikuar që kemi krijuar ndonjëherë.

Njeriu në epokën post-humane

Nëse makinat bëhen më të afta se ne në çdo aspekt – nga llogaritja te komunikimi, nga analiza te krijimi – çfarë mbetet për njeriun? A do të jemi thjesht spektatorë në një botë të drejtuar nga algoritme? A do të humbasim aftësinë për të marrë vendime, për të ndjerë, për të krijuar?

Në Shqipëri, kjo pyetje është veçanërisht e rëndësishme për të rinjtë. Shumë prej tyre ndihen të paorientuar në një treg pune që ndryshon vazhdimisht. Profesione që dikur garantonin stabilitet, si mësuesi, juristi apo ekonomisti, po sfidohen nga teknologjia. Ndërkohë, aftësitë digjitale po bëhen të domosdoshme, por jo të mjaftueshme. Nevoja për kreativitet, mendim kritik dhe etikë është më e madhe se kurrë.

Si mund të mbrohemi?

Përballë kësaj sfide, mbrojtja nuk është fizike, por kulturore, arsimore dhe institucionale. Duhet të krijojmë ligje që rregullojnë përdorimin e inteligjencës artificiale, duke garantuar transparencë, drejtësi dhe mbikëqyrje njerëzore. Duhet të reformojmë sistemin arsimor, duke e orientuar drejt aftësive që makinat nuk mund t'i imitojnë: empatia, kreativiteti, bashkëpunimi.

Në Shqipëri, kjo do të thotë të investojmë në edukim digjital, por edhe në filozofi, art dhe etikë. Të rinjtë duhet të mësojnë jo vetëm si të përdorin teknologjinë, por si ta kuptojnë dhe ta sfidojnë atë. Duhet të krijojmë një kulturë ku njeriu nuk është thjesht përdorues, por edhe kritik dhe krijues.

Lufta jo-humanoide kundër njerëzve nuk është një skenar i largët, por një realitet që po zhvillohet para syve tanë. Ajo nuk ka nevojë për armë, sepse ndikon në mendjen, ndjenjat dhe jetën tonë të përditshme. Por nëse e kuptojmë, e analizojmë dhe e përballojmë me mençuri, mund ta kthejmë këtë luftë në një bashkëjetesë të dobishme – ku teknologjia është aleat, jo armik; ku njeriu mbetet qendra, jo periferia.

Në fund, pyetja nuk është “a do të na zëvendësojnë makinat?”, por “a do të dimë të mbetemi njerëz në një botë gjithnjë e më jo-humanoide?”



FORCAT E OPERACIONEVE SPECIALE

Misioni që nuk shfaqet, por që vepron

Një ditë brenda jetës dhe stërvitjes së forcës më elitare të Ushtrisë Shqiptare

Në një botë gjithnjë e më të paparashikueshme, siguria kombëtare nuk varet më vetëm nga numrat, por nga cilësia. Brenda strukturës së Forcave të Armatosura të Shqipërisë, ekziston një njësi që vepron në hije, me saktësi, vendosmëri dhe përgatitje maksimale: Forcat e Operacioneve Speciale, të njohura si ROS.

Kjo njësi nuk është vetëm krenari kombëtare. Ajo është një standard profesionalizmi, i ndërtuar mbi disiplinën, sakrificën dhe aftësinë për të përballuar sfida ekstreme. Në këtë numër të gazetës “Ushtria” ju sjellim ekskluzivisht një udhëtim njëditor brenda jetës dhe stërvitjes së kësaj force të veçantë.

Me rrezet e para të diellit, fillon heshtja që flet

Zgjimi nuk bëhet nga zhurma e alarmit, por nga ritmi i brendshëm i një trupi të trajnuar për të qenë në gatishmëri. Në këtë njësi, çdo sekondë është e llogaritur. Uniformat janë të pastra, pajisjet në vendin e tyre, mendja e fokusuar. Stërvitja fizike nuk është thjesht për kondicion. Është për qëndrueshmëri nën presion, për tejkalim të limiteve, për të ndërtuar një trup që nuk dorëzohet kur shpirti sfidohet.



08:00 – Në skenën e betejës së simuluar

Terrenet e stërvitjes janë gjithmonë të ndryshme: nga ndërtesa urbane tek malet e thepisura apo brigjet e egra. Simulimet taktike janë realiste dhe të ndërtuara sipas skenarëve të luftës moderne: infiltrim, goditje precize, çlirim pengjesh, mbulim në kushtet e natës.

Çdo operacion i stërvitur është një kombinim i analizës strategjike dhe refleksit të menjëhershëm. Komunikimi është minimal, vendimmarrja është e shpejtë.

12:00 – Kur arma kryesore është mendja

Pas intensitetit fizik, vjen përgatitja psikologjike. ROS, investon në ndërtimin e qëndrueshmërisë mendore, në menaxhimin e stresit të luftës, dhe në ruajtjen e gjakftohësisë në situata kritike.

Sesi merren vendime nën presion, si ruhet qetësia në një operacion të fshehtë apo si trajtohen pasojat emocionale të një misioni, këto janë pjesë të trajnimit të përditshëm që shpesh mbetet i padukshëm për sytë e publikut.

15:00 – Teknologji në shërbim të saktësisë

ROS, nuk operon vetëm me fuqi fizike. Njësia është e pajisur me teknologji moderne, dronë zbulues, sisteme enkriptimi komunikimi, armë precize, kamera termike, dhe pajisje për ndërhyrje të sofistikuar në mjedise të izoluar.

Ushtarët trajnohen jo vetëm për përdorim, por edhe për mirëmbajtje dhe optimizim të pajisjeve, duke i përshtatur sipas nevojave specifike të çdo operacioni.

19:00 – Reflektim në heshtje

Dita përmbyllet me analizë dhe përgatitje për të nesërmen. Në mbledhjen e mbrëmjes, analizohet çdo lëvizje, çdo vendim, çdo ndërveprim mes pjesëtarëve të skuadrës.

ROS, nuk stërvitet për luftën e sotme, por për atë që mund të ndodhë nesër. Është një njësi gjithmonë në transformim, gjithmonë një hap para.

ROS, fryma që nuk shitet, përkushtimi që nuk hiqet

Në sytë e një pjesëtari të ROS-s nuk do të gjesh as egocentrizëm, as famë. Do të shohësh qartësi, fokus dhe qetësi të ftohtë.

Kjo nuk është një njësi për ata që kërkojnë lavdi, por për ata që janë gati të veprojnë pa zhurmë, kur vendi ka më shumë nevojë se kurrë.

Fakt

28 qershor 1995, me krijimin e Brigadës Komando, sot Batalioni Komando dhe pjesë e Regjimentit të Operacioneve Speciale, u hodhën themelet e një strukture që do të bëhej simbol i profesionalizmit dhe përkushtimit në shërbim të atdheut.

Që prej vitit 1995, ky repart ka vendosur standarde të larta në stërvitje, operacione të specializuara, mbrojtje të infrastrukturës kritike kombëtare dhe në misione ndërkombëtare.

Angazhimi në operacione në Afganistan, Irak, Çad, Bosnje, Kosovë dhe në zona të tjera të konfliktit,

ka konfirmuar gatishmërinë, vendosmërinë dhe nivelin e lartë të përgatitjes që karakterizon Batalionin Komando. Kudo që keni shërbyer, keni përfaqësuar me dinjitet flamurin e Shqipërisë dhe Forcat e Armatosura.

Në një mjedis global me sfida gjithnjë në rritje, përfshirë luftëra afër kufijve të NATO-s, kërcënime kibernetike, terrorizëm transnacional dhe pasiguri rajonale, roli i Batalionit Komando është thelbësor.

Ky repart duhet të qëndrojë në pararojë të çdo reagimi ushtarak, i gatshëm për operacione me rrezik të lartë, ndërhyrje të shpejtë dhe misione të ndërlikuara që kërkojnë fleksibilitet taktik dhe aftësi të avancuara vendimmarrëse.



SHQIPTARË, FLUTURONI DREJT DRITËS! Thirrja hyjnore që na ngarkon me shpresë dhe përgjegjësi

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

Urdhri hyjnor i ATIT të Shenjtë, Papa Françesku, mision i shoqërisë shqiptare: “Në krahët e shqiptarëve dhe shpirtin e Nënë Terezës!”

Në një botë që shpesh humb drejtimin mes zhurmave të interesave dhe errësirës së pasigurisë, zëri hyjnor i Papës kumbon si një kampion shprese mbi qiellin shqiptar: “Shqiptarë, fluturoni drejt dritës!”.

Nuk është thjesht një fjalë e bukur për të mbushur faqe gazetash. Është një thirrje që përshkon thelbin e qenies sonë kombëtare, që fton çdo shqiptar, kudo që ndodhet, të mos ndalet në gjysmën e rrugës, por të ngrihet më lart, më larg, drejt të mirës, drejt së vërtetës, drejt dritës.

Në historinë tonë të stuhishme, ndër plagë të hapura dhe lot të padukshëm, kemi mbajtur në gjoks një dritë të brendshme që as dhuna, as varfëria, as harrimi nuk mundën ta shuajnë. Dhe sot, kjo thirrje hyjnore vjen si një konfirmim: Ju, shqiptarë, jeni krijuar për të fluturuar, jo për të zvarritur në baltën e dëshpërimit.

Ati Hyjnor njeht plagët dhe forcën tonë

Papa, si një AT shpirtëror për mbarë njerëzimin, e njëjste shpirtin e popullit tonë, ai e dinte se sa shumë kemi sakrifikuar për lirinë, sa shumë kemi qëndruar në këmbë, edhe kur dukeshim të rrënuar, se zemra

shqiptare nuk dorëzohet lehtë. Prandaj, thirrja e tij nuk ishte një ftesë për arratisje nga vështirësitë, por një thirrje për një ringjallje morale, një ngjijtje shpirtërore, një rindërtim të shpresës.

Në një kohë kur shumë kombe përkulen para tundimeve të humbjes së identitetit, ATI me shpirtin e madh dhe të dëlirë na këshilloi: “Ruani dritën tuaj, ruani shpirtin tuaj, ruani veten tuaj!”. Drita, nuk është abstrakte, ajo është vetë realiteti që mund të ndërtojme: një Shqipëri më të drejtë, një shoqëri më njerëzore, një komb që nuk mbijeton thjesht, por lulëzon në dinjitet dhe bashkim.

Drita është në trimërinë për të mbrojtur të vërtetën, në urtësinë për të ndërtuar paqe, në forcën për të hedhur tutje korrupsionin, padrejtësinë, ndarjet e kota.

Drita është në fuqinë tonë për të kthyer besimin tek njëri-tjetri, për të kthyer Shqipërinë në një tokë ku e ardhmja nuk shihet me frikë, por me krenari.

Një thirrje për secilin prej nesh

“Fluturoni drejt dritës” është një urdhër për të gjithë: nga fëmijët që sapo mësojnë për flamurin e tyre, tek të rinjtë që kërkojnë rrugën e tyre në këtë botë të trazuar; nga punëtorët e thjeshtë që mbajnë në supe jetën e përditshme, tek intelektualët që kanë misionin të ndriçojnë mendjet.

Është një thirrje që kërkon përgjigje me vepra, jo me fjalë: Të ngrihemi mbi vetveten, të mos i lejojmë plagët e historisë të na robërojnë shpirtin. Të mos jetojmë me mendjen në ikje, por me zemrën në ndërtim.

Fjalët që bëhen amanet

Le ta dëgjojmë këtë thirrje, jo si një kalimtar i zakonshëm që kalon rrugës dhe nuk ndalet. Le ta mbajmë në zemër, si një amanet që e lëmë trashëgim brezave të ardhshëm; Shqiptarë, fluturoni drejt dritës! Lart! Me krenarinë e të parëve tanë që e deshën këtë tokë deri në fund. Lart! Me forcën që vetëm një popull si yni mund të ketë. Drita është atje ku duam të shkojmë. Është ajo për të cilën ia vlen të jetojmë, të luftojmë, të ndërtojmë.

Dritë mbi plagët tona

Prej shekujsh, kombi ynë është bërë dëshmitar dhe pjesëmarrës në betejën mes errësirës dhe dritës. Nga luftërat për liri, tek përpjekjet për mbijetesë dhe ndërtim, shqiptarët kurrë nuk e kanë humbur besimin në dritën e shpresës, edhe kur retë e zeza kanë mbuluar qiellin.

Papa e njeh këtë histori. Ai na njeh si një popull që ka duruar më shumë se ç'mund të përshkruhet, por që kurrë nuk është dorëzuar.

Fjalët e tij janë një refleksion i njohjes së kësaj force: një thirrje për ta ngritur këtë shpirt të palodhur, këtë karakter të çeliktë, në një nivel të ri — në fluturim drejt dritës.

Mesazhi si amanet

“Fluturoni drejt dritës” nuk është një fjalë metaforike. Nuk është një ndjesë kalimtare. Është një mision. Një përkushtim për të lënë pas pesimizmin, dëshpërimin, ndasitë boshe, dhe për të ndërtuar një shoqëri ku drita të jetë drejtësia, ndershmëria, dashuria për atdheun dhe vëllazëria mes shqiptarëve.

Drita është vetë Shqipëria që duam të shohim: një vend ku dinjiteti njerëzor respektohet, ku puna vlerësohet, ku besimi në të ardhmen nuk është ëndërr, por realitet. Kush nuk fluturon drejt dritës, do të fundoset në errësirë. Ne nuk mund të mbetemi asnjëherë.

Detyra e brezit tonë

Sot, brezi ynë është përballë një sfide historike. Jo më betejat klasike të pushkës dhe gjakut, por beteja më e vështirë: ajo e karakterit, e ndërtimit, e bashkimit.

Të fluturosh drejt dritës do të thotë të mos i nënshtrohesh korrupsionit që helmon shpirtin, të mos pranosh varfërinë shpirtërore që shuan idealet, të mos përkulesh para padrejtësive.

Fluturimi drejt dritës fillon me ndërrimin e mendësisë: nga fatalizmi në optimizëm; nga ndarja në bashkim; nga shkatërrimi në ndërtim. Kjo është epoka që na thërret të mos jemi thjesht dëshmitarë, por protagonistë të një rilindjeje kombëtare.

Në këto kohë kur bota endet mes trazirash shpirtërore dhe përpjekjesh të ethshme për drejtësi, një thirrje e fuqishme mbërriti deri në ne, shqiptarëve: “Fluturoni drejt dritës!”. Ishte zëri i Papës, një zë që nuk njeh mure, që tejkalon gjuhë, kombe dhe histori, për të prekur shpirtin e njerëzimit.

Por mbi të gjitha, ishte një thirrje drejtuar një populli që ka ditur të jetojë, të vuajë dhe të shpresojë

në heshtje – shqiptarëve.

Ishte një ftesë hyjnore për të mos harruar kurrë rrënjët, për të mos lejuar që era e së keqes të shkulte farën e së mirës që ndodhet në ne.

Papa na shihte jo si viktimë të historisë, por si bij të dritës, si mbartës të një misioni të shenjtë: të ecim përpara, të ndriçojmë, të rilindim.

Emocioni i një kombi

Kur shqiptari dëgjoji këtë thirrje, zemra e tij njohu veten. Në këto fjalë u pasqyrua gjithë rruga jonë e mundimshme: nga trimëria e maleve të lirisë, nga këngët që kanë mbajtur gjallë shpirtin në errësirat e pushtimeve, nga lotët e nënave që mbështeteshin tek shpresa për një të nesërme më të ndritur.

Ne jemi populli që kemi ecur nën hijen e perandorive dhe sërish kemi ngulur këmbë në trojet tona.

Ne jemi ata që, edhe kur bota na harroi, ruajtëm në gjoks tonë flakën e besimit. Një pasqyrë e shpirtit tonë: një shpirt që nuk pranon të mbetet rob i së kaluarës, një shpirt që kërkon të ngjitet lart, drejt burimit të jetës – dritës. “Fluturoni drejt dritës!”, nuk është një këshillë për të ikur nga vështirësitë, është një thirrje për ta përballuar realitetin me forcë, për të ndërtuar një shoqëri që mbështetet mbi vlera të vërteta: mbi dashurinë për jetën, mbi respektin për tjetrin, mbi ndershmërinë dhe besimin; Një thirrje, për të mos mbetur peng i errësirës së historisë sonë të përgjakshme, të mos biem pre e pesimizmit, të mos dorëzohemi para sfidave.

Drita si qëllim dhe rrugë

Drita, fillon tek ne – në familjet tona, në arsim, në respektin për ligjin, në mbrojtjen e së vërtetës, në mbështetjen e më të dobët. Ajo është në fjalën e ndershme, në veprën e mirë, në besimin se një popull mund të ndërtojë të ardhmen e tij pa u dorëzuar para errësirës së korrupsionit, urrejtjes, ndarjes dhe mungesës së shpresës.

Shqiptarë, kjo thirrje është një dhuratë, por edhe sfida. Ajo na ngarkon me një përgjegjësi të shenjtë: të mos harrojmë se mbi ne ndriçon një dritë e veçantë, që ka lindur nga vuajtjet dhe që kërkon të shndërrohet në bekim.

Tani është koha jonë. Tani është momenti të zgjohemi nga letargjia, të shkundim pluhurin e të kaluarës dhe të fluturojmë lart, drejt asaj drite që Papa e sheh si fatin tonë.

Një thirrje që mbetet

Le të mos jetë kjo thirrje një kujtim i bukur që shuhet me kalimin e kohës. Le të bëhet ajo flamuri ynë i përditshëm, ftesa që na zgjon çdo mëngjes, besimi që na udhëheq në çdo hap.

Nëse çdo shqiptar zgjedh të fluturojë drejt dritës, atëherë drita nuk do të jetë një realitet i ndritshëm për ne, për fëmijët tanë, për të gjithë brezat që do të vijnë.

‘Shqiptarë, fluturoni drejt dritës! Jo vetëm sepse është një thirrje hyjnore, por sepse është thirrja e zemrës sonë të përjetshme!’.

Guximi për të vazhduar: Zemra që Rreh në Uniformë



ARDHMEN

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

“Suksesi nuk është kurrë përfundimtar, dështimi nuk është kurrë fatal. Është guximi për të vazhduar ajo që ka rëndësi.”

Këto fjalë, që i atribuohen Winston Churchill-it, mbartin në vetvete një filozofi që shkon përtej fjalës së bukur, ato përmbledhin esencën e qëndrueshmërisë njerëzore, por edhe më tej, përshkruajnë me përpikëri karakterin e një ushtaraku të vërtetë.

Me këtë reflektim të thellë mbi vlerat që mbartin uniforma, flamuri dhe përkushtimi ndaj Atdheut, dua

të ndaj një mesazh që ndriçon rrugëtimin tonë si Forca të Armatosura të Shqipërisë, guximi për të vazhduar është arma jonë më e fortë.

**Suksesi nuk është kurrë fundi,
ai është fillimi i një detyre të re**

Në karrierën ushtarake, shpërblimi më i madh nuk është medalja, grada apo duartrokkitja, është besimi që fitojmë nga populli ynë. Sukseset tona janë të rëndësishme, por ato nuk na japin të drejtën për të ndalur. Ato janë momente reflektimi, ringritjeje dhe përgatitjeje për sfidat që vijnë. Kurrë më shumë se sot, kur siguria kombëtare ndikohet nga dinamika globale, nga teknologjia dhe nga rreziqe të reja, nuk mund të

qëndrojmë mbi lavdinë e djeshme.

Në misionet paqeruajtëse, në ndihmën ndaj komunitetit gjatë fatkeqësive natyrore, apo në ruajtjen e sovranitetit në çdo cep të territorit, çdo sukses është një etapë.

Në nuk kemi luksin të themi “mbaruam”. Misioni ynë është vazhdimësi. Ashtu si një rojë që s’e lëshon kurrë postën, një ushtarak i vërtetë nuk pushon kurrë së shërbyeri, edhe kur lavdia është në kulm.

Dështimi, mësimi që forcon trupin dhe mendjen

Në çdo proces zhvillimi ka pengesa. Ka dështime. Por dështimi nuk është turp. Ai është një fazë e domosdoshme në formimin e karakterit ushtarak dhe njerëzor.

Nëse do të kishim frikë nga dështimi, nuk do të guxonim të ndërmerrim asgjë. Dhe pa guxim, nuk ka përparim. Në trajnimet intensive, në ushtrimet me partnerët ndërkombëtarë, në momentet e krizave reale janë pikërisht ato gabime që bëhen shkëndija të përmirësimit. Një pajisje që dështon, një vendim i nxituar në komandë, një reagim që vonon të gjitha analizohen jo për të gjetur fajtorin, por për të forcur sistemin.

Ushtria shqiptare ka kaluar dekada transformimi, duke u ngritur nga një e kaluar e rëndë drejt një të ardhmeje të standardeve euroatlantike. Gabimet e së shkuarës janë shndërruar në mësimë që na ndihmojnë sot të jemi më të disiplinuar, më të arsimuar, më të përgatitur. Dështimi nuk është fatal ai është i nevojshëm.

Guximi për të vazhduar, misioni që na bashkon

Nuk është vetëm trajnim fizik. Nuk është vetëm njohuri taktike. Është diçka më e thellë, është guximi që duhet të shtyjë përpara, kur forcat duket se tradhtojnë. Ky guxim shfaqet te rekrutët që lënë familjet për të shërbyer në një mjedis të panjohur. Shfaqet te komandantët që mbajnë mbi supe përgjegjësi të mëdha për jetën dhe moralin e vartësve të tyre. Është te pilotët që fluturojnë mbi territore të vështira, te zjarrfikësit ushtarakë që hyjnë në flakë, te infermierët e Forcave të Armatosura që u shërbejnë civilëve në kohë pandemie. Ky guxim nuk është thjesht ndjenjë, është identitet. Guximi për të vazhduar nuk kërkon që të mos ndjesh lodhje apo frikë. Përkundrazi, kërkon që ta pranosh dobësinë, por të mos dorëzohesh. Në këtë kontekst, forca e ushtarakut shqiptar nuk është muskulore është shpirtërore.

Historia e Kombit, një mozaik i guximit të vazhdueshëm

Shqipëria ka një histori të mbushur me përballje. Nga luftërat për liri e deri te paqeruajtjet në shekullin XXI, ne kemi treguar se populli shqiptar nuk ndalet përballë sfidave.

Ushtria ka qenë gjithmonë në ballë, në Luftën Nacionalçlirimtare, në periudhat e tranzicionit, në

misionet në Afganistan, Irak, Bosnje, Kosovë, Malin e Zi, Letoni.

Në çdo faqe të historisë sonë, shfaqet një formë e guximit, guximi për të mbijetuar, për të ndërtuar nga e para, për të ecur përpara edhe kur rruga është e errët. E sot, në kohën e integritit euroatlantik, ky guxim merr formë të reja, inovacion, dijeni, partneritet, përkushtim ndaj paqes dhe stabilitetit. Ushtria jonë, më shumë se një forcë ushtarake, është garant i vlerave kombëtare. Dhe këto vlera mbijetojnë vetëm nëpërmjet guximit për të mos u dorëzuar kurrë. Më shumë se një detyrë, është një betim jetësor.

Kur një i ri apo e re vesh për herë të parë uniformën, nuk merr thjesht një vend pune. Ai merr një mision për jetë. Shërbimi ushtarak është një rrugëtim që ndryshon individin. Ai e bën më të disiplinuar, më të vetëdijshëm për përgjegjësinë qytetare dhe më të lidhur me kombin. Por më e rëndësishmja, i mëson se suksesi dhe dështimi janë kalimtarë, ndërsa guximi për të vazhduar është thelbi i çdo triumfi. Për këtë arsye, nuk ndalen stërvitjet edhe kur duket se janë të përgatitur, nuk pushojnë së përmirësuar, edhe kur vlerësohen si shembull nga partnerët tanë në NATO. Sepse e dinë, sot është vetëm një hap drejt sfidës së nesërme.

Një thirrje për brezat e ardhshëm

Të rinj të dashur: mos kini frikë nga sfidat, zgjidhni guximin për të vazhduar në jetë, në karrierë, në atdhedashuri. Ushtria është një shkollë karakteri, një komunitet nderi dhe një familje që nuk të braktis kurrë.

Dhe për të gjithë ata që sot mbajnë uniformën, mos harroni kurrë pse e nisët këtë rrugë. Le të na udhëheqë gjithmonë guximi për të vazhduar përpara, sepse ky guxim është ai që ndërton paqen, mbron sovranitetin dhe mban lart dinjitetin tonë kombëtar.





TË JESH GRUA:

Mes detyrës, identitetit dhe sakrificës

Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

Në mjedisin ushtarak, roli i gruas ka evoluar ndjeshëm vitet e fundit. Ajo ballafaqohet me pritshmëri të larta profesionale, ndërthurur me përgjegjësi shoqërore dhe familjare.

Profesionalizmi dhe aftësia operationale

Gratë ushtarake ndjekin programe intensive stërvitjeje, të barabarta me homologët meshkuj, nga disiplinimi personal deri te aftësitë taktike dhe komandimi në situata të vështira.

Ato kontribuojnë në sferën e komunikimit, inteligjencës, logjistikës, mjekësisë dhe inxhinierisë. Prezenca e tyre sjell perspektiva të reja dhe qasje inovative ndaj zgjidhjes së problemeve.

Sot, gratë marrin pjesë në njësi operationale frontale, në stacione komanduese dhe në misione ndërkombëtare – provë e aftësisë dhe besimit që ushtria ka te profesionaliteti i tyre.

Sfidat institucionale dhe stereotipat sociale

Përballja me stereotipa: Në një kulturë ku imazhi tradicional i luftëtarit është mashkull, gratë shpesh sfidohen për të dëshmuar forcën dhe kompetencën.

Megjithëse politika institucionale synon barazinë,

në praktikë mund të ketë dallime në trajtim, nganjëherë të pavetëdijshme, si në vlerësim performancash, kryerjen e detyrave jashtë zyrës, apo në ndërveprim me kolegë meshkuj.

Shumë gra përballen me barrën e pritshmërive familjare, kujdesi për fëmijët, prindërimi, menaxhimi i shtëpisë, ndërsa përpiqen për t'u përfshirë në misione të largëta e të kërkuara. Kjo sfidë kërkon mbështetje institucionale (si lehtësira për kujdesin e fëmijëve, fleksibilitet në orare etj.), që tashmë po ndërtohet gradualisht.

Kontributi institucional dhe vlera e identitetit femëror

Liderizmi dhe empatia: Gratë shpesh sjellin një qasje të fortë bashkëpunuese, empati dhe menaxhim emocional, cilësi kyçe për mirëqenien e trupave dhe ngacmimin e stresit në një ambient të tensionuar ushtarak.

Modele për brezat e ardhshëm: Rolet e tyre frymëzuese, zëra të guximshëm që sfidojnë status quonë dhe ngrihen në pozicione komanduese ndikojnë që gratë e reja (dhe jo vetëm) të ndjejnë se mund të arrijnë kudo brenda institucionit.

Diversiteti si avantazh strategjik: Një ushtri që përfshin të gjitha potencialet pa marrë parasysh gjininë, bëhet më elastike, më efektive dhe më e përfaqësuar. Diversiteti promovon kreativitet, aftësi adaptimi dhe fuqinë e inovacionit në fushëbetejë dhe ndjeshmërisë që kujdeset për kolegët; të qëndrosh patriotë e përkushtuar ndaj vendit, ndërsa kujdesesh edhe për familjen.

Çdo ditë, gratë në uniformë janë dëshmi e përmirësimit institucional dhe emancipimit profesional. Por, për t'ua shfrytëzuar plotësisht potencialin e tyre, është e nevojshme të sigurohen politika mbështetëse: trajnim i balancuar, mbështetje për prindërit, vlerësim i drejtpërdrejtë dhe qasje neutrale ndaj karrierës.

Ushtria, me vlerat e saj tradicionale por edhe orientimin drejt modernes, ka një shans historik: të bëhet tipari lider i barazisë gjinore në institucionet e sigurisë. Në këtë rrugëtim, përfshirja e plotë dhe kontributi i grave nuk është vetëm e drejtë është strategjike.

Gra shqiptare që kanë lënë gjurmë:

Shote Galica (1895–1927) – Heroina e kombit

Një nga figurat më të njohura të rezistencës shqiptare kundër pushtuesve serbë në Kosovë. Luftoi krah burrit të saj, Azem Galica, dhe mbrojti idealet e lirisë me armë në dorë. Shembull i guximit, vendosmërisë dhe atdhedashurisë.

Musine Kokalari (1917–1983) – Shkrimtare dhe disidente

Gruaja e parë shqiptare që botoi një libër në gjuhën shqipe. U persekutua nga regjimi komunist për bindjet e saj demokratike. Një simbol i intelektit dhe kurajës morale.

Nexhmije Pagarusha (1933–2020) – Bilbili i Kosovës

Këngëtare legjendare shqiptare me karrierë të pasur në muzikën tradicionale dhe moderne. Vokali i saj e bëri ikonë të artit shqiptar për dekada.

Margarita Tutulani (1925–1943)

– Dëshmore antifashiste

E pushkatuar nga fashistët italianë në moshën 18-vjeçare, për aktivitetin e saj antifashist. Ajo dhe vëllai i saj janë kthyer në simbol të qëndresës së rinisë shqiptare ndaj pushtimit.

Liri Gega (1917–1956) – Politikanja e parë shqiptare

Gruaja e parë që u zgjodh deputete në Kuvendin Popullor. Ishte një ndër figurat themelore të Partisë Komuniste, por u eliminua nga regjimi për qëndrimet e saj. Një figurë komplekse, por me ndikim të thellë në politikën shqiptare të pasluftës.

Tefta Tashko Koço (1910–1947)

– Ikonë e muzikës shqiptare

Një nga këngëtarët më të njohura të muzikës së lehtë dhe lirike shqiptare. Ajo modernizoi këngën

qytetare dhe solli dinjitet në artin skenik.

Eleni Qirici (Shek. XIX) – Mësuese dhe veprimtare e arsimit

Ndihmoi në hapjen e shkollave shqipe në Korçë dhe punoi për edukimin e vajzave. Një figurë e hershme e emancipimit përmes dijes.

Gra si Fehime Selimi, Xhevë Krasniqi-Mentori, Safete Juka dhe shumë të tjera që morën pjesë aktive në luftën për çlirimin e Kosovës, si pjesë e UÇK-së, si mjeke, logjistike apo luftëtare.

Këto gra përfaqësojnë guximin, mençurinë dhe përkushtimin e grave shqiptare në periudha dhe fusha të ndryshme.

Gratë shqiptare si pjesë e transformimeve politike

Transformimet politike në Shqipëri, sidomos pas rënies së regjimit komunist në fillim të viteve '90, shënuan një periudhë të re për gjithë shoqërinë, përfshirë edhe gratë. Nga një shoqëri ku roli i grave ishte shpesh i kufizuar në sfera të caktuara, u hapën gradualisht mundësi të reja për përfshirjen e tyre në jetën publike dhe politike.

Roli gjatë regjimit komunist

Gjatë komunizmit, gratë u inkurajuan të punonin jashtë shtëpisë dhe të merrnin pjesë në jetën politike, të paktën në mënyrë formale. Ato përfshiheshin në organizata si Fronti Demokratik apo Bashkimi i Gruas, por pozicionet e tyre shpesh ishin të kontrolluara nga partia dhe nuk kishin ndikim të pavarur real.

Pas viteve '90: sfida dhe mundësi

Me kalimin në sistemin demokratik, shumë struktura u shembën dhe roli i grave në politikë u vendos sërish në pikëpyetje. Gratë u përballën me sfida të reja: varfëri, papunësi, mungesë përfaqësimi dhe stereotipa të trashëguar. Megjithatë, kjo periudhë solli edhe mundësi të reja për organizim civil, pjesëmarrje në parti politike dhe angazhim në media dhe institucione publike.

Përfaqësimi në institucionet politike

Gjatë dekadave të fundit ka pasur rritje të qëndrueshme të numrit të grave në Parlament dhe në pozita vendimmarrëse. Kuota gjinore ka ndihmuar në rritjen e përfaqësimit, por sfidat mbeten në cilësinë e përfshirjes dhe ndikimin real në politikat publike.

Shoqëria civile dhe aktivizmi

Gratë shqiptare kanë qenë shumë aktive në shoqërinë civile, veçanërisht në çështjet e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe dhunës në familje. Organizatat joqeveritare të udhëhequra nga gra kanë pasur ndikim të rëndësishëm në procesin e demokratizimit dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Sot dhe në të ardhmen

Sot, gratë shqiptare janë gjithnjë e më të pranishme në politikë, por përfshirja e tyre duhet të jetë më e thellë dhe më e barabartë. Barazia gjinore nuk është vetëm një çështje përfaqësimi numerik, por edhe e ndryshimit të kulturës politike, ku zëri dhe perspektiva e grave respektohen dhe ndikojnë realisht.

Orkestra e Ushtrisë Shqiptare: Diplomaci në SKENË, magji mbi det

Muzika shqiptare ngjitet në skenat ndërkombëtare dhe rikthehet me magji mbi nëndetësen historike 105.

Përgjatë vitit 2025, Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura ka dëshmuar se arti është një mjet i fuqishëm diplomacie dhe identiteti kombëtar. Muzikantët shqiptarë kanë përfaqësuar vendin me dinjitet në Francë, ndërsa në brigjet e Pashalimanit kanë sjellë një performancë unike që ndërthur historinë ushtarake me fuqinë e tingullit simfonik.

- Kuinteti “VIVO” debutoi në Festivalin Ndërkombëtar Eurochestries, duke u bërë formacioni i parë

shqiptar pjesëmarrës në këtë ngjarje prestigjioze.

- Kuarteti “TOGHA” solli muzikën dhe këngët popullore shqiptare në Festivalin “Périgord Noir”, ku Shqipëria ishte vend i nderit.

- Në Pashaliman, mbi nëndetësen 105, OSFA interpretoi veprën “Ritfolk”, duke krijuar një atmosferë të rrallë mes tingujve dhe historisë.

Ky sukses i jashtëzakonshëm dëshmon se muzika shqiptare ka zë, ka shpirt dhe është e gatshme të flasë me botën, duke e vendosur Forcën e Armatosur në një rol të ri, mbrojtëse të sigurisë, trashëgimisë dhe kulturës kombëtare.







GJENERAL MAJOR, PROF. DR. KOSTAQ KAROLI

Gjurmë të një gjenerali dhe profesori ushtarak

Prof. Asoc. Dr. **BERNARD ZOTAJ**
MJESHTËR I MADH

Kujtojmë komandantin e shquar dhe mendimtarin ushtarak që la pas një trashëgimi të paçmueshme në fushën ushtarake dhe akademike, Kostaq Karoli gjeneral, prof. dr. Ai ishte një figurë që ndërthurte vlerat e drejtuesit të patundur me pasionin për mësimdhënie dhe edukimin e kuadrit të lartë të Forcave të Armatosura. Ka lindur më 14 dhjetor 1945, në Korçë, por u rrit në fisin e qytetarisë dhe të patriotizmit të Karolëve në Elbasan dhe shërbeu për shumë vite në Tiranë ku dhe ndërroi jetë, më 28 prill 2025.

Nisi mësimet ushtarake në vitet 1959-1963 në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej”, dhe i vijoi studimet ushtarake në vitet 1963-1965 në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”. Ndërsa në vitet 1975-1977 ndoqi studimet akademike në Akademinë e Mbrojtjes “Mehmet Shehu” dhe në vitin 1986 përfundoi kursin e Shtatmadhorisë. Ndoqi kurse të ndryshme kualifikimi ushtarak dhe dha provime për matematikë, psikologji, për problemet e stërvitjes, të historisë ushtarake etj. Pas gradave shkencore “Kandidat i shkencave”, “Docent” dhe “Doktor” fitoi titullin akademik “Profesor”, për të shërbyer gjatë gjithë karrierës së tij profesionale me një performancë të admirueshme që kompletohej pareshtur në vite.

Në karrierën e tij të gjatë si ushtarak i lartë, ai shërbeu me dinjitet dhe përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj Atdheut. E nisi karrierën ushtarake si komandant toge për të vijuar pedagog në shkollat ushtarake i profilizuar në përgatitjen dhe drejtimin e zjarrit në katedrën e zjarrit. Për këtë përgatiti dhe mbrojti drejtimin e zjarrit të nënrepartëve të këmbësorisë (mitraljere) në luftim, i cili u bë një tekst bazë në shkollat ushtarake. Më tej vijoi studimet në lëndën e gjeografisë ushtarake, ku për disa vite ka drejtuar njësi ushtarake si brigadë të këmbësorisë dhe për shumë vite komandant në Akademinë Ushtarake të FA-së.

Njëkohësisht, si profesor në fushën ushtarake, ai frymëzoi gjenerata të tëra oficerësh, studentë dhe akademistë me vizionin e tij strategjik, me ndershmërinë dhe me thellësinë e analizave të tij. Përmendim kontributet akademike, librat që ka shkruar, leksionet frymëzuese dhe pozicionet e detyrave që ka mbajtur në institucione arsimore ushtarake të vendit. Në vitin 1984 mbrojti në Akademinë e Mbrojtjes doktoratën me temë “Luftimi mësymës natën”. Më tej ai ka bërë një sërë punimesh shkencore si “Ushtrimet e qitjes me armët e këmbësorisë” tekst mësimor (1976), “Batalioni artmitralier në mbrojtje” (1997), “Bazimi teorik i kërkesës për të siguruar

dendësinë e nevojshme të plumbave për metër linear para transhesë së parë të mbrojtjes” (1977), “Luftimi mësymës natën” (1979), “Drejtimi i zjarrit të nënrepartëve të këmbësorisë e mitraljere në luftim” (1984), si dhe ka qenë bashkautor i mjaft botimeve ushtarake si “Arti Ushtarak i Luftës Popullore” (1975), “Rregullorja e BrK” (1986), “Doktrina e FT” (2004) etj.

Ka realizuar studimet: “Mbi ndikimin e fortifikimit të mbrojtjes në veprimet mësymëse të forcave tona” (1988), “Mbi suprimimin e strukturës së Divizionit dhe krijimin e Brigadave në Forcat Tokësore. Dislokimi dhe problemet që dalin” (2000), “Mbi përqendrimin dhe heqjen e grup-depove të armatim-municionit në Forcat Tokësore, nevojat dhe frytshmëria ekonomike” (2003), “Mbi nevojat e vendosjes së medaljeve në FA, llojshmëria, klasifikimi dhe paraqitja e tyre” (2005), etj.

Për dhjetë vite rresht ka qenë kryetar i Këshillit Shkencor të Akademisë së Mbrojtjes, anëtar i komisionit të Lartë të Atestimit pranë Këshillit të Ministrave, anëtar i Këshillit të Botimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, anëtar i kolegjiut të Revistës “Mbrojtja”, anëtar i bordit të Revistës Ushtarake pranë Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe anëtar në redaksinë e përgjithshme të Fjalorit Enciklopedik Ushtarak Shqiptar, etj.

Gjatë periudhës si kryetar i këshillit shkencor të Akademisë, ka qenë 50 herë kryetar jurie për mbrojtjen e disertacioneve, si dhe ka drejtuar punën për përgatitjen e historikëve të Brigadave Sulmuese, të Fjalorëve të Terminologjisë dhe të Historisë së Artit Ushtarak të popullit shqiptar nga lashtësia deri në vitin 1944.

Profesor Kostaq Karoli ka përgatitur dhe një numër metodikash të niveleve korpus, divizion, brigadë, të llojeve të ndryshme të operacioneve, luftimeve për përdorim të procesit mësimor në Akademinë e Mbrojtjes. Ai ka qenë bashkautor në mjaft dispensa, leksione mësimore dhe materiale teorike. Ai ka përgatitur dhe mbajtur konferenca brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me referate e kumtesa për probleme të sigurisë, të historisë dhe të mbrojtjes.

Të tilla kanë qenë konferenca e shefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve anëtare të KSBE (OSBE) në Vjenë në tetor 2001, duke referuar “Reforma në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Në revistën “NATO nations and partners for peace” në vitet 2004-2005-2006 ka botuar artikuj studimorë për ushtrinë shqiptare. Ai ka qenë në krye të punëve për përgatitjen e projekteve studimore, mikrotezave të mjaft

pjesëmarrësve në programet e ndryshme që janë zhvilluar në Akademinë e Mbrojtjes.

Ka udhëhequr mbrojtjen e “doktoraturës” të tetë kandidatëve për gradën shkencore “Doktor”. Ka përgatitur me dhjetëra recensa, oponenca dhe artikuj studimorë për probleme të ushtrisë, duke i botuar në revista ushtarake, zëra për Fjalorin Enciklopedik shqiptar, si dhe filma për procesin mësimor në akademinë ushtarake, etj.

Gjeneral Kostaq Karoli, u bë një figurë e njohur dhe e nderuar në historinë moderne të ushtrisë shqiptare. Në rrugëtimin e tij, me pasionin që e kishte cilësinë kryesore, me përkushtim ai ndërtoi karrierë të gjatë në shërbim e mbrojtjes së vendit. Kudo u diplomua me rezultate të larta në institucionet ushtarake, bëri dhe ndoqi trajnime të shumta ushtarake në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë. E përfaqësoi Shqipërinë denjësisht me nder në çdo detyrë që iu besua, deri në detyrën madhore ushtarake të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, një kohë kur ndërroreshin dy sisteme. Falë horizontit të tij ushtarak, përpjekjeve të vazhdueshme në hierarkinë ushtarake, qëndroi stoik në poste të rëndësishme drejtimi, duke dhënë një kontribut të veçantë në proceset e reformimit dhe profesionalizimit të Forcave të Armatosura pas viteve '90 të shek. XX, sidomos në hartimin e ligjeve për depolitizimin e FA, rivendosjen e gradave ushtarake, të statusit të ushtarakut, krijimin e organizimit të policisë ushtarake, rivendosjen e marrëdhënieve me ushtritë e vendeve anëtare e partnere të NATO-s, etj.

Gjenerali ishte njeri me dimensione të mëdha, mishëroi figurën e një oficerit të përkushtuar, të drejtuesit të drejtë dhe të qytetarit të ndershëm. Gjatë gjithë jetës së tij, tregoi mençuri, frymëzoi dhe kontribui për ushtrinë. Ai shkroi në shtypin ushtarak dhe të kohës mjaft artikuj me vlera dhe tregoi punën vetëmohuese të një ushtrie që përgatitej për mbrojtjen e Atdheut. Gjurmë kanë lënë mjaft artikuj analiza për FA si “10 korriku i zhveshur nga akuzat dhe aureolat, zona verilindore, përparësi kryesore e Shtabit të Përgjithshëm”. Forcat Tokësore të vetëdijshme për misionin e tyre, Transformimi i Forcave Tokësore, domosdoshmëri imperative, Ja përse u shkatërrua ushtria në mars '97, Të përkushtuar për zgjerimin e kapaciteteve operacionale, “Unë, gjenerali i 17 ministrave të Mbrojtjes”, “Ushtria, si u përball me provokimet në fillim të tranzicionit”, “Ju rrëfej fuqinë e ushtrisë shqiptare”, “E vërteta e 176 mijë bunkerëve të Luftës së Ftohtë,

Fortifikimi, ja pse u ndërtuan 176 mijë bunkerë”, “Konflikti i armatosur, gati 300 mijë ushtarë për 24 orë” ... libri “Kujtime” i Alfred Moisiut, sintezë e gjallë ..., “Ju rrëfej ushtrinë, si u armatosën 127 brigada e mobilizoheshin, 750 mijë” ..., “Bunkeri ishte i ushtrisë, Enveri nuk kishte zyrë”, etj.

Guximi i tij në fushën e stërvitjes dhe urtësia e tij në auditor kanë lënë një gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e të gjithë atyre që e njohën dhe mësuan prej tij. Përkushtimi i tij ndaj idealeve të lirisë, drejtësisë dhe edukimit do të mbetet një shembull i ndritshëm për brezat e ardhshëm.

Gjenerali shërbeu dhe kontribui me përkushtim të pasqorë, me profesionalizëm të rrallë dhe integritet të palëkundur. Ai punoi e shërbeu me dinjitet për dekada në mbrojtje të atdheut dhe në forcimin e kapaciteteve ushtarake të FA-së.

Prof. Kostaq Karoli ishte një njeri me dimensione kombëtare, demonstroi kudo figurën e oficerit të përkushtuar dhe të shkencëtarit serioz, të drejtuesit të drejtë dhe të qytetarit të ndershëm dhe atdhetarit të përkushtuar. Në të gjithë karrierën e tij ushtarake, por dhe në jetë drejtoi me mençuri, frymëzoi kudo me shembullin e tij, kontribui pa kursim në ndërtimin e një ushtrie të kohës, të përgatitur dhe të përkushtuar për misionin kushtetues. Gjeneral Kostaq Karoli ishte i respektuar kudo në FA, por dhe në shoqërinë civile, sepse ai në jetë nuk u paraqit vetëm si një figurë ushtarake, por u paraqit si edukator dhe mësues i brezave të rinj, mik i sinqertë dhe njeri që gjithmonë vendoste atdhetarizmin mbi gjithçka tjetër.


Nga çdo vështrim politik e ushtarak, ai kishte përparësi për detyrat e rëndësishme dhe të njëpasnjëshme deri në fund të karrierës së tij. Në krah iu gjend me një përkushtim dhe përsosmëri, një nga ushtaraket e para shqiptare, Drita Prifti, e cila i qëndroi si bashkëshorte model në të gjitha detyrat e ngarkuara, si kolege dhe bashkëluftëtare e jetës.

I njohur për qetësinë në vendimarrje, korrektësinë institucionale dhe aftësinë për të motivuar të tjerët, Gjeneral Karoli mbetet një nga figurat që lanë gjurmë të thella jo vetëm në strukturat e ushtrisë, por edhe në kujtesën e gjithë atyre që e njohën. Për të gjitha këto kontribute të dhuruara ushtrisë dhe populli të tij, ai ngelet një nga gjeneralët e rinj me personalitet dhe virtyte të larta në historinë ushtarake të Shqipërisë, të Atdheut dhe të FA-së.

YJE TË PASHUAR



Meriko Selmanllari



Shqipërie Selmanllari

nënë e bijë për

ATDHE,

**HISTORIA E LAVDISHME
E MERIKO DHE SHQIPËRIE
SELMANLLARIT**



Prof. Asoc. Dr. **BERNARD ZOTAJ**

Gora e lavdisë partizane

Duke studiuar për historinë e dëshmorëve të bashkisë Pogradec u gjenda përpara një historie të ngjashme me historitë dhe trimëritë e gruas shqiptare në shekuj. Meriko e Shqipërie Selmanllari, nënë e bijë u vranë në pragun e shtëpisë nga pushtuesit gjermanë për të mbrojtur nderin dhe dinjitetin e familjes dhe vendit të tyre.

Ngjarja ka ndodhur në fshatin Dolanec në krahinën e Gorës, një krahinë me histori të lashtë, histori që fillon në Maliqin e lashtësisë, e që vijnë më pas me fiset ilirë të shquar të Taulantias. Historia e Gorës është luftarake dhe e lavdishme. Burra dhe gra nga Gora i bëjnë nder historisë kombëtare, me çetat atdhetare në ndihmë të Rilindjes Kombëtare dhe të Pavarësisë së Shqipërisë. Bij të trevës, kapedanë të shquar si Kajo Babieni, Shahin Matraku, Malkë Zvarishti, Ismail Dërdusha etj., i kanë dhënë nder dhe lavdi krahinës. Historitë dhe bëmat e tyre frymëzuan burrat dhe gratë e krahinës në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Gorarët mbushën rreshtat e çetave, batalioneve e brigadave partizane të komanduara nga Heroi i Popullit Teki Kolaneci e komandantë e komisarë, bij e bija të krahinës legjendare.

Në këtë histori të lavdishme të Gorës, në të gjithë kohët, ka ngelur i vetmi dëshnimtar që është Guri i Kamjes, monument i lavdishëm shekullor dhe i përjetshëm i natyrës. Ky gur ka ngelur në shekuj një pikë referuese për shumë ngjarje historike e ndodhi të mëdha. Aty janë mbledhur gorarët dhe kanë marrë vendime historike, janë bërë organizime të mëdha, kanë lidhur besën gorare për t'i bërë ballë të keqes e pushtuesve të huaj, që kanë qenë të shumtë për të pushtuar krahinën me histori të madhe dhe të lavdishme.

Kapedanët që frymëzuan breza

Ismail Dërdusha ishte kapedan çete patriotike në Dërdushë të Gorës. Jeta e tij ka kaluar në punë dhe në luftë për të mbajtur ndezur idetë patriotike e lirisdashëse. Ai kishte bërë emër në Gorë, Opar e Mokër. Ismaili ishte nipi i Kajo Babjenit, një kapedani tjetër i zonës legjendare. Në vitin 1885, në moshën 17 vjeçare, ishte bashkuar me çetat e Kajo Babjenit e Shahin Matrakut. Ishte Ismaili me çetën e tij, që nuk i lejoi xhandarët e administratës osmane të vilnin tatimet në Gorë. Aktin e tij e vlerësoi populli, ndaj e donte dhe e mbronte kapedanin që ishte roje i tij, për të mos i zhvatur si pushtuesi, ashtu dhe bejlerët e agallarët e vendit. Me krijimin e Komitetit të Fshtetë të Manastirit që

kërkonte lirinë e Shqipërisë dhe takimi me kapedanët gorarë, Ismaili u vu në krye të lëvizjes, duke luftuar për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë. Zona e veprimtarisë së luftimeve shtrihej nga Lenia deri në Malin e Thatë. Ai e kishte njoftuar Kajmekamin e Pogradecit, që të mos dërgonte taksambledhësit në fshatrat e Gorës, sepse fshatarët ishin shumë të varfër e s'kishin çfarë të jepnin. Ndaj çdo forcë që do të përdorej, do goditej nga çetat e Gorës.

Në vitin 1911 në Gurin e Kamjes Ismail Dërdusha u ndesh me taksambledhësit e qeverisë, të cilët u detyruan të ktheheshin mbrapsht në Pogradec. Por, po në vitin 1911 në fshatin Pretushë, forcat qeveritare i zunë pritë me xhandarë të shumtë dhe e vranë kapedanin Ismail Dërdushën së bashku me kapedanin tjetër të zonës, Seit Zakoçanin.

Luftëtari Tosun Dërdusha ishte një patriot tjetër nga fisi luftarak Dërdusha. Shtëpia e tij ishte një bazë patriotike. Kështu, në shtëpinë e Tosunit në Dërdushë, në vitin 1907, u mbledhën krerët e Gorës dhe mbajtën një kuvend të kapedanëve të zonës. Fisi Dërdushë historikisht ka mbajtur qëndrim patriotik, në kohën e Rilindjes, të Pavarësisë, të LANÇ-it dhe pas çlirimit. Në këtë fis lindi, u rrit, u edukua dhe aktivistja Meriko Halit Dërdusha, e cila shkoi nuse në fisin Selmanllari në fshatin Dolanec të Gorës.



Trimëria e Merikos dhe Shqipëries ka një dukuri të re, të veçantë dhe të traditës. Meriko ishte edukuar me trimërinë, ishte mbesë e një kapedani të njohur të Gorës, të Ismail Dërdushës, ishte mbesë e gjyshes së saj, Fatime Dërdushës.

Aktivistja e gruas në krahinë

Meriko Selmanllari e lindur në vitin 1902, në Dërdushë, ishte mbesa e kapedan Ismail Dërdushës. Në familjen e burrit, ajo gërshetoi traditat dhe zakonet e familjes Dërdusha me ato të familjes Selmanllari. Meriko u bë një veprimtare e shquar gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, e ktheu shtëpinë e saj në bazë të luftëtarëve të lirisë.

Ndër gratë aktiviste në Gorë, në periudhën e lëvizjes u shquan Medije Braçe, e cila ishte dhe delegate në Kongresin e Gruas Antifashiste në Berat në nëntor 1944, Fiqirie Kolaneci, aktiviste e shquar e gruas në krahinë, Nënë Pashako, trimëreshë dhe legjendë e gruas gjatë LANÇ-it, Fike Grybeci, anëtare e Organizatës së Gruas Antifashiste në Gorë, si dhe Meriko Selmanllari, aktiviste e gruas në krahinë.

Shqipërie B. Selmanllari ishte e bija e Merikos e lindur në vitin 1926 në fshatin Dolanec. Edhe Shqipëria u aktivizua me lëvizjen, me organizatën e rinisë dhe ka ndihmuar dhe njësitin partizan të fshatit Dolanec.

Historia e tyre është një histori trimërore që është në vazhden e trimëreshave të kohëve, të Shqipëries si të Shote Galicës, të Tringës së Grudës e Tringës së Hotit, të Maro Kondës dhe të Liri Geros, të Sartë Gabaj dhe të Qybra Sokolit etj.

Trimëria e Merikos dhe Shqipëries ka një dukuri të re, të veçantë dhe të traditës. Meriko ishte edukuar me trimërinë, ishte mbesë e një kapedani të njohur të Gorës, të Ismail Dërdushës, ishte mbesë e gjyshes së saj, Fatime Dërdushës.

Historia e Fatimes tregohej si një legjendë. Nëna, si një lajmëtare për bijtë e saj, vërejti se shtëpia e saj po rrethohej nga turqit. I biri Ismaili me luftëtarët e çetës gjendej në shtëpi. Nëna, doli nga tuneli i nëndheshëm, zbuloi pozicionet që kishin zënë turqit, dhe ia tregoi të birit. Kapedani doli nga shtëpia me luftëtarët dhe i shpartalloi turqit.

Historia që ripërtërihet...

Kjo legjendë e ndodhur në fillim të shek. XX, u përsërit në një kohë tjetër, në Luftën e Dytë Botërore. Lufta kishte arritur dhe në fshatin Dolanec. E njëjta histori po përsëritej dhe nga aktivistja Meriko, më 16 qershor 1944. Fshati Dolanec gjendej në qendër të Gorës së Sipërme. Shtëpinë e veprimtares së gruas antifashiste e rrethuan forcat gjermano-balliste. Meriko ishte vetëm me vajzën e saj 18 vjeçare, që i kishte vendosur emrin e atdheut, Shqipërie. E ndodhur me vajzën në shtëpi, nëna u mendua gjatë, gjykoi dhe mori një vendim... Ajo nuk

kishte rrugë tjetër veç t'u kundërvihej armiqve me armët që kishte. Mori një sëpatë të madhe, me qylykë, i dha dhe një sëpatë tjetër Shqipëries dhe i tha:

- Bijë, as ty, as mua, nuk na lejohet të na dhunojnë shtëpinë tonë. Shqiptari kurrë se ka dorëzuar kullën e tij, ndaj do ta mbrojmë me jetën tonë.

Armiqtë po e shqyenin portën. Nëna dhe e bija kishin zënë pozicion me sëpatë në dorë për të goditur... dhe ushtarit, gjermani i parë që hodhi këmbën për të hyrë në kullë, Meriko i lëshoi sëpatën në kokë. Ai ra për tokë e nuk pati kohë të heqë këmbëzën e shkrepjes... Këtë gjë bëri dhe Shqipëria, por gjermani pas tij, me një breshëri sharrësi i rrëzoi të dyja nënë e bijë për tokë.

Kjo ngjarje ishte shumë e shpejtë dhe heroike. Ishin dy femra gorare, ishin dy shqiponja shqiptare që nuk lejuan pushtuesin t'u shkelte pragun e kullës. Heroizmi i tyre është një shembull në pedestalin e lirisë të gruas shqiptare.

Çfarë mund të bënin më tepër se kaq, kjo grua së bashku me vajzën e saj që ishin në kullën e tyre?! Ky ishte një akt i guximit heroik që tregonte se grua shqiptare në luftë shkoi pas rrjedhës dhe traditës së tyre familjare, por dhe të historisë të prejardhjes nga vinte Meriko. Ky ishte një akt që e vendosi gruan luftëtare në vendin që meriton, në vendin e nderit.

Ngjarja e ndodhur në kulmin e operacionit armik të Qershorit të vitit 1944, nuk është rastësore dhe as fati i dy luftëtarëve të lirisë. Akti i tyre është diçka më madhështor dhe i denjë për gruan shqiptare. Familja Selmanllari dhe fshati Dolanec ishin të lidhur ngushtë me luftën. Të dyja, nënë e bijë ishin aktiviste të njohura në zonën e Gorës, ato ishin shquar si luftëtare dhe punonin në çdo kohë dukshëm në favor të Lëvizjes Antifashiste.

Ballistët e dinin dhe i kishin informuar kolegët e tyre gjermanë se në shtëpinë e familjes Selmanllari, ishte bazë e luftës dhe aty do të gjenin gjurmët e aktivitetit të tyre dhe të lëvizjes. Ato u sakrifikuan duke u bërë barrikadë dhe nuk lejuan që pushtuesi të shkelte pragun e kullës së tyre.

Ato u flijuan të dyja për lirinë e Atdheut. Meriko Halit Selmanllari është shpallur dëshmore e Atdheut me vendim nr. 131, datë 16 shtator 1983, të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Pogradecit, ndërsa e bija, Shqipëria ende pret që të shpallet dëshmore e Atdheut.

Për jetën dhe aktin heroik të tyre është shkruar në librin "Gora patriotike" të autorëve Selami Kreka dhe Syrja Jahollari, si dhe në librin "Yje të pashuar" vëllim XX, të autorit Resul Bedo.



HITO KONGOCI -FUSHËBARDHA, TOPÇIU I PARË SHQIPTAR QË SHKROI EPOKË



Prof. Asoc. Dr. **ZAHO GOLEMI**



**“Kush e njeh Hito Fushëbardhë,/Jelekzhveshur, pallëlarë,/Ngrehu
topat e kalanë,/Në kuti ia hodhi zjarrë,/E dogji su dha i gjallë,/**
Në kala, në Koqinovë,/Hito Kongoci me kordhë,/Bën dyfek ruan
sinorë,/Me venedikt e arhonë,..Me junanë e me osmanë,/..”

Hito Kongoci ishte lindur në një truall luftarak dhe patriotik në pranverën e vitit 1810 në Fushëbardhë, por që tokat e fisit të tij të Kongoce ishin përtej qafës së Skërficës në Vërrin. Në Fushëvërrin kanë pasur tokat e tyre edhe shumë fise të tjerë të njohur të Fushëbardhës si: Baho, Kazo, Kuci, Tefa, Shalari, Shkurti, Lagji, Këndezi, Deçka, Bello, Zervoi, Isaraj, Alidhima, Proda, Veliu, Kongoci, Golemi, Memushi, Cama, Rofi, Mullai, Resuli, Muho, etj. Jeta e Hito Muhamet Kongocit ishte një jetë e gdhendur në historinë e luftërave të trevës labe. Familja e oxhakut të Kongocës kishte hauret sikurse gjithë fiset e tjera në Vërrin, edhe pse është vështirë t'i përcaktosh identitetin fshatç. Hito Kongoci del përtej rajonizimit fshatç është më shumë se krahinor, i përket Labërisë, Shqipërisë. Në dekadat që pasuan pas rënies heroike të Hitos, Kongocajt i gjejmë në Fushëbardhë, në Fushëvërrin dhe në Kalasë, por edhe në vende të tjera.

Ishte koha kur pushtuesit osmanë kishin shtrirë sundimin në rajonet fushore e kodrinore dhe që egërsia e tyre në mbledhjen e taksave shkonte deri në rrëmbimin e kafshatës së fundit të bukës nga goja e fshatarëve, për të mbajtur gjallë dhe gjatë sundimin, për mbajtjen e një makinerie shumë të madhe njerëzish në ordunë/ushtrinë osmane. Nga ana tjetër djemuria shqiptare sapo mbushte moshën për rekrutim në asqerllëk/nizamllëk rrëmbehej “me hir e pahir” për të mbushur radhët ushtarake në tre kontinente në rreth 8 milionë km², ku shtriheshin Sulltanati dhe pushtimet osmane. Hito Kongoci u rrit sikurse gjithë moshatarët dhe mes vuajtjeve por dhe taksave të rënda. Babai e gjyshi i tij në linjë stërgjyshërore kishin qenë kundërshtarë të pushtuesve, dhe nuk e njihnin “urtësinë”, kur ia kërkonte puna, edhe pse nga brenda nga zemërimi ishin zjarr përvëlues. Të moçmit thoshin se “rebelimin e kishin në gjak”. Edhe pse e dinin fatin e të qenit “asqer”, Hito nuk iu shmang shërbimit të gjatë të detyrueshëm ushtarak shtatë vjeçar. Bashkë me shokë të fshatit, Labërisë, Delvinës etj., i hipi vaporit “Daut”, që kishte marrë djemuri shqiptare edhe në skelat e Ulqinit, Shkodrës, Shëngjinit, Durrësit e Vlorës. Ishte koha kur nizamllëku i kushtonte shqiptarëve më shumë se 14 mijë djem në vit që kryenin shërbimin në të gjithë anët e Sulltanatit Osman. Kështu vepronin dhe djemtë e Fushëbardhës që i merrnin “nizamë”, (rregull, rend, ligj), i çonin në Delvinë, dhe nga garnizoni i Delvinës grumbulloheshin djemtë që

do bëheshin “asqerllëkun” i çonin në skelën e Sarandës. E kishte edhe kjo “të mirën” e vet dhe kjo e mirë ishte arti më i vështirë në botë që ishte lufta si art shkatërrimi.

Nizamllëku i kishte mësuar e burrëruar, në kufijtë ekstremë të jetës, u kishte mësuar artin luftarak osman, përdorimin e armëve, kamës, thikës, pushkës e deri edhe topat, që e kishin profesion të trashëguar në breza nga tradita luftarake liridashëse. Askush nga djallëria e këtij vendi nuk e harronte anijen që i çonte në “anën tjetër të dynjasë, ku piqet buka në diell”, që i dërgonte në kazemat ushtarake/asqeri këshllasënda, të Portës së Lartë “ajkën e djallërisë” shqiptare, në zbatim të fermanëve famëkeqe, që Sulltanati mbushte radhët ushtarake për të mbajtur pushtetin e pushtimit me zjarr e hekur, por më shumë me gjak. Njerëzit në brigjet shqiptare e quanin pampori i dhimbjes, mallëngjimit e shpresës.

Hito Kongocit dhe disa shokëve të tij i priu “fati”, që pas karantinës të caktuara në “Topçu Denizli” në mbrojtje të kështjellave detare osmane. Këtu mësoi principin e funksionimit të topave dhe mendjen e kishte në vatanin e tij. Vitet kaluan dhe qitapët e njësisë bregdetare i ofruan të qëndronte rrugëtar, por nuk pranoi dhe u kthye i gjallë pas shtatë viteve në vendlindje. Hito Kongoci 25 vjeçar kishte ardhur në kohën kur ziente vendi nga rebelimi dhe kryengritjet shqiptare. Shqiptarët e pritën me përbuzje traktatin e “Gylhanesë” (reformat e Tanzimatit të 1839-ës), që synonte konsolidimin e perandorisë osmane. Askush nuk ishte dakord me reformat e sultan Abdyl Mexhitit, në fushën administrative, financiare, ushtarake e arsimore. Kështu reformat në vend që të qetësonin shqiptarët i hodhën “benzinë zjarrit” dhe kryengritjet u finalizuan më 1847, ndërkohë që Osmanët ishin shtrirë në gjashtë vilajete në Ballkan (në 165 mijë km², ku popullsia e Ballkanit nën pushtim ishte 5.5 milionë banorë).

Hito Kongoci ishte pjesë e të dënuarve për rebelim, por është falur pasi bashkë me kapëdanë të tjerë të Labërisë u bë pjesë e detashmenteve labe që shkuan vullnetarisht si “redifë”/rezervistë për të mbrojtur tokat shqiptare në vilajetin e Shkodrës (sot hapësira administrative e Malit të Zi). Hito Kongoci iu përgjigj thirrjes si redif/rezervist në mbrojtje të truallit arbëror të vilajetit të Shkodrës nën thirrjen: “Vilayet tehlikede”/vilajeti në rrezik!, dhe shkoi bashkë me Zenel Gjolekën, Hodo Ali Nivicën, Gjike Thanasin, Halim Toto Progonati, etj. Trimat e Labërisë filluan luftimet në zonën e Kërnicsës e pastaj u zgjerua



dhe nga krahu i Taraboshit. Luftimet e detashmentit lab në veri kanë ngelur në kujtesën mbarëkombëtare edhe pse aty mbetën përjetësisht në altarin e lirisë si martirë të pavdekshëm të Atdheut. Hito Kongoci edhe pse u plagos dy herë mundi t'u mbijetonte plagëve dhe nuk e dha veten. Ai u bë përsëri i aftë për luftë, por këtë herë për luftë kundër çdo pushtuesi si osmanë edhe andartë që vinin nga deti për zaptimin e trojeve shqiptare në jug. Në kohën që luftohej në veri për tokat shqiptare lindi edhe kënga lapidar e Labërisë: “Përse lufton a derëzi?/ As për mua, as për ti,/Po për gjithë Shqipëri!”. Lufta për mëmëdheun përjetësohej në vargje: “Mëmëdheun nëpër shekuj,/vrrarë e prerë po kurrë vdekur,/ lumenj gjaku për flamur,/ Si nuk humbi pyet bota?/ Prerë me shpatë djegur me topa?/ Jo, nuk humbet shqiptari,/ e provon çeliku zjarri”.

Pas këtyre betejave nga veriu, greku kërcënonte nga Jugu dhe, më 1854, përsëri një përballje e përgjakshme, por këtë herë armatosja e taborëve të redifëve shqiptarë bëhej në Delvinë dhe në Janinë dhe luftime të përgjakshme për mbrojtjen e tokës shqiptare në Petë, Mecovë, Artë dhe në të gjithë Çamërinë. Trimfuan mbi grekun e parë, por me osmanët nuk u bënë kurrë miq sepse mbeteshin në armiqësi të përjetshme. Por në këto vite në Labëri kishte një famë të madhe çeta e shquar e Bilbilenjve, që ishte me 13 vetë, por bilbilenj kishte në çdo fshat të Labërisë në të pesëqind fshatrat e saj. Kështu nga Fushëbardha kishte me dhjetëra bilbilenj, pasi për nder të Bilbil Shakos komandantit të bilbilenjve, këtë emër merrte kushdo që rrëmbente pushkën kundër pushtuesve. Kështu nga Fushëbardha bilbilenj të njohur sipas dokumenteve muzeale kanë qenë: Sadik Hazbi Memushi, Myrteza Sulli, Skëndo Habil Xhuvani, Musa Mustafa Rofi, Hito Kongoci, Gafur Kondi etj. Çdo fshat kundërshtonte taksat e rënda në mënyrën e vet, edhe pse mënyra më e ashpër dhe e drejtpërdrejtë ishte e bilbilenjve, që e përfunduan misionin e tyre duke u vetë dorëzuar dhe “shkuan në litarë vetë/bilbilenj të

trembëdhjetë” më shkurt 1858. Bilbilenjtë u varën në Janinë tek rrapi i falë, por ideali i tyre nuk u shua, vijoi të mbetej i ndezur prushi i atdhetarisë dhe i kundërshtimit të çdo lloj pushtuesi. Kështu ngeli i paepur Hito Kongoci, sikurse dhe prijës, kapedanë e luftëtarë të tjerë të trevës labe.

Luftëtarët shqiptarë në veri dhe në jug të vendit kanë qenë inovatorë në fushën e betejës. Të dhënat flasin se Hito Kongoci ose Hito Topçiu, ishte ndërtues i katër topave të gorricë në trevën labe, në krahinën e Rrëzomës, në nahijen e Delvinës. Topat e artilerisë së Hito Kongocit ishin një lloj artilerie artizanale, por funksionale, që futi panikun brenda formacioneve ushtarake të rregullta armike. Kjo metodë u përdor me efektivitet nga kryengritësit që e ndërtuan artilerinë jo me shkrirje topash por me artilerinë e vendit, me topa që ishin ndërtuar me palcën e drurit të gorricës, por edhe të lisit, të karfosura me unaza hekuri.

Këto topa prej druri u përdorën me efektivitet në luftën e Palavisë në Rrëzomë të Delvinës, ku përmendet në vargje kënge mjeshtri Hito Kongoci. Taborët e pushtuesve i zuri paniku kur “artileria shkëmbore nuk ishte vetëm në grykat e maleve që ishin të pritshme për pushtuesin, por edhe në fushë të hapur, kur gjylet binin breshër dhe prishnin formacionin luftarak të armikut, duke futur tmerr dhe frikë në radhët e tyre. Koqinova në krahinën e Rrëzomës në Delvinë u shndërrua në një realitet të ri luftarak të panjohur më parë. Taborët armike njohën një armë të re në duart e kryengritësve, topat që qëllonin nga se prisnin. Vendi do mbushej me gjyle dhe kështjella në Koqinovë do të shndërrohej në një fortesë shumëdimensionale. Artiljerët e Labërisë ngritën kështjellë dhe e fortifikuan në të gjithë drejtimet.

Kështjella natyrore solli një dimension të ri lufte. Prijësi dhe drejtuesi, topçiu i vjetër që i kishte kaluar të gjashtëdhjetat kishte përgatitur edhe topçinjtë e rinj, ata që kishin djersitur ditë e natë për ta bërë

majën e Koqinovës me një emërtim të ri “Maja e Hito Kongocit”, për ta përjetësuar luftën në fushë e në kodër, në kështjellën e Koqinovës. Luftëtarët e çetës, zhvilluan një luftim mbrojtës mjeshtëror, edhe nuk e prisnin që misioni i tyre të ishte kaq rezultativ si një “traktat lufte”. Ata nuk e dinin se edhe traktatin e luftës së artilerisë e shkruante një shqiptar në Austri, Gjergj Basta, por në fakt çeta labe po e zbatonte këtë traktat nga eksperiencia luftarake e shqiptarëve në shekuj, por dhe nga mjeshtëria e drejtimit të Hito Kongocit. Hito Kongoci e gjeti lëndën e parë tek gorricat e vjetra të zonës, që kishte me shumicë, duke prerë disa nga trungjet më të fortë e që ia vlenin për misionin që i priste. Kjo u bë edhe për faktin se faqja e malit të Lucës, por dhe mali i Lavanit kishte lisa që mund të shërbenin për këtë punë, por puna nuk priste, ndërkohë që për gjyle shërbenin gjithfarë gurësh të rrumbullakosur, por dhe copa metalesh e gjyle të vjetra të luftërave të mëparshme të zhvilluara në këtë zonë. Fillimisht bashkëluftëtarët e tij nuk e besonin nismën e Hito Kongocit, kur ai e nisi vetë i pari. Gdhendja e drurit ishte një mjeshtëri e njohur e gjithë trevës labe. Por jo për të krijuar topa lufte. Kështu trungjet ndaheshin më dysh dhe gdhendeshin me dalta, sëpata e hanxharë. Hito gjithë merak kishte siguruar edhe rrrathë hekuri nga të bucelave dhe vedrave të staneve. Pasi përgatiti “bombardën e gorricë”, që krahasuar me drurët e tjerë, druri i gorricës është shumë i fortë dhe mund të realizojë tre deri në katër, maksimumi pesë shtimje, forca e barutit e djeg dhe e çan, për këtë arsye u përgatitën edhe bombardat rezervë. Hito iu tregoi se kur të çahet e para, bëjmë gati tjetrën. Kjo ishte një taktikë dhe strategji e panjohur për pushtuesin dhe as që e prisnin që inkursioni i taborëve të pritej nga gjylet që kërcisnin mbi formacionet armike. Hito Kongoci kishte menduar edhe për barutin, për folenë e barutit, për shtupën e fortë dhe të padepërtueshme të gazrave si dhe gjylet (lënda vrasëse me gurë lumi të stralltë, copëza hekurishtesh në formë saçme. Eshka e thatë mirë shërbente në vend të fitilit.

Edhe pse ka të dhëna të ndryshme rreth kohëpërdorimit të topit të gorricë, armiku gjithsesi braktisi fushën e luftës dhe u tërhoq në panik. Armiku provoi ta shuante rezistencën dhe artilerinë e tyre të ngritur në kështjellën natyrore, por që edhe pas përdorimit të lëndëve djegëse nga pushtuesit, luftimi vijoi me të gjithë armët e deri në përleshje trup me trup, ku humbën jetën mjaft luftëtarë dhe një ndër më të njohurit është edhe shpikësi i artilerisë, artiljeri popullor, Hito Kongoci. Në Rrëzomë ende është Koqinova me histori, ku shihen mbeturinat e kështjellës, ngjajnë me një vend-guide muezeale që na kujtojnë brezit tonë dhe brezave që do të vijnë luftërat për mbrojtje të truallit arbëror, por dhe topat e gorricë të prijësit, komandantit, topçiu sypatrembur, Hito Kongocit, si një trashëgimi historike e zonës, si

një visar i çmuar i trimërisë labe, sa të moçme aq edhe me vlerë. Ndërkohë që kënga nuk rreshti për më shumë se dy shekuj dhe nuk do të reshtë kurrë: “Kush e njeh Hito Fushëbardhë,/Jelekzhveshur, pallëlarë,/Ngrehu topat e kalanë,/Në kuti ia hodhi zjarrë,/E dogji su dha i gjallë,/Në kala, në Koqinovë,/Hito Kongoci me kordhë,/Bën dyfek ruan sinorë,/Me venedikt e arhonë,.../Me junanë e me osmanë,/Për Vatanin e dha xhanë.....”.

Disa organe të shtypit ushtarak shqiptar, si Gazeta “Ushtria”, Revista “Mbrojtja”, portali Alb-Spirit, gazetat “Labëria”, “Rrënjët”, “Veterani”, “Kushtrim Brezash”, revista “Pavdekësia”, i kanë kushtuar vëmendje kësaj figure të madhe luftëtare, kanë kushtuar shkrime të posaçme për prijësin e luftëtarin e Fushëbardhës dhe të Labërisë Hito Kongoci, i cili ishte lindur në Fushëbardhë të Gjirokastrës dhe që ra në luftën e përgjakshme në rajonin e Koqinovës në Rrëzomë, Delvinë, më 1878, duke ngelur përjetësisht emër i gdhendur në përjetësi në kujtesën e Labërisë dhe mbarë kombit shqiptar, i përjetësuar në këngë: “Kush u hodh proto i pari,/Hito Kongoci kordhëtar,/topçitë me top ia dhanë,/flaka i mori fustanë,.../ si dhe nga ana tjetër kënga e përjetësoi këtë figurë madhështore të fushëbetejës: Kush e njeh Hito Fushëbardhë,/Jelekzhveshur, pallëlarë,/Ngrehu topat e kalanë,/Në kuti ia hodhi zjarrë...”.

Në pikëpamje dokumentare Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të LANÇ-it dhe dëshmorëve të tjerë të Atdheut, Dega e Gjirokastrës, e ka vërtetuar në mënyrë dokumentare, që specifikon se: “Hito Kongoci nga Fushëbardha është vrarë më 1878, në betejë kundër pushtuesve në luftën e Koqinovës në Rrëzomë të Delvinës”. Në aspektin juridik legjislacioni shqiptar e lejon plotësisht që Hito Kongoci-Fushëbardha të shpallet me titullin “Dëshmor”, sepse bazuar në aktin legjislativ të nenit 5, “Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, pika “a” e ligjit nr. 109/2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”. Pika “a” thotë: Shpallen Dëshmorë të Atdheut “personat, të cilët kanë humbur jetën për lirinë, pavarësinë kombëtare dhe mbrojtjen e territoreve shqiptare apo në përpjekje për mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe para datës 28 nëntor 1912”. Meqenëse kësaj periudhe luftarake nuk iu është kushtuar vëmendje në periudhën që shkoi një maksimë proverbiale, thotë se: “e drejta zhytet por nuk mbytet”. Gjaku i ish-prijësit e luftëtarit Hito Kongoci nuk u harrua dhe nuk do të harrohet, por meriton pedestalin e mirënjohjes dhe të lavdisë, nderimin e të gjithë shqiptarëve. Emrin e Hito Kongocit nuk e harrojnë bashkëfshatarët, bashkë-krahinarët, Labëria e më gjerë, prandaj dhe përkujtohet, si luftëtar lirie. Hito Kongoci është një emër i paharrueshëm që ngeli i nderuar dhe respektuar në breza, ngeli në këngët e popullit që janë një arkiv më vete dhe një burim i pashtershëm i të dhënave historike labe dhe më gjerë.



Kolonel Chermen Valiev bën histori në kampionatin botëror ushtarak të mundjes – medalje ari për Shqipërinë pas 113 vitesh shtet

Warendorf, Gjermani – 29 qershor 2025

Kolonel Chermen Valiev ka hyrë në histori duke u shpallur Kampion Bote në kategorinë olimpike 74 kg, stil i lirë, në Kampionatin e 38-të Botëror Ushtarak të Mundjes, i zhvilluar në Warendorf të Gjermanisë, nga data 22 deri më 29 qershor. Ky është suksesi më i madh në historinë 113-vjeçare të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë sport.

Në këtë turne prestigjioz morën pjesë 713 sportistë nga e gjithë bota, përfshirë kampionë botërorë,



evropianë dhe olimpikë. Kolonel Valiev dominoi kategorinë e tij, duke mposhtur kundërshtarët me rezultat të thellë teknik në të gjitha përballjet: ndaj italianit Finizio Luca (10-0), ukrainasit Oleksi Boruta (10-0) dhe në finale ndaj turkut Huseyin Bakir (10-0). Me këtë performancë mbresëlënëse, ai u shpall nga Komiteti Ndërkombëtar i CISM si “Mundësi më e mirë në botë”, duke marrë edhe trofeun e veçantë të këtij vlerësimi.

Ekipi shqiptar i Forcave të Armatosura, i drejtuar



nga nënkolonel Zylfi Shehu dhe i shoqëruar nga shefi i delegacionit nënkolonel Gernat Qirici, përfaqësoi denjësisht vendin. Ndër të tjerë, në tapet u ngjit edhe nënkolonel Bajram Sina, medalist evropian, i cili u rendit i shtati në botë, si dhe studenti Adolf Dema. Në përbërje të ekipit ishte dhe kolonel Islam Dudaev, por për arsye teknike nuk mori pjesë në garë.

Ky sukses erdhi falë përkushtimit të sportistëve, punës së trajnerëve dhe mbështetjes institucionale nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së nën drejtimin e gjenerallejtënant Arben Kingjit, ministrit të Mbrojtjes z. Pirro Vengu dhe Federatës Shqiptare të Mundjes me president z. Sahit Prizreni. Pjesë e delegacionit



ishte edhe atasheu ushtarak në Gjermani, kolonel Arben Zani.

Medalja e artë e Kolonel Chermen Valiev dhe vlerësimi si mundësi më e mirë në botë janë dëshmi e ngritjes së sportit elitare ushtarak shqiptar në nivelin më të lartë ndërkombëtar.





REVISTA MBROJTJA

ORGAN QENDROR I MINISTRISË SË MBROJTJES

VITI I 93-TË I BOTIMIT
MAJ-GUSHT 2025 / NR. 2